



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS**

Adresa: Rruga "Abdi Toptani", nr. 1, Tiranë; Tel-Fax: 0694057089  
E-mail: [rmuca@klsh.org.al](mailto:rmuca@klsh.org.al); Web-site: [www.klsh.org.al](http://www.klsh.org.al)

Nr. 442/ prot.

Tiranë, më / /2019

Miratohet

## Raport Auditimi Performance "Ndotja e deteve"

**Bujar LESKAJ**

**KRYETAR**



**Rinald Muça**

**Drejtor i Departamentit**

**Jo publik:** Ky dokument është pronësi e Kontrollit të Lartë të Shtetit. Ai përmban informacion jopublik dhe qëllimi i tij është përthithja e komenteve zyrtare dhe administrativ përgjatë fazës së terrenit të auditimit.



Departamenti i Performancës në KLSH @Performanca



Departamenti i Auditimit të Performancës - KLS

# RAPORT AUDITIMI

## “Ndotja e deteve”

Dhjetor 2019

Auditimi është kryer në bazë të programit të auditimit miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit nr. 442/2, datë 21.10.2019.

Projekt-raporti është draftuar nga grupi auditues në përputhje me standardet dhe udhëzimet për auditimin e performancës e konkretisht: Standardet Audituese INTOSAI dhe eksperiencën në terren, Udhëzuesin e Auditimit të Performancës ISSAI 3000-3100, Manualin e Departamentit të Auditimit të Performancës, Indikatorët e Performancës, si edhe Rregulloren e Brendshme institucionale.

Auditimi është shtrirë në një zinxhir subjektsh e konkretisht Ministrisë Turizmit dhe Mjedisit; Agjencisë Kombëtare të Bregdetit me katër Drejtoritë Rajonale, që monitoron bregdetet në Velipojë, Shëngjin, Tale (Lezhë), Gjiri i Lalzit, Durrës, Golem, Vlorë, Dhërmi, Himarë, Borsh, Sarandë; Agjencisë Kombëtare të Mjedisit me Drejtoritë Rajonale Mjedisore në 12 qarqet e vendit Berat, Dibër, Durrës, Elbasan, Fier, Gjirokastër, Korçë Kukës, Lezhë, Shkodër, Tiranë dhe Vlorë, projekt-raporti i është përcjellë Ministrisë Turizmit dhe Mjedisit; Agjencisë Kombëtare të Bregdetit me katër Drejtoritë Rajonale; Agjencisë Kombëtare të Mjedisit me Drejtoritë Rajonale Mjedisore në 12 qarqet e vendit, me shkresat nr. 442/6, datë 25.11.2019, nr. 442/4, datë 25.11.2019 dhe nr. 442/5, datë 25.11.2019, të përfshira në këtë auditim, për të përthithur sa më shumë opinione dhe observacione në drejtim të përmirësimit të mëtejshëm të shërbimit të ofruar për përdoruesit e rrugës, me fokus kryesor “Ndotja e deteve”.

Raporti ka marrë formë përfundimtare në Dhjetor të vitit 2019, pasi subjektet e audituara kanë paraqitur mendime brenda afateve ligjore për Projektraportin kështu;

- Agjencia Kombëtare e Mjedisit me shkresën nr. 5111/3 datë 19.12.2019 ka paraqitur një objeksion të saj, për të cilin mendojmë se rekomandimi, për rritjen e kompetencave të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit në monitorimin e ujërave të deteve nuk ka të bëjë me zbehjen apo uljen e rrolit të AKM e cila ka legjislacionin e saj ku mbështet veprimtarinë, por me shtrirjen e veprimtarisë së AKB në një vizion më të gjerë si në turizëm, zhvillimin e veprimtarive private, ndërtimeve, sporteve ujore, në rruajtjen e florës dhe faunës detare etj., etj.;
- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit nuk ka paraqitur mendime brenda afateve ligjore për projektraportin çka nënkupton se është dakord me të;
- Agjencia Kombëtare e Bregdetit nëpërmjet shkresës nr. 402/3 datë 20.12.2019 ka vlerësuar projektraportin dhe bashkëpunimin me KLSH duke u dakordësuar me rekomandimet për përmirësimet ligjore, rritjen e bashkëpunimit të institucioneve, etj., në mbrojtje të mjedisit dhe deteve nga ndotjet dhe ndotësit .

Cilësia e tij është garantuar nga strukturat përkatëse në KLSH

Auditimi është kryer nga grupi i auditimit:

1. Rinald Muça, Drejtor i Departamentit/përgjegjës grupi
2. Alfred Zylfi, anëtar
3. Elfrida Agolli, anëtare

## PËRMBAJTJA

1. RËNDËSIA E AUDITIMIT .....	4
1.1 Konteksti i problemit social .....	7
1.2 Strategjia e KLSH-së në auditimet e performancës.....	7
1.3 Auditime të mëparshme në këtë fushë .....	7
1.4 Subjekti nën auditim .....	8
1.4.1 Hyrje.....	9
1.4.2 Politikat e institucionit.....	10
1.4.3 Peshë në buxhet dhe GDP .....	11
1.4.4 Risqet e aktivitetit të subjektit.....	11
1.4.5 Rëndësia e produkteve të subjektit.....	13
1.4.6 Feedback-u i subjektit në fazën studimore .....	13
2. QASJA DHE DETAJET E AUDITIMIT .....	14
2.1 Objektivi dhe problemi i performancës.....	14
2.1.1 Fokusimi dhe përkufizimi i problemit .....	14
2.1.2 Objektivi i auditimit .....	15
2.2 Përkufizimet dhe terminologjia.....	15
2.3 Kriteret.....	15
2.3.1 Kriteret e politikës .....	16
2.3.2 Kriteret e monitorimit dhe raportimit.....	16
2.3.3 Kriteret teknike.....	17
2.3.4 Kriteret e tjera/ Praktikë më të mira.....	18
2.4 Piramida pyetjeve audituese .....	18
2.5 Skema e auditimit .....	18
2.5.1 Qasja/metodologjia audituese .....	19
2.5.2 Metodën & teknikat audituese .....	19
2.6 Rezultatet e parashikuara.....	19
2.6.1 Impakti i mesazhit auditues për Kuvendin dhe Qeverinë .....	19
2.6.2 Impakti i mesazhit auditues për publikun dhe palët e interesit.....	19
2.6.3 Forma e publikimit.....	19
3. SHTJELLIMI I PYETJES KRYESORE DHE NENPYETJEVE .....	20
3.1 A e ka realizuar menaxhimi dhe monitorimi i detit si pasuri natyrore kombëtare, ruajtjen nga ndotjet dhe zhvillimin e tij si vlerë e mjedisit natyror në shërbim të njeriut ?..	20
3.1.1 A garantojnë strukturat shtetërore përgjegjëse për sigurinë e deteve, zbatimin e ligjit në parandalimin e ndotjeve, krijimin e një ambienti të sigurt mjedisor, në mbrojtje, të jetës njeriut, biodiversitetit, habitateve, të faunës dhe florës së egër, interesit të përgjithshëm publik dhe zhvillimit ekonomik? .....	22
3.1.2 A garanton efektivitetin sistemi i menaxhimit e monitorimit të detit nga ndotjet, turizmin natyror, kryerjen e biznesit, përfundimin e të ardhurave, etj., në shërbim të njeriut, si trashëgimi natyror që i përket brezave? .....	43
4. PERMBLEDHJA, REFERENCA DHE ANEKSE.....	81
4.1 Referencat.....	81
4.2 Aneksë .....	96
5. GRUPI I PUNËS DHE PËRGJEGJËSITË HIERARKIKE.....	113



## LISTA E SHKURTIMEVE

<b>KLSH</b>	Kontrolli i Lartë i Shtetit
<b>INTOSAI</b>	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve të Larta të Auditimit
<b>EUROSAI</b>	Institucionet e Larta të Auditimit Evropian
<b>ISSAI</b>	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
<b>MTM</b>	Ministria e turizmit dhe Mjedisit
<b>MIE</b>	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjetikës
<b>MSHMS</b>	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
<b>AKB</b>	Agjencia e Kombëtare e Bregdetit
<b>AKM</b>	Agjencia Kombëtare e Mjedisit
<b>ISHP</b>	Instituti i Shëndetit Publik
<b>INSTAT</b>	Instituti i Statistikave
<b>MSA</b>	Marrëveshja e Stabilizim-Asocim
<b>BB</b>	Banka Botërore
<b>OBSH</b>	Organizata Botërore e Shëndetësisë
<b>OECD</b>	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik
<b>BE</b>	Bashkimi Evropian
<b>GIZ</b>	Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit GmbH
<b>SK</b>	Strategjia Kombëtare
<b>SKZHI</b>	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim
<b>PIKE</b>	Plani Kombëtar për Integrimin Evropian
<b>VKM</b>	Vendim i Këshillit të Ministrave
<b>ITUN</b>	Impianti i Trajtimit të Ujërave të Ndotura
<b>KFW</b>	Banka Gjermane për Zhvillim
<b>GIS</b>	Sistemi i Informacionit Gjeografik
<b>SHGJSH</b>	Shërbimi Gjeologjik Shqiptar
<b>MIZB</b>	Menaxhimi i Integruar i Zonave Bregdetare
<b>METAP</b>	Mediterranean Environmental Technical Assistance Program
<b>CZM</b>	Coastal Zone Management Plans
<b>UNEP/MAP</b>	Programi i Kombeve të Bashkuar për Mjedisin/Plani i Veprimit për Mesdheun
<b>PAP/RAC</b>	Qendrës për Menaxhimin të Zonës Bregdetare të UNEP/MAP
<b>RAC/SPA</b>	Qendrës për Zonat e Mbrojtura Detare të UNEP/MAP
<b>WWF</b>	Fondi botëror i jetës së egër për natyrën

## 1. RËNDËSIA E AUDITIMIT

Auditimi i performancës synon të promovojë **përmirësime në performancën e shërbimeve publike**. Filozofia e re drejtuese në KLSH e ka vënë auditimin e performancës në qendër të vëmendjes si motor të zhvillimit institucional si në Planin Strategjik 2013-2017 ashtu dhe në atë 2018-2022. Misioni i KLSH-së në Planin Strategjik 2018-2022 përkufizohet: *KLSH është institucion i pavarur kushtetues, i ndërtuar që të shërbejë qytetarit shqiptar, të jetë “agjent” i Kuvendit dhe palëve të interesit duke i informuar në mënyrë të vazhdueshme, të paanshme dhe të plotë, mbi përgjegjshmërinë që qeveria dhe entet publike tregojnë në përdorimin e kontributit të taksapaguesve shqiptarë e duke kontribuar në përmirësimin e qeverisjes nëpërmjet luftës kundër korrupsionit.<sup>1</sup>*

Rëndësia e këtij auditimi performance ka të bëjë me vlerësimin e reformave të ndërmarra nga qeveria në hartimin e politikave në mbrojtjen e mjedisit me prioritet mbrojtjen e deteve dhe bregdetit shqiptar nga ndotjet, ruajtjen e zonave të mbrojtura detare dhe gjallesave, në përputhje me standardet kombëtare, për t'u bërë pjesë e zhvillimit ekonomik, nëpërmjet përmirësimit të vazhdueshëm, realizimit të investimeve, rritjes performancës monitorimit për parandalimin, konstatimin, dhe verifikimin e shkeljeve të rregullave, duke promovuar eksperiencën efektive në zhvillimin e gjithanshëm të tyre.

Gjithashtu qëllimi i këtij auditimi performance është përmirësimi i funksionimit të një sistemi unik të menaxhimit dhe monitorimit të sigurisë në detet dhe bregdetin shqiptar nga ndotja duke promovuar shërbime të sigurta, efikase dhe ekologjikisht të shëndosha në respektim edhe të standardeve evropiane, të diktuar nga direktivat e BE dhe konventat ndërkombëtare në të cilat aderon dhe vendi ynë, sepse përmirësimi i sistemit të mbrojtjes mjedisit dhe ujërave të deteve ka ndikim të drejtpërdrejtë në jetën e shëndetit e njeriut, sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, në dobi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm, si dhe sigurimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit.

Auditimi do të bazohet në parimin e partneritetit, në përsosjen e akteve ligjore në frymën e bashkëpunimit me institucionet shtetërore, pushtetin vendor në shërbim të mjedisit ku jetojmë, florës dhe faunës bregdetare, taksapaguesit, operatorëve ekonomikë. Në konkluzione do të pasqyrohet mendimi më bashkëkohor për ruajtjen e deteve, cilësinë shërbimit të ofruar, kostot që mbart shoqëria, etj., ku mendimet e dhëna të respektojnë interesin qytetar. Gjithashtu do të synojmë në përmirësimin dhe vlerësimin e këtij sistemi që institucionet shtetërore të cilat menaxhojnë atë të bashkëpunojnë midis tyre si një i vetëm të japin llogari për veprimet e tyre në mënyrë të përgjegjshme, transparente dhe efektive që menaxhimi dhe monitorimi i ujërave detare nga ndotjet të jetë me kostot më të mira të mundshme pa rrezikuar në asnjë moment cilësinë e tyre, të jetës e gjallesave detare, etj.

Me gjithë punën e bërë deri më sot, në përmirësimin e sistemit të menaxhimit dhe monitorimit të ujërave detare nga ndotjet në vendin tonë në minimizimin e mangësive, ky sistem vazhdon të ndeshet me problematikat, që kanë të bëjnë me;

- legjislacionin dhe mënyrën e përdorimit të tij, përcaktimin e fushës dhe përgjegjësisë;
- përmirësimin të strategjisë e në mënyrë të detajuar për ruajtjen e ujërave të deteve;
- kompetencat, vendimmarrjen dhe bashkëpunimin midis institucioneve, mungesën e transparencës dhe ekspertizës;
- kompetencat, vendimmarrjen dhe bashkëpunimin midis institucioneve shtetërore dhe

---

<sup>1</sup> Strategjia e Zhvillimit të KLSH 2018-2022, miratuar me Vendim të Kryetarit KLSH nr. 228, datë 31.12.2017

pushtetit vendor;

- përmirësimin e sistemit të monitorimit e menaxhimit të sistemit të mbrojtjes së deteve nga ndotësit;
- mungesën e studimeve, kërkimeve shkencore dhe eksperimenteve për efikasitetin, në ruajtjen dhe zhvillimin e zonave bregdetare ruajtjen e deteve, zhvillimin e florës dhe faunës tyre për qëllime ekonomike e turistike në përputhje me përparësitë e përcaktuara në dokumentet strategjike;
- ndërhyrjet e paligjshme në detet dhe zonat e mbrojtura detare;
- mungesën e kanalizimeve për përpunimin e ujërave të përdorur para derdhjes në lumenj dhe dete;
- ndërhyrjet e paligjshme dhe derdhjet e pakontrolluara të karburanteve në det;
- mangësitë në monitorimin e cilësisë së ujit të deteve dhe në kryerjen cilësore të analizave të ujit;
- eliminimin e derdhjes së ujërave të përdorura të papërpunuara në det, lumenj, liqene, gropa septike;
- eliminimin e derdhjeve të ngurta dhe mbeturinave plastike në det;
- mungesën e mjeteve dhe të burimeve financiare për investime në mbrojtjen e deteve dhe largimin e mbetjeve të grumbulluara në vite;
- mungesën e mjeteve dhe të burimeve financiare për investime në zonat e mbrojtura detare si dhe për evidentimin dhe ruajtjen e florës dhe faunës në dete;
- mangësi në llogaritjen e kostove për ruajtjen dhe pastrimin e deteve dhe ruajtjen e florës dhe faunës që fshihet në to;
- mangësi të theksuara në bashkëpunimin me ndërmarrjet e ujësjellës kanalizime;
- përcaktimin e pikave më të ndotura dhe përmirësimin e infrastrukturës për eliminimin e tyre;
- përgatitjen e termave të referencës për ndotjet në dete në përputhje me normat dhe standardet e kombëtare dhe të BE-së;
- mungesën e projekteve;
- mungesën e punonjësve si dhe ndryshimet e shpeshta të tyre, ndryshimet e kompetencave e mënyrës së organizimit të institucioneve shtetërore;
- mangësi në trajnimin e aftësimit profesional të punonjësve në përfitimin e përvojave të reja profesionale, duke ndarë dhe përvojën e tyre;
- zbatimin e detyrave të raporteve dhe analizave statistikore të cilat rekomandojnë veprimet parandaluese korrigjuese për të mos ndodhur përsëri ndotje të ujërave të deteve;
- etj.

Gjithashtu me anë të këtij auditimi do të vëmë në pah anët pozitive dhe negative të menaxhimit e monitorimit të deteve nga ndotjet, si një investim në kohë ku duhet të punojnë së bashku me qëllim përmirësimin e cilësisë ujërave në shërbim të mjedisit, turizmit, gjallesave që fshihet në dete.

**Qëllimi i auditimit:** është përmirësimi i bashkëveprimit të gjitha palëve, për të nxitur, rëndësinë strategjike në mbrojtjen dhe ruajtjen e mjedisit detar nga ndotjet dhe ndotësit, respektimin e standardeve me moton uji është jeta në dorën tuaj.

**Objektivi i auditimit:** është analizimi me objektivitet i situatës për të rritur përgjegjësitë institucionale të strukturave shtetërore në monitorimin dhe menaxhimin e ruajtjes ujërave detare nga ndotjet dhe ndotësit si pasuri kombëtare e brezave.

**Rëndësia e auditimit:** është vlerësimi i performancës, përsosja e monitorimit, modernizimi i standardeve, rritja e besueshmërisë publike, për mbrojtjen e mjedisit në ujërat detare, në funksion të ruajtjes shëndetit njeriut, florës dhe faunës detare zhvillimit të turizmit, rritjes së punësimit e zhvillimit të ekonomive që kanë lidhje me detin.

### **1.1 Konteksti i problemit social**

Sot sfida e mbrojtjes deteve nga ndotjet qëndron në menaxhimin e tij në mënyrë gjithë përfshirëse duke ofruar përfitime të barabarta, sipas parimeve të politikave mjedisore dhe ujore të BE-së. Menaxhimi sa më efikas i ujit të deteve qëndron në rritjen e transparencës, besimit dhe shmangies abuzimeve sepse, përmirësimi i sistemit të menaxhimit, ka rëndësi si një element i domosdoshëm i një bashkëjetese normale qytetare, përsosja e të cilit është rezultat i shumë aspekteve dhe ndërveprimeve që kanë të bëjnë me zhvillimin e infrastrukturës e të shërbimeve, me rendin ligjor, vetëdijen qytetare dhe me qeverisjen në tërësi.

Administrimi dhe menaxhimi i ujërave të deteve nënkupton, ruajtjen, përdorimin e burimeve natyrore e biologjike, lehtësimin e kushteve për zhvillimin e turizmit, informimin dhe edukimin e publikut e sektorit publik e privat, për përfitime ekonomike. Sot sfida në çështjet mjedisore qëndron në të drejtën e publikut për akses në informacionin mjedisor, akses në drejtësi për çështjet mjedisore dhe pjesëmarrja e publikut të interesuar në vendim-marrjet mjedisore.

KLSH ka ndërmarrë këtë auditim performance në rritjen e besimit qytetar sepse në shumë raste mënyra e menaxhimit dhe bashkërendimit të veprimtarisë institucioneve shtetërore maten vetëm me shifra, por harrojmë se mënyra sesi ato menaxhojmë shërbimet, reflekton qasjen sociale për brezat e ardhshëm. Dhënia e opinionëve, për përmirësimin, modernizimin e sistemit të mbrojtjes deteve, është prioritarë sot më shumë sepse nuk është plotësisht në harmoni të plotë me kërkesat e sotme në drejtim të:

- nevojave për miratimin dhe zbatimin e “Strategjisë ndër sektoriale kombëtare për mbrojtjen mjedisore të ujit deteve”;
- përmirësimin të cilësisë së ujit në dete sipas standardeve shtetërore dhe të BE;
- ruajtjen nga shkatërrimi të habitateve;
- ruajtjes së peizazhit të habitateve, e cila në disa raste po shkon drejt zvogëlimit;
- zhvillimi i një mjedisi më të favorshëm ligjor dhe institucional për përthithjen e investitorëve të vendas dhe të huaj privatë;
- një qasje më gjithëpërfshirëse në zhvillimin e turizmit ujor, sporteve ujore, zonave të mbrojtura detare, për sigurimin e të ardhurave dhe mundësive të punësimit;
- bashkëpunimit dhe koordinimit të ruajtjes me struktura të zbatimit të ligjit për efekt të sipërfaqeve shumë të mëdha dhe vijës së gjatë bregdetare;
- problematikave me ndarjen e re administrative në përcaktimin e administrimit të territorit dhe kompetencave;

### **1.2 Strategjia e KLSH-së në auditimet e performancës**

Kontrolli i Lartë i Shtetit, në kuadër të objektivave të parashtruara në Planin Strategjik të Zhvillimit 2013-2017 dhe atij 2018-2022, në zbatim të standardeve ndërkombëtare të auditimit (INTOSAI, EUROSAI), të cilat njohin nevojën për auditime të performancës sepse lejojnë më

shumë kompleksitet dhe marrjen e praktikave më të mira evropiane, si një ndër prioritetet kryesore të tij ka përcaktuar përmirësimin e cilësisë dhe shtimin e numrit të auditimeve të performancës, çka përbën një nga sfidat më madhore të KLSH.

Auditimet e performancës në KLSH udhëhiqen nga Udhëzuesi i Auditimit të Performancës, Manuali i tij, Indikatorët e tyre si dhe udhëzuesi i Hartave Konjitive të cilat konsiderohen si dokumente dinamikë, që përditësohen me progresin praktik. Ato nuk janë thjesht dokumente normative apo teknike, apo një referencë e shpejtë, por përmbajnë një numër udhëzimesh dhe informacionesh me implikime praktike, që marrin në konsideratë kushtet specifike dhe karakteristikat e çdo auditimi performance.

KLSH këshillon dhe ndihmon drejtuesit dhe personelin e këtyre enteve për përmirësimin e proceseve të punës, sidomos aty ku efienca është e vështirë për t'u matur, si dhe në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve publike pa rritur shpenzimet.

Udhëzimet e reja të auditimit të performancës në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (ISSAI 3000-3100) nxisin një orientim drejt nevojave të qytetarëve, progresi dhe praktikat po ndërtohen nga të mësuarit mbi përvojën duke matur në çdo rast interesin publik në performancën e entit shtetëror që auditojmë.

### **1.3 Auditime të mëparshme në këtë fushë**

Të vëmendshëm dhe duke pasur në konsideratë të dhëna për kryerjen e auditimeve në këtë fushë, rezulton se është hera e parë që po realizohet një auditim performance për ndotjen e deteve, çështje kaq sensitive duke marrë shkas edhe nga problematika e trajtuar në median e shkruar dhe elektronike, megjithëse dhe në auditime të tjera kemi identifikuar çështjet që kanë të bëjnë me ndotjet e mjedisit.

Mjedisi është jo vetëm pasuri e shumëllojshme ekosistemesh, por edhe një burim ekonomie që duhet përdorur me kujdes e në mënyrë strategjike si një detyrimin social dhe moral që ta mirë menaxhojmë dhe mbrojmë këtë pasuri kombëtare në interes të qytetarëve dhe të brezave që vijnë.

Gjithashtu Kontrolli i Lartë i Shtetit në vijimësi në Ministri e Turizmit dhe Mjedisit ka kryer "Auditimin e rregullshmërisë" të cilët kanë patur të bëjnë me:

- a) verifikimin e përgjegjësisë financiare të subjekteve përgjegjëse dhe qeverisjes së përgjithshme;
- c) auditimin e sistemeve financiare dhe transaksioneve;
- ç) auditimin e sistemit të kontrollit të brendshëm;
- d) auditimin e integritetit dhe përputhshmërisë së vendimeve të marra ;
- dh) raportimin e të gjitha çështjeve të tjera që dalin nga apo që lidhen me auditimin.



#### 1.4 Subjekti nën auditim

Institucionet që do të përfshihen në këtë auditim janë :

- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit;
- Agjencia Kombëtare e Bregdetit me katër Drejtoritë Rajonale, që monitoron bregdetet në Velipojë, Shëngjin, Tale (Lezhë), Gjiri i Lalzit, Durrës, Golem, Vlorë, Dhërmi, Himarë, Borsh, Sarandë
- Agjencia Kombëtare e Mjedisit me Drejtoritë Rajonale Mjedisore në 12 qarqet e vendit Berat, Dibër, Durrës, Elbasan, Fier, Gjirokastrë, Korçë Kukës, Lezhë, Shkodër, Tiranë dhe Vlorë.



## 1.4.1 Hyrje



Nuk mund të bësh shumë gjëra pa u lidhur me mjedisin tënd. *“Individi është kalimtar, racat dhe kombet venë e vijnë, por njeriu mbetet”*<sup>2</sup>

Uji i detit është një element dinamik, vetitë e të cilit ndryshojnë në hapësirë e kohë. Lëvizjet, vetitë fizike (temperatura, kripshmëria, densiteti), gazet e tretura dhe mbetjet e ngurta krijojnë një shumëllojshmëri të kushteve mjedisore të cilat ndikojnë ndjeshëm në përbërjen e secilit komunitet biologjik që e popullon. Pjesa më e madhe e materialeve që mbërrijnë në det, shpërbëhen nëpërmjet reaksioneve kimike ose aktiviteteve bakteriale dhe organizmave më të mëdha. Megjithatë ka disa substanca të cilat janë shumë të qëndrueshme ose kanë një shkallë të ulët degradimi.<sup>3</sup>

Zonat detare sigurojnë benefite të rëndësishme për njerëzit përsa i përket ushqimit dhe shërbimeve të tjera të ekosistemit. Për mijëra vjet, njerëzit e kanë shfrytëzuar gjerësisht detin si një depozitë të madhe ushqimore në luftën e tyre për mbijetesë. Gjatë shekullit të XX, vija bregdetare ka ndryshuar disi për shkak se dyndja e turistëve së bashku me ndotjen e shkaktuar prej tyre ka goditur plazhet.

Mjedisi është bashkësia e ndërveprimeve të përbërësve biotikë dhe jo biotikë që nxisin dhe zhvillojnë jetën e gjallë në tokë, duke përfshirë mjedisin fizik, natyror të ajrit, tokës, ujërave, etj. Ruajtja dhe kujdesi për mjedisin nuk është vetëm një detyrim shoqëror, por mbi të gjitha është dhe një përgjegjësi individuale. Mjedisi është i të gjithëve dhe të gjithë duhet ta mbrojnë atë. Shoqëria, si në vendin tonë, ashtu edhe në mbarë botën po përballet me probleme të mëdha që lidhen me mjedisin si: ndotja, prishja e ekuilibrave të ekosistemeve, shfrytëzimi pa kriter i burimeve natyrore, etj. Ndotja e mjedisit është futja e drejtpërdrejtë ose e tërthortë e lëndëve, vibracioneve, energjisë, nxehtësisë, rrezatimit, zhurmave, etj., të cilat e ndryshojnë cilësinë e mjedisit e të jetës. Mbrojtja e biodiversitetit, habitateve, të faunës dhe florës së egër kanë rol të rëndësishëm dhe me interes të përgjithshëm publik në politikat e një vendi, si në zhvillimin ekonomik ashtu edhe në të ardhmen e brezave.

Mbrojtja e mjedisit, si një proces tepër kompleks, kërkon njohjen dhe aplikimin e koncepteve të reja ekologjike, sociale, ekonomike, politike; pjesëmarrjen si partnerë të shumë aktorëve: organe shtetërore, komuniteti i banorëve të zonës me rol të veçantë, OJF-ve; kërkon ndihmesën e të gjithë qytetarëve. Ajo realizohet nëpërmjet: mbështetjes ligjore dhe institucionale, formulimit të strategjive dhe politikave të përshtatshme; përgatitjes dhe zbatimit të programeve të studiuara.

Nëpërmjet këtij auditimi synojmë të skicojmë dhe adresojmë rrugën për përmbushjen dhe plotësimin e përparësive strategjike gjithëpërfshirëse për mbrojtjen e detit nga ndotjet, si edhe për të ndihmuar në zhvillimin e qëndrueshëm të menaxhimit; administrimit të integruar në strategjitë, politikat, planet, programet dhe veprimtaritë në nivel kombëtar, rajonal e vendor; etj. Të gjitha këto bëjnë të mundur që të nxisin zhvillimin e qëndrueshëm, mbrojtjen e biodiversitetit, habitateve, faunës dhe florës së egër si trashëgimi për brezat, zhvillimin e biznesit dhe turizmit, rritjen e të ardhurave dhe përmirësimin e cilësia jetës njeriut e ruajtjen e saj.

---

<sup>2</sup> Nikola Tesla ka qenë një prej mendjeve më të mëdha të shkencës. Kontributi i tij ka qenë shumë i madh në fushën e elektricitetit dhe inxhinierisë.

<sup>3</sup> (<http://www.aqualex.org>)

**Mesazhi kryesor i këtij auditimi është:** *“Agjencia Kombëtare të Bregdetit të krijojë një qasje të re ligjore në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare të Mjedisit pushtetin vendor, specialistë të fushës, institucionet ligjvënëse e grupet e interesit, në rritjen e kompetencave të saj për ruajtjen mjedisore të ujërave detare, zhvillimit të ekonomisë dhe turizmit detar, ruajtjes florës e faunës në dete dhe rritjes besimit qytetar.*

Në hartimin e këtij Raporti Auditimi, grupi i auditimit i KLSH-së, i përfaqësuar nga Rinald Muça, Alfred Zylfi, Elfrida Agolli, u bazua në dokumentacionin e mbledhur dhe përgjigjet e dhëna nëpërmjet pyetësorëve mbi ndotjet e deteve drejtuar Ministrisë Turizmit dhe Mjedisit; Agjencisë Kombëtare të Bregdetit me katër Drejtoritë Rajonale, që monitoron bregdetet në Velipojë, Shëngjin, Tale (Lezhë), Gjiri i Lalzit, Durrës, Golem, Vlorë, Dhërmi, Himarë, Borsh, Sarandë; Agjencisë Kombëtare të Mjedisit me Drejtoritë Rajonale Mjedisore në 12 qarqet e vendit Berat, Dibër, Durrës, Elbasan, Fier, Gjirokastrë, Korçë Kukës, Lezhë, Shkodër, Tiranë dhe Vlorë; në zbatim të programit të auditimit nr. 442/2, datë 21.10.2019, sipas kriterëve e standardeve të miratuara të KLSH-së, të INTOSAI-t dhe Kodin Etik.

#### **1.4.2 Politikat e institucionit**

Në programin e qeverisë 2017-2021 mjedisi konsiderohet jo vetëm pasuri e shumëllojshme ekosistemesh, por edhe një burim ekonomie që duhet përdorur me kujdes e në mënyrë strategjike, të vetëdijshme si detyrimin institucional, social dhe moral që ta mirë menaxhojmë dhe mbrojmë si pasuri kombëtare në interes të qytetarëve dhe të brezave që vijnë. Parandalimi dhe kufizimi i erozionit është i lidhur direkt me përmirësimin e kushteve të mjedisit dhe në plan afatgjatë ndikon drejtpërdrejt cilësinë e jetesës. Për këtë qëllim, është parashikuar pyllëzimi me ritme të shpejta dhe ngritje të veprave të natyrave të ndryshme hidroteknike, me qëllim disiplinimin e rrjedhës së ujërave në shtretërit e lumenjve.

Vendi ynë përfiton nga një linjë bregdetare prej 440 km dhe ndodhet në një pozicion strategjik në detet Adriatik dhe Jon. Qeveria do punojë që të marrë të gjitha masat e t'i kushtojë vëmendjen e duhur mbrojtjes së mjedisit në hapësirën ujore nëpërmjet:

- kontrollit dhe monitorimit të vazhdueshëm të parametrave të ujit të detit;
- reduktimit të sasisë së mbetjeve të ngurta dhe vajore e trajtimi i tyre sipas normave të caktuara evropiane;
- hartimit të planeve të emergjencës dhe procedurave operative për përballimin e incidenteve apo situatave të mundshme të emergjencës mjedisore;
- krijimit të strukturave të nevojshme dhe kompletimi i tyre me personelin e përshtatshëm për kryerjen e detyrave të mësipërme.

#### **1.4.3 Pesha në buxhet dhe GDP**

Nga të dhënat rezulton se Agjencia Kombëtare Bregdetit financohet nga buxheti i shtetit nëpërmjet Ministrisë Turizmit dhe Mjedisit fond i cili në përgjithësi ka ardhur duke u ulur. Fondet e akorduar nga buxheti i shtetit përdoren për përmirësimin e konkretisht:



## FONDET BUXHETORE TË PLANIFIKUARA PËR AKB


Nr.	Emërtimi	Viti 2016		Viti 2017		Viti 2018	
		Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
1	Paga	24000000	16881320	25000000	13811565	12000000	11228326
2	Sigurime shoqërore	4000000	2782204	4500000	2227927	1900000	1710946
3	Mallra shërbime	10000000	6210346	11000000	6182029	5000000	4479802
4	Shpenzime kapitale pa trupëzuara			960000	600000		
5	Shpenzime kapitale të trupëzuara	102564000	37228430	35349738	32243153		
6	<b>TOTALI</b>	<b>140564000</b>	<b>63102300</b>	<b>76809738</b>	<b>55064674</b>	<b>18900000</b>	<b>17419074</b>

Konkluzioni kryesor që nxirret nga analizimi i të dhënave sipas tabelës së mësipërme, është se fondet e planifikuar për këtë agjenci kanë ardhur gjithmonë duke u ulur si dhe nëse do të krahasohem me fondet buxhetore të Ministrisë ato zënë një përqindje të papërfillshme e konkretisht si më poshtë:

## FONDET BUXHETORE TË PLANIFIKUARA PËR MINISTRINË

Nr.	kodi/prog	Emërtimi buxhetor	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019
1	1110	Planifikim, Menaxhim e Administrim	177300	211400	157566	210040
2	5320	Programe për mbrojtjen e Mjedisit	2377078	1273603	963213	954470
3	430	Mbështetje për Peshkimin				
4	5640	Administrimi i Ujërave				
5	4260	Administrimi i Pyjeve	820752	722597	789193	987330
6	4760	Zhvillimi i Turizmit		339200	254305	475000
7	<b>TOTALI</b>	<b>Ministria e Turizmit dhe Mjedisit</b>	<b>3375130</b>	<b>2546800</b>	<b>2164277</b>	<b>2626840</b>





#### 1.4.4 Risqet e aktivitetit të subjektit

Në këtë program auditimi kemi marrë në konsideratë disa risqe të menaxhimit të sistemit të ndotjes së deteve ku në mënyrë të përmbledhur po i paraqesim si më poshtë:

- ✓ ndryshime të varësisë ministrore;
- ✓ kontributi në garantimin e monitorimit të ndotjeve të detit të disa institucioneve;
- ✓ ndryshime të strukturave të institucioneve që menaxhojnë detet;
- ✓ ndryshimet sipas ndarjes së re administrative dhe territoriale;
- ✓ mungesa e një infrastrukture të plotë dhe përgjegjëse për menaxhim profesional, cilësor dhe gjithëpërfshirës;
- ✓ mungesën e trajnimeve dhe lëvizjet e shpeshta të stafi.

#### 1.4.5 Rëndësia e produkteve të subjektit

Institucionet shtetërore Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Bregdetit, Agjencia Kombëtare e Mjedisit të cilat nëpërmjet autoritetit të tyre ligjor menaxhojnë sipas përkatësisë ndotjet e deteve mbështesin politikat e Qeverisë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe politikat e përcaktuara në strategjitë sektoriale. Institucionet kanë si fushë veprimi menaxhimin e mbrojtjes detit nga ndotjet, në përputhje me legjislacionin, duke ushtruar aktivitetin ligjor, teknik, koordinues dhe monitorues si:

- + duke marrë në mënyrë individuale ose së bashku masat e duhura në përputhje me dispozitat ligjore dhe protokolleve dhe marrëveshjet, për të ulur, për të eliminuar sa të jetë e mundur ndotjen e detit dhe për të mbrojtur e përmirësuar mjedisin detar me qëllim për të ndikuar në zhvillimin e tij të qëndrueshëm;
- + duke marrë masat e duhura për zbatimin e Planeve të Veprimit, për mbrojtjen e mjedisit detar dhe të burimeve natyrore të Detit Adriatik e Jon, si pjesë e pandarë e procesit të zhvillimit, duke plotësuar nevojat e brezit të sotshëm dhe të ardhshëm;
- + mbrojtës të mjedisit dhe për të ndihmuar në zhvillimin e qëndrueshëm të zonës detare Adriatik, Jon:
  - sipas parimit të parandalimit në bazë të cilit kur ekzistojnë kërcënime serioze apo dëme të pakthyeshme, mungesa e sigurisë shkencore nuk mund të jetë arsye për të mos marrë masa efektive për pengimin e degradimit të mjedisit;
  - sipas parimit “ndotësi paguan”, sipas të cilit kostoja e parandalimit, kontrollit dhe pakësimit të ndotjes përballohet nga ndotësi në interes të publikut;

- të vlerësimit të ndikimit në mjedisit për aktivitetet e propozuara që mund të shkaktojnë një ndikim negativ në mjedisin detar dhe i nënshtrohen një autorizimi nga autoritetet kombëtare kompetente;
- nxitjen e bashkëpunimit ndërmjet qeverisjes vendore në procedurat e vlerësimit të ndikimit të mjedisit në lidhje me aktivitetet nën juridiksionin ose kontrollin e tyre që mund të kenë një efekt të madh negativ në mjedisin detar të zonave që ndodhen jashtë kufijve të juridiksionit tyre në bazë të njoftimit, shkëmbimit të informacionit dhe konsultimit;
- angazhimit për të nxitur menaxhimin e integruar të zonave bregdetare, duke marrë parasysh mbrojtjen e zonave me interes ekologjik, pejsazheve dhe përdorimin racional të burimeve natyrore;
- miratimit të programe dhe masave që përmbajnë, aty ku duhet, afate kohore për përfundimin e tyre;
- përdorimit të teknikave ekzistuese dhe praktikave mjedisore më të mira dhe të nxisin zbatimin e aksesit dhe transferimin e teknologjive mjedisore, duke përfshirë teknologji prodhimi të pastra, duke marrë parasysh kushtet sociale, ekonomike dhe teknologjike;
- Etj.

#### **1.4.6 Feedback-u i subjektit në fazën studimore dhe realizimit**

Në fazën e parë studimore nga institucionet e përfshira në auditim, konform kërkesave ligjore, grupit të auditimit i janë krijuar komoditetet e nevojshme për realizimin e saj. Megjithatë këtu vlen të theksohet se;

- ka vështirësi në gjetjen e dokumentacionit për arsye të shpërndarjes së gjerë të institucioneve që marrin me garantimin e sigurisë ndaj ndotjes së deteve dhe varësisë institucionale në nivel qendror e lokal.

## **2. QASJA DHE DETAJET E AUDITIMIT**

### **2.1 Objektivi dhe problemi i performancës**

Ky auditim ka si objektiv ndihmesën në bashkërendimin e veprimtarisë së institucioneve shtetërore në mbrojtjen e mjedisit detar të Republikës së Shqipërisë nga ndotjet e dëmtimet, parandalimin dhe shmangien e tyre, të shkaktuara nga veprimtaritë njerëzore në det e në zonën bregdetare, të cilat prishin cilësinë e ujit, dëmtojnë burimet e detit e të bregdetit, rrezikojnë faunën dhe florën, kërcënojnë shëndetin e njeriut, si dhe vështirësojnë zhvillimin normal të veprimtarive në këtë mjedis.

#### **2.1.1 Fokusimi dhe përkufizimi i problemit**

Mbrojtja e deteve është çështja kryesore sociale e cila kërkon një sistem unik të menaxhimit dhe zhvillimit në funksion të mjedisit ku në mbrojtje të pastërtisë së tij veprojnë të gjitha aktet ligjore që mbrojnë mjedisin në vendin tonë dhe konventat, protokollet, marrëveshjet ndërkombëtare, në të cilat ne jemi palë.

Nëpërmjet këtij auditimi në këtë fushë ne synojmë të kontribuojmë në minimizimin e ndotjes deteve, mbrojtjen e florës dhe faunës detare, zhvillimit të transportit, bizneseve të peshkimit dhe rritjes së peshkut turizmit detar, përdorimit efikas të burimeve financiare, si dhe të kërkojmë nga institucionet shtetërore rritjen e monitorimit, rritjen e bashkëpunimit me pushtetin vendor si dhe të planifikojnë fonde të mjaftueshme për programet e ndotjes detare,

duke garantuar standarde të larta.

Përmirësimi i menaxhimit dhe monitorimit të sigurisë nga ndotja e deteve duhet ti kushtohet vëmendje në rritje ndaj:

- ✓ personave juridike e fizike, publike dhe private, vendas ose të huaj, që e përdorin mjedisin detar ose ushtrojnë veprimtari të ndryshme në të;
- ✓ të gjitha veprimtaritë e instaluara në bregdet;
- ✓ çdo mjet lundrues, që ndodhet ose lundron nëpër mjedisin detar;
- ✓ mjetet aeronautike, që fluturojnë mbi mjedisin detar;
- ✓ etj.

### 2.1.2 Objektivi i auditimit

Objektivi i këtij auditimi është të ndihmojë aktorët e ndryshëm që sistemi i menaxhimit të mbrojtjes së deteve nga ndotjet të jetë në përputhje me standardet edhe të BE-së, duke analizuar problematikën aktuale e instrumentet që strukturat shtetërore kanë në dispozicion për ta përmirësuar. Gjithashtu objektivi i tij është pasqyrimi me realizëm dhe objektivitet i situatës, për të kontribuar në përmirësimin e këtij sistemi, si nevojë jetike në mbrojtjen e mjedisit me kosto e tarifa sa më të përshtatshme.

Me këtë auditim synojmë të arrijmë një mendim të plotë, të drejtë dhe vlerësues të:

- Performancës institucioneve përgjegjëse në menaxhimin e monitorimin e sistemit të mbrojtjes së ujërave dhe bregdetit të vendit nga ndotjet;
- parandalimi, kontrolli dhe ulja e ndotjes së ujit;
- ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i natyrës dhe i biodiversitetit;
- ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i qëndrueshmërisë mjedisore me pjesëmarrje publike;
- përdorimi i matur dhe racional i natyrës dhe i burimeve të saj;
- ruajtja dhe rehabilitimi i vlerave kulturore dhe estetike të peizazhit natyror;
- mbrojtja dhe përmirësimi i kushteve të mjedisit;
- mbrojtja dhe përmirësimi i cilësisë së jetës dhe shëndetit të njeriut.
- përmirësimin dhe arritjen e vendosjes standardeve të BE;
- shtrirjes së monitorimit në të gjithë bregdetin;
- uljes së kostos që paguan shoqëria për pastrimin e deteve;
- matjes së performancës nëpërmjet dinamikave të rritjes së treguesve;
- rritjes besueshmërisë të opinionit publik dhe operatorëve ekonomikë.

## 2.2 Përkufizimet dhe terminologjia

Përkufizimet dhe terminologjia e përdorur në këtë material ka këto kuptime:

- "Mjedisi detar" është hapësira detare e Republikës së Shqipërisë, së bashku me faunën dhe florën, pasuritë e ujit, të sipërfaqes së fundit të detit dhe të nëntokës së tij, duke përfshirë edhe vijën bregdetare, plazhet, portet, radat dhe territoret tokësore të tyre, lagunat, grykëderdhjet e lumenjve, liqenet e vijës së ujit, që komunikojnë me detin;
- "Burimet e detit dhe të bregdetit" janë të gjitha pasuritë minerare, llojshmëria biologjike, gjetjet arkeologjike, paleontologjike, që ndodhen në mjedisin detar;
- "Ndotje" është futja nga njeriu, drejtpërdrejt ose tërthorazi, e lëndëve ose e energjisë në mjedisin detar, të cilat dëmtojnë burimet e detit dhe të bregdetit, ulin cilësinë e ujit të detit, rrezikojnë shëndetin e njeriut, pengojnë veprimtaritë detare dhe peshkimin;

- "Ndotje e madhe" është ndotja komplekse dhe me shtrirje të gjere, shmangia e se cilës kërkon masa të gjithanshme dhe operacione pastrimi;
- "Ndotje e vogël" është ndotja me shtrirje të kufizuar, shmangia e së cilës përballohet me përdorimin e mjeteve e mundësive vendore;
- "Hedhje në det" është hedhja e mbeturinave dhe e çdo lloj lëndë nga anijet, platformat, instalimet, si dhe nga bregdeti;
- "Mbytje në det" është fundosja me dashje e anijes, e platformës, e instalimit, si dhe e çdo lloj ngarkese e pajisjeje;
- "Lëndë të rrezikshme" janë lëndët që prodhimi, transporti, ruajtja, përdorimi ose shkarkimi i të cilave në mjedisin detar, si pasojë e vetive të tyre, dëmtojnë shëndetin e njeriut, cilësitë e mjedisit detar, florën, faunën dhe ulin cilësinë e jetës;
- "Mbeturina" janë të gjitha llojet e mbetjeve, që vijnë nga zhvillimi i veprimtarive njerëzore;
- "Ujëra të ndotura" janë:
  - ujërat e zeza;
  - mbeturinat e lëngëta që rrjedhin nga çdo lloj burimi;
  - derdhjet e lëngëta spitalore;
  - çdo mbeturinë tjetër, e përzier me ujërat e zeza.
- "Veprimtaritë njerëzore" përfshijnë:
  - lundrimin dhe transportin me anije e me mjete të tjera;
  - shfrytëzimin e burimeve dhe të pasurive të detit e të fund detit;
  - veprimtaritë ekonomike, tregtare, të shërbimeve të bregdetit;
  - mirëmbajtjen, riparimin dhe operacione të tjera ndihmëse për anije, platforma e instalime, që ndodhen në det e në bregdet;
  - kërkimet shkencore për burimet e detit, të shtratit dhe të nëntokës së tij;
  - studimet gjeologjike, sizmike, oqeanografike, marrjen e mostrave, shpim-kërkimet.
- "Platforme" dhe "Pontile" janë konstruksione të vendosura në det, për qëllime studimi, kërkimi ose shfrytëzimi;
- "Instalime" janë pajisjet e vendosura në det, si tubacione, kablllo, linja, për të zhvilluar veprimtari të ndryshme;
- "Djegje në det" është shkatërrimi i lirë termik në ujërat e mjedisit detar i mbeturinave dhe lëndëve të tjera të djegshme.

## 2.3 Burimet e Kriereve

### 2.3.1 Kriteret e politikës

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Ligjin 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit";
- Ligji nr.10 431, datë 9.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit"
- Ligji nr. 8905, datë 06.06.2002 "Për mbrojtjen e mjedisit detar nga ndotja dhe dëmtimi"
- Ligji nr. 93/2015 "Për turizmin";
- Ligji nr. 114/2017 për disa shtesa në ligjin nr. 93/2015 "Për turizmin"
- Ligji nr. 111/2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore"
- Ligji nr. 8102, datë 28.03.1996, i ndryshuar "Për Kuadrin Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe të Largimit dhe Përpunimit të Ujërave të Ndotura";



- Ligji nr. 9587, datë 20.7.2006; "Për Mbrojtjen e Biodiversitetit"
- Ligji nr. 68/2014, për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 9587, datë 20.07.2006 "Për mbrojtjen e biodiversitetit";
- Ligji "Për ratifikimin e Konventës së Bernës";
- Ligji nr. 8906, datë 06.06.2002 "Për zonat e mbrojtura";
- Ligji nr. 1006, datë 23.10.2008 : "Për mbrojtjen e faunës së egër.
- Ligji nr. 9131, datë 08.09.2003 "Për Rregullat e Etikës në Administratën Publike"
- Ligji nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë";
- Ligji nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore";
- Ligji nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit"
- Vendim nr. 369, datë 18.5.2016 "për miratimin e rregullores "për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit";
- Vendim i KM nr. 321, datë 28.5.2014 Për sigurinë në det, plazhe, në ujërat e brendshme në thellësi të territorit dhe gjatë ushtrimit të sporteve ujore;
- Vendim i KM nr. 31, datë 22.1.2014 Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit;
- Strategjia e Turizmit 2019-2023;

### 2.3.2 Kriteret e monitorimit dhe raportimit

- Analiza të veprimtarisë së Agjencisë Bregdetit;
- Analiza të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit
- Rregullore për organizimin dhe funksionimin e të veprimtarisë të Agjencisë Bregdetit;
- VKM nr.47, datë 29.01.2014, "Për Përcaktimin e Rregullave për Organizimin dhe Funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit e të Agjencive Rajonale të Mjedisit"
- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit  
Strategjia kombëtare e menaxhimit të integruar të mbetjeve
  1. Pyje,
  2. Biodiversitet,
  3. VNM dhe VSM,
  4. Menaxhimi i Mbetjeve,
  5. Cilësia e Ajrit,
  6. Kimikate,
  7. Zhurma,
  8. Substancat Ozonholluese.
- Të dhëna statistikore nga INSTAT
- Udhëzues dhe Manuale të Auditimit të Performancës të KLSH-së dhe SAI-ve;
- Etj.

### 2.3.3 Kriteret teknike

- Raporte monitorimit;
- Direktiva e BE 92/43/ EEC e 21 Maj 1992 "Mbi mbrojtjen e habitateve natyrore dhe të faunës dhe florës së egër"  
<http://europa.eu.int/comm/environment/nature/habdir.htm>;
- Konventa e biodiversitetit – 1994;
- Konventa e Rios 05.01.1994 - Larmia biologjike;
- Konventa e Aarhusit;

- Konventa e Bernës - Ligji për "Ratifikimin e konventës për ruajtjen e florës dhe faunës së egër dhe mjedisit natyror të Evropës"
- Aderimi i Shqipërisë në konventën për "Mbrojtjen e mjedisit detar dhe të zonës bregdetare të Detit Mesdhe, si dhe të 6 protokolleve shoqëruese"
- Protokoll i Kartagenës për biosigurinë - Ligji nr. 9279, datë 23.09.2004
- Projekte /WORD BANK,/ /UNESCO/ /USAID/ /UNDP/ /PNUD/ /BE/ /OSBE/ /GEF/ /WWF/ /MIREANIC/ /IUCN//GIZ/ /Kfw/ /ECNC/ /G&G Group/ /INCA/ /NATURA 2000/ /SBI/, /GOPA/, /JICA/, etj., "Për mjedisin";
- <http://www.bregdeti.gov.al/> Agjencia e Kombëtarë e Bregdetit;
- Etj.

### 2.3.4 Kriteret e tjera/ Praktikrat më të mira

- Indikatorët e Performancës, NAO Britanike;
- Raporte me eksperiencat më të mira ndërkombëtare;
- Strategjia Kombëtare e Sektoriale
- Raporte të auditimit të KLSH-së, Ministrisë dhe auditit të brendshëm;
- Etj.


## 2.4 Piramida pyetjeve audituese

### 1. Pyetja Kryesore: A e ka realizuar menaxhimi dhe monitorimi i detit si pasuri natyrore kombëtare, ruajtjen nga ndotjet dhe zhvillimin e tij si vlerë e mjedisit natyror në shërbim të njeriut?

1.1 A garantojnë strukturat shtetërore përgjegjëse për sigurinë e deteve, zbatimin e ligjit në parandalimin e ndotjeve, krijimin e një ambienti të sigurt mjedisor, në mbrojtje, të jetës njeriut, biodiversitetit, habitateve, të faunës dhe florës së egër, interesit të përgjithshëm publik dhe zhvillimit ekonomik?

1.2 A garanton efektivitetin sistemi i menaxhimit e monitorimit të detit nga ndotjet, turizmin natyror, kryerjen biznes, përfitim të ardhurave, etj., në shërbim të njeriut, si trashëgimi natyror që i përket brezave?

## 2.5 Skema e auditimit



### 2.5.1 Qasja/metodologjia audituese

Në këtë auditim performance, grupi i auditimit përzgjedhi si më të përshtatshëm **qasjen audituese të orientuar kah rezultati**. Rrjedhimisht, metodologjia e përdorur është **normative** dhe përmban elementë vlerësues, krahasues, analitikë dhe rekomandues.

### 2.5.2 Metodatat & teknikat audituese

Metodat e përdorura për të mbështetur metodologjinë e përzgjedhur janë si vijon:

- Mbledhje dhe shqyrtim i dokumentacionit dhe evidencave fizike;
- Studimi i organizimit dhe gjithë procesit;
- Studim i legjislacionit vendas dhe të huaj, si edhe rregulloret, manualët e referuara;
- Intervista dhe pyetje të hapura, përpunim dhe analizim cilësor e sasior i përgjigjeve të tyre;
- Intervista verbale me stafin menaxherial dhe punonjës, marrja e opinionëve të tyre;
- Vëzhgime të drejtpërdrejta përgjatë bregdetit të vendit;
- Pyetësor me pyetje të mbyllura; përpunim dhe analizim cilësor dhe sasior i përgjigjeve të pyetësorëve.
- Vlerësimi i sistemit të sigurisë rrugore dhe krahasimi me standardet kombëtare apo praktikatat më të mira;

## 2.6 Rezultatet e parashikuara

### 2.6.1 Impakti i mesazhit auditues për Kuvendin dhe Qeverinë

Me këtë auditim duam të informojmë Kuvendin dhe Qeverinë, mbi gjendjen aktuale të ujërave të deteve si nevojë jetike e njeriut dhe nëpërmjet rekomandimeve të mundësojmë realizimin e politikave që duhen ndërmarrë për përmirësimin e tij, duke promovuar eksperiencat më të mira dhe sipas standardeve bashkëkohore e ndërkombëtare.

### 2.6.2 Impakti i mesazhit auditues për publikun dhe palët e interesit

Auditimi i performancës “*Ndotja e deteve*”, ka një impakt shumë të gjerë duke qenë se prek një temë shumë delikate, që ka të bëjë me ujin dhe rritjen e cilësisë jetës. Nëpërmjet këtij auditimi synojmë të ndërgjegjësojmë të gjithë qytetarët, taksapaguesit dhe operatorët ekonomikë për pasojat, me qëllim ndryshimet përmirësuese dhe arritjen e standardeve ndërkombëtare.

### 2.6.3 Forma e publikimit

Në përfundim të auditimit do të përgatitet Projekt-Raporti i Auditimit, i cili do të diskutohet me të gjithë palët e përfshira në këtë auditim. Pas marrjes së opinionëve dhe reflektimit të tyre do të përgatitet Raporti Final i Auditimit i cili do t’iu përcillet palëve të përfshira në auditim dhe publikohet në raportet periodike dhe vjetore të KLSH-së, në Web-in e KLSH, në faqen e Facebook të Departamentit të Performancës në KLSH, në shtypin e përditshëm, etj.

### 3. SHITJELLIMI I PYETJEVE DHE NËN PYETJEVE

#### 3.1 Pyetja Kryesore: A e ka realizuar menaxhimi dhe monitorimi i detit si pasuri natyrore kombëtare, ruajtjen nga ndotjet dhe zhvillimin e tij si vlerë e mjedisit natyror në shërbim të njeriut?

Gjithë rezervuarët e ujit në tokë përbëjnë hidrosferën, e cila në vetvete përmban ujin e oqeaneve e deteve, ujin e ngurtë të akullnajave, ujin sipërfaqësor e atë nëntokësor si edhe ujin në gjendje të avullit. Dihet që rreth 97% e ujit në tokë ndodhet në dete dhe oqeanet, rreth 2% në akullnajat dhe vetëm 0,6% është ujë i ëmbël që mund të përdoret nga njerëzit.

Jeta në tokë varet nga uji i lëngët, sepse uji është tretës në shumicën e reaksioneve kimike e biologjike. Gjallesat në natyrë në përbërje të tyre janë afërsisht 70 % ujë. Vetitë e ujit i japin formë çdo aspekti të jetës, nga kimia e reaksioneve biologjike, format e makromolekulave, organizimi i qelizave, muskujve dhe organeve të vetë organizmit.<sup>4</sup>

Uji i detit është një element dinamik, vetitë e të cilit ndryshojnë në hapësirë e kohë. Lëvizjet, vetitë fizike (temperatura, kripshmëria, densiteti), gazet e tretura dhe mbetjet e ngurta krijojnë një shumëllojshmëri të kushteve mjedisore të cilat ndikojnë ndjeshëm në përbërjen e secilit komunitet biologjik që e popullon. Pjesa më e madhe e materialeve që mbërrijnë në det, shpërbëhen nëpërmjet reaksioneve kimike ose aktiviteteve bakteriale dhe organizmave më të mëdha. Megjithatë ka disa substanca të cilat janë shumë të qëndrueshme ose kanë një shkallë të ulët degradimi<sup>5</sup>.

Ndotja e ujit dhe përdorimi i tij ka ndikim të drejtpërdrejtë në shëndetin e njeriut dhe lë pasojat për kohë të gjatë. Sot në botë njihen më se dyqind sëmundje që paraqiten si pasojë e përdorimit të ujit të ndotur. Sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë (WHO) nga uji i ndotur, sot në botë sëmurën mbi pesëqind milion njerëz. Nga uji i papastër pasojnë një sërë sëmundjesh, ku, ndër më të rëndësishmet janë kolera, tifoja e zorrëve, hepatiti, tularemia etj. Këto sëmundje shpesh kanë marrë jetë njerëzore. Në ditët e sotme me zhvillimet e avancuara që po ecën bota, është vështirë të mendohet për një jetë në Tokë me ujë të pastër. Krahas kësaj, mbrojtja e ujit nga ndotja mund të bëhet edhe duke ndaluar hedhjen e ndotësve në ujë, pastaj me mënjanimin ose zvogëlimin e ndotësve në ujë, duke qarkulluar uji i ndotur nëpër sisteme të mbyllura, etj. Zvogëlimi i sasisë së hedhjes të materieve ndotëse në ujë është formë e rëndësishme e luftës kundër ndotjes. Kjo nënkupton vendosjen e filtrave përkatës dhe e sistemeve për filtrimin në vendet ku nxirren ujërat e ndotura. Një formë e mbrojtjes së ujërave rrjedhës nga ndotja është edhe mbrojtja speciale e burimeve, planifikimi i vendit të depozitimit të hedhurina, që ato të ndërtohen sa më larg ujërave rrjedhëse, zvogëlimi i përdorimit të pesticideve dhe plehrave kimike në bujqësi si dhe pyllëzimi dhe ruajtja e tokës nga erozioni. Me konventa ndërkombëtare ndotja e ujërave është e sanksionuar, por, vështirë është të binden njerëzit që të mos e ndotin atë. Prandaj, është me rëndësi vetëdijesimi dhe edukimi i popullatës për shfrytëzim racional të resurseve ujore.<sup>6</sup>


---

<sup>4</sup> [www.wikipedia.org/wiki/Cikli\\_i\\_Ujit](http://www.wikipedia.org/wiki/Cikli_i_Ujit)

<sup>5</sup> <http://www.aqualex.org>

<sup>6</sup> [www.wikipedia](http://www.wikipedia)

## Përqindja e të ujit të banjës në dete sipas cilësisë në vendet e Evropës



### Konkluzion

Çdo person, kushdo qoftë, bashkëjeton me mjedisin, jo të gjithë njerëzit e institucionet veprojnë njëlloj ndaj mjedisit, prandaj është detyrë e të gjithëve por edhe e jona që të synojmë nxitjen e veprimeve të menjëhershme që të përcaktojnë një reflektim mbi pasojat e veprimtarisë njerëzore në mjedis e ku po shkon niveli i ndotjes, duke bindur institucionet shtetërore, biznesin, komunitetin dhe qytetarin për të vepruar, që :

- të kuptojë ç' është ndotja e mjedisit;
- të njohë ndotjen e tokës;
- të tregojmë ç' është ndotja e ujërave detare;
- të tregojmë nivelin e ndotjes së ujit, shkaqet;
- të japim rolin e ligjit në mbrojtjen e mjedisit duke shprehur legjislacionin përkatës;
- të tregojmë realisht nivelet e ndotjes bazuar në statistika;
- të paraqesim disa masa që mund të merren për pakësimin e ndotjes;
- të tregojmë fakte mbi ndotjen dhe masat që merren në zonën ku jetojmë;
- të japim mesazhe rekomanduese për institucionet shtetërore dhe sensibilizuese për dëgjuesin.

<sup>7</sup> <https://www.eea.europa.eu/highlights/large-number-of-europes-bathing>  
EEA Report No 3/2019 European Bathing Water Quality in 2018

### 3.1.1 A garantojnë strukturat shtetërore përgjegjëse për sigurinë e deteve, zbatimin e ligjit në parandalimin e ndotjeve, krijimin e një ambienti të sigurt mjedisor, në mbrojtje, të jetës njeriut, biodiversitetit, habitateve, të faunës dhe florës së egër, interesit të përgjithshëm publik dhe zhvillimit ekonomik?

Mjedisi është bashkësia e ndërveprimeve të përbërësve biotike dhe jo biotike që nxisin dhe zhvillojnë jetën e gjallë në tokë, duke përfshirë mjedisin fizik, natyror te ajrit, tokës, ujërave etj. Faktorët natyrorë dhe shoqërore të mjedisit ndikojnë drejtpërdrejt në jetën e njeriut. Ata janë një kusht thelbësor për të përcaktuar zhvillimin e tyre fizik, mendor, intelektual, psikologjik dhe vete mënyrës së jetesës së tyre. Jo të gjithë njerëzit e institucionet veprojnë njëllor ndaj mjedisit. Disa zhvillojnë veprimtari mbrojtëse ndërsa të tjerë e shfrytëzojnë në mënyrat me barbare atë. Ruajtja dhe kujdesi për mjedisin nuk është vetëm një detyrim shoqëror, por mbi të gjitha është dhe një përgjegjësi individuale. Mjedisi është i të gjithëve dhe të gjithë duhet ta mbrojnë e atë. Shoqëria si në vendin tonë ashtu edhe në mbarë botën po përballlet me problem të mëdha që lidhen me mjedisin si: ndotja, prishja e ekuilibrave të ekosistemeve, shfrytëzimi pa kriter i burimeve natyrore etj. Ndotja e mjedisit, është futja e drejtpërdrejte ose e tërthortë e lëndëve, vibracioneve, energjisë, nxehtësisë, rrezatimit, zhurmave të cilat e ndryshojnë cilësinë e mjedisit e të jetës.

Legjislacionit është i rëndësishëm në të gjitha fushat ai shërben si rregullatori më i mirë i të gjithë marrëdhënieve në shoqërinë njerëzore pse jo dhe në atë të gjallesave të tjera që u binden verbërisht ligjeve të natyrës duke dhënë kështu një shembull të mirë dhe për ne qenien njerëzore që vetë natyra e sollti në majë të piramidës ekzistenciale.

Njohja, zbatimi dhe harmonizimi i legjislacionit është shumë i rëndësishëm sepse shërben si urë lidhëse midis institucioneve qendrore, pushtetit vendor dhe komunitetit, gjithashtu tre komponentët e mësipërm të legjislacionit sjellin besueshmëri, efikasitet, siguri dhe sukses. Është shumë e rëndësishme të krijohet një bazë e plotë ligjore për mbrojtjen e mjedisit detar si pjesë e natyrës, nëpërmjet zhvillimit të qëndrueshëm të saj dhe veçanërisht në:

- ✚ mbrojtjen, ruajtjen, shfrytëzimin e qëndrueshëm të mjedisit detar si pjesë e natyrës dhe burimeve të përsëritshme të tij;
- ✚ rivitalizimin e vendeve të dëmtuara ose pjesëve të saj dhe kompensimi për dëmet e shkaktuara;
- ✚ ruajtjen dhe restaurimin e baraspeshës ekologjike në natyrë;
- ✚ vendosjen e sistemit për planifikim, udhëheqje, inventarizim, monitorim, informim dhe financim, për mbrojtjen e mjedisit detar;
- ✚ realizimin e qëllimeve, të përcaktuara në politikat e mbrojtjes së mjedisit detar;
- ✚ parandalimin e përkeqësimit e mëtejshëm, ruan dhe forcon gjendjen e sistemeve ujore;
- ✚ promovimin e përdorimit e vazhdueshëm të ujërave detare, bazuar në mbrojtjen afatgjatë të tyre;
- ✚ forcimin e mbrojtjes dhe përmirësimin e mjedisit ujor, përveç të tjerash nëpërmjet masave specifike për një reduktim progresiv të shkarkimeve, ndalimin ose mënjanimin e ngadaltë të shkarkimeve të substancave të rrezikshme;
- ✚ sigurimin e një reduktimi progresiv të ndotjes dhe parandalimin e ndotjes e mëtejshme të tyre;
- ✚ zvogëlimin e shfrytëzimit të masë dhe rrezikimit të llojeve të florës dhe faunës e sidomos i atyre me rëndësi të veçantë, të rralla dhe të rrezikuara, si dhe i habitateve të tyre;
- ✚ sigurimin e së drejtës për informim publik dhe pjesëmarrje të publikut në lëmin e

- mbrojtjes së natyrës;
- ✚ sigurimin e së drejtës së qytetarëve për mjedis të shëndoshë, pushim dhe rekreacion në mjedisin detar;
- ✚ zhvillimin e turizmit detar, rritjes punësimit dhe krijimit të ardhurave nga zhvillimi i biznesit në ujërat detare;
- ✚ sigurimin e biodiversitetit përmes ruajtjes së habitateve të rëndësishme natyrore dhe llojeve me rëndësi të florës dhe faunës në statusin e favorshëm të ruajtjes;
- ✚ arritjen e mbrojtjes e ujërave territoriale dhe detare, arritjen e objektivave të marrëveshjeve përkatëse ndërkombëtare, që synojnë parandalimin dhe zhdukjen e ndotjes së mjedisit detar, nëpërmjet ndërhyrjes së Komunitetit Evropian bazuar në konventat evropiane për të ndaluar ose mënjanuar gradualisht shkarkimet, derdhjet dhe humbjet e substancave parësore të rrezikshme, me qëllimin përfundimtar të arritjes së përqendrimeve në mjedisin detar afër normave bazë për substancat me origjinë natyrore dhe çuarjen në zero të substancave sintetike të prodhuara nga njeriu.
- ✚ sjelljen e standardeve të Shqipërisë në harmoni me ato të Bashkimit Evropian

Qeveria dhe organizmat ndërkombëtare të pranishëm në vendin tonë prej kohësh pranojnë nevojën për një angazhim më të madh për të kontribuar në reformimin dhe transformimin e sistemit të mbrojtjes së mjedisit si një nga faktorët e rëndësishëm në mbrojtjen e shëndetit të njeriut.

Nga ana e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit hartimi i strategjisë dhe përmirësimet ligjore në sistemin e mbrojtjes mjedisore të ujërave detare, duhet të konkretizoheshin më shumë nga përpjekje dhe angazhim intensiv e profesional në vendosjen e dialogut gjithëpërfshirës, për të siguruar mirëkuptimin ndërmjet aktorëve të ndryshëm për të garantuar një sistem të menaxhimit të respektuar në nivel kombëtar e madje dhe ndërkombëtar.

Në kuadrin e politikave të qeverisjes janë bërë disa ndryshime në e konkretisht;

- ndryshimi i emërimit nga Ministria e Zhvillimit Urban Turizmit në Ministria Turizmit dhe Mjedisit;
- kalimit të varësisë së ujërave nga Ministria e Mjedisit dhe Turizmit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural e sot në varësi të Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë
- krijimit të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit me kompetenca të cunguara në mbrojtjen e ujërave detare;
- mbrojtjes së ujërave nga ndotjet në ndërvarësi të shumë institucioneve;
- monitorim i cilësisë së ujërave detare bëhet nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit e cila për kryerjen e analizave të ujërave të larjes në një distancë jo larg bregut të detit, nënkontraktin Institutin e Shëndetit Publik, të cilët disponojnë edhe laborator, ndërsa menaxhimi i ujërave bëhet nga Agjencia Kombëtare e Ujërave në varësi të Ministrisë infrastrukturës dhe Energjetikës;
- legjislacion prej vitesh dhe i pa harmonizuar me ndryshime të emërtimeve të reja kompetencave, direktivave të BE, etj.;
- mos përcaktimit konkretë të kompetencave të mbrojtjes së mjedisit në ujërat detarë;
- problematikave me kompetencat sipas edhe ndarjes së re territoriale të bashkive, etj.

ndryshime të cilat janë pasuar edhe me lëvizjen e fushës së varësisë e për pasojë ndryshimin e kompetencave të tyre në këtë fushë. Synimi i këtyre ndryshimeve ka qenë përmirësimi i sistemit por nuk është shoqëruar me studim “si ka qenë - si është - si do të bëhet” ku të jepen efektet



dhe pritshmëritë e tij në krijimin e kësaj qasje të re të administrimit të kompetencave, asetëve, burimeve njerëzore dhe financiare të sistemit të menaxhimit të mbrojtjes së ujërave detare nga ndotjet në funksion të mbrojtjes mjedisit, zhvillimit biznesit e turizmit, mbrojtjen e florës dhe faunës detare, etj.

Studimi duhet të kishte konsistuar gjithashtu në zhvillimin e politikave dhe hapave ligjorë që duhen ndërmarrë për reformimin dhe modernizimin e sistemit të menaxhimit të mbrojtjes mjedisore të ujërave detarë, përcaktimin e kriterëve të përgjithshme, organizimin dhe funksionimin e institucioneve që menaxhojnë, në përputhje me kërkesat e perspektivën e zhvillimit ekonomik, kombëtar dhe rajonal, kërkesat e tregut të punës dhe me drejtimet evropiane të zhvillimit të vendit.

## A.

### VENDIM

Nr. 509, datë 13.9.2017

#### PËR PËRCAKTIMIN E FUSHËS SË PËRGJEGJËSISË SHETËTËRORE TË MINISTRISË SË TURIZMIT DHE MJEDISIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

#### VENDOSI:

1. Miratimin e misionit dhe të fushave të përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.
2. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka si mision hartimin dhe zbatimin e politikave që synojnë mbrojtjen e mjedisit, përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, mbrojtjen e natyrës dhe të biodiversitetit, zhvillimin dhe menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve e kullotave, monitorimin e cilësisë së ujërave, si dhe hartimin dhe zbatimin e politikave për turizmin.
3. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit e ushtron veprimtarinë e saj në këto fusha përgjegjësie shtetërore, në përputhje me legjislacionin përkatës:
  - a) Sektorin e mjedisit, përfshirë politikën, standardet e trajtimit të mbetjeve dhe të efekteve që sjellin në drejtim të ajrit dhe të mjedisit, cilësinë e ajrit, zhurmat, ndotjen industriale, kimikatet, ndryshimet klimatike dhe monitorimin e treguesve të mjedisit dhe të cilësisë së ujërave, vlerësimin e ndikimit në mjedis;
  - b) Natyrën dhe biodiversitetin, përfshirë florën dhe faunën, mbrojtjen e tokës nga erozioni e degradimi, mbrojtjen e peizazhit natyror, mbrojtjen e faunës së egër e të specieve të rrezikuara dhe zonat e mbrojtura;
  - c) Sektorin e pyjeve dhe të kullotave;
  - d) Harton dhe zbaton politika për një zhvillim të qëndrueshëm të turizmit, nëpërmjet nxitjes së investimeve në fushën e turizmit, ngritjes dhe monitorimit të sistemit të standardeve në turizëm dhe edukimit në vazhdim të biznesit në fushën e turizmit, promovimit të produktit dhe destinacioneve turistike, koordinimit dhe bashkëpunimit me strukturat shtetërore,



pushtetin vendor, dhe funksione të tjera, të cilat do të mbulohen nga institucionet e varësisë, aparati i ministrisë dhe degët territoriale.

4. Vendimi nr. 945, datë 9.10.2013, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjesisë shtetërore të Ministrisë së Mjedisit”, shfuqizohet.
5. Ngarkohet Ministria e Turizmit dhe Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.

## **B.**

### **VENDIM I KESHILLIT TE MINISTRAVE NR. 31, DATË 22.1.2014**

*“Për Krijimin dhe Mënyrën e Organizimit e të Funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit”*

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4 e 6 të ligjit nr. 90/2012 datë 27.9.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban dhe Turizmit, Këshilli i Ministrave

#### **VENDOSI: KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

1. Krijimin e Agjencisë Kombëtare të Bregdetit, në vijim AKB, si person juridik publik buxhetor, në varësi të ministrit të Zhvillimit Urban dhe Turizmit, me seli në Tiranë.

2. AKB-ja ka për qëllim mbrojtjen e zonës bregdetare, promovimin dhe monitorimin e projekteve, ndjekjen e zhvillimit të zonës bregdetare e të planeve të miratuara nga autoritetet e planifikimit.

3. AKB-ja ka stemën, logon dhe vulën e vet zyrtare, të cilat miratohen nga titullari. Stema përbëhet nga stema e Republikës së Shqipërisë me shënimet: “Republika e Shqipërisë, Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit, Agjencia Kombëtare e Bregdetit”, në përputhje me përcaktimet e vendimit nr. 474, datë 10.7.2003 të Këshillit të Ministrave “Për mënyrën e përdorimit të stemës së Republikës, si dhe raportin e përmasave të saj”.

4. Vula zyrtare e AKB-së ka formën dhe elementet e përcaktuara në pikën 2 të vendimit nr.390, datë 6.8.1993 të Këshillit të Ministrave “Për rregullat e prodhimit, administrimit, kontrollit dhe ruajtjes së vulave zyrtare”, të ndryshuar.

Vula e AKB-së prodhohet, administrohet dhe ruhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

#### **KREU II ORGANIZIMI I AKB-së KREU III PËRGJEGJËSITË DHE DETYRAT E AKB-SË**

1. AKB-ja e shtrin veprimtarinë në të gjithë territorin e zonës bregdetare të Republikës së Shqipërisë, të përcaktuar sipas lidhjes 1 bashkëlidhur këtij vendimi.

2. AKB-ja ka objekt të veprimtarisë së saj dhe kryen këto funksione:

- a) Mbrojtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të zonës bregdetare;
- b) Zbatimin e politikave e të strategjive për menaxhimin e integruar të zonës bregdetare;
- c) Bashkërendimin e programeve të lidhura me zonën bregdetare;

- d) ç) Nxitjen e investimeve në zonën bregdetare;
- d) Dhënien e kontributit në informimin, konsultimin dhe aksesin e publikut gjatë hartimit dhe zbatimit të politikave e të strategjive të lidhura me menaxhimin e integruar të zonës bregdetare;
- dh) Marrjen pjesë në hartimin e politikave e të strategjive kombëtare për menaxhimin e integruar të bregdetit dhe bashkërendimin e punës për zbatimin e tyre;
- e) Propozimin e ndryshimeve dhe përmirësimin e kuadrit ligjor e nënligjor për menaxhimin e integruar të zonës bregdetare;
- ë) Bashkëpunimin me organet përkatëse për projektet dhe aktivitetet për mbrojtjen dhe zhvillimin e bregdetit dhe monitorimin e zbatimit të tyre;
- f) Nxitjen dhe bashkëpunimin me organizma, institucione, investitorë dhe aktorë të tjerë ndërkombëtarë apo vendas dhe fitimin e tyre për pjesëmarrje dhe përfshirje në projektet dhe zhvillimet me rëndësi për menaxhimin e integruar të zonës bregdetare;
- g) Monitorimin e zbatimit me përpikëri të instrumenteve të planifikimit të territorit, të miratuara nga autoritetet qendrore dhe vendore në zonën bregdetare;
- gj) Monitorimin e respektimit të rregullave për përdorimin e pasurisë së patjetërsueshme publike në zonën bregdetare;
- h) Hartimin e rregullores së posaçme, ku përcaktohen standardet kombëtare, sipas të cilave administrohen hapësirat publike të zonës bregdetare, që përdoren si plazhe publike apo të administruara nga subjekte private. Kjo rregullore miratohet nga ministri përgjegjës për turizmin;
- i) Monitorimin e respektimit të kriterëve ligjore për dhënien në përdorim dhe administrimin e plazheve, duke verifikuar administrimin e tyre nga subjektet shtetërore dhe private, si edhe lënien në dispozicion të publikut të plazheve publike pa pagesë për përdoruesit;
- j) Hartimin e rregullores për disiplinimin e zhvillimit të veprimtarive turistike, të cilat zhvillohen në zonën bregdetare. Kjo rregullore miratohet nga ministri përgjegjës për turizmin;
- k) Monitorimin e respektimit të kriterëve ligjore për kryerjen e veprimtarive turistike detare, të cilat zhvillohen në zonën bregdetare;
- l) Lajmërimin e organeve shtetërore kompetente në rastet kur vërehen shkelje administrative, veprime apo mosveprime në kundërshtim me ligjin, duke u propozuar organeve përkatëse marrjen e masave disiplinore ndaj personave përgjegjës, si dhe përgatitjen e kallëzimit penal për veprat penale të vëna re gjatë ushtrimit të kontrollit dhe paraqitjen e tyre pranë organeve përgjegjëse, sipas legjislacionit në fuqi;
- II) Administrimin e pasurive të paluajtshme shtetërore dhe publike, të cilat i kalohen në përgjegjësi administrimi, në përputhje me rregullat e përcaktuara nga legjislacioni shqiptar në fuqi.

#### KREU IV

#### PROCEDURAT E REKRUTIMIT

#### KREU V

#### DISPOZITA KALIMTARE E TË FUNDIT

1. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i shtetit, nëpërmjet Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Turizmit.
2. Ngarkohet Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit për zbatimin e këtij vendimi.

#### VENDIM

**Nr. 295, datë 8.4.2015**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 31, DATË 22.1.2014,**

## **TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR KRIJIMIN DHE MËNYRËN E ORGANIZIMIT E TË FUNKSIONIMIT TË AGJENCISË KOMBËTARE TË BREGDETTIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4 e 6, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 31, datë 22.1.2014, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Kudo në vendim, emërtimi “... Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit ...” zëvendësohet me “... Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes ...”;

b) Pika 2, e kreut I, “Dispozita të përgjithshme”, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. Agjencia Kombëtare e Bregdetit e shtrin veprimtarinë e saj në të gjithë territorin e zonës bregdetare të Republikës së Shqipërisë dhe në zonat, territoret, objektet e veprimtaritë që ndodhen ose zhvillohen, tërësisht ose pjesërisht, apo kanë ndikim në zonën bregdetare të Republikës së Shqipërisë.”.

c) Pika 1, e kreut II, “Organizimi i AKB-së”, ndryshohet, si më poshtë vijon;

“1. AKB-ja ka statusin e drejtorisë së përgjithshme, në nivel qendror, dhe në nivel vendor organizohet në degë rajonale.”.

ç) Pas kreut III shtohet kreu III/1, me këtë përmbajtje:

“KREU III/1

### **BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL**

1. Agjencia Kombëtare e Bregdetit, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj, ka të drejtë të marrë nga organet e tjera shtetërore, qendrore dhe vendore, të gjithë ndihmën dhe të dhënat e nevojshme për ushtrimin e funksioneve që i janë caktuar.

2. Institucionet shtetërore janë të detyruara të bashkëpunojnë me Agjencinë Kombëtare të Bregdetit, të shkëmbejnë të dhëna dhe të krijojnë të gjitha lehtësitë për përmbushjen e qëllimeve e të funksioneve gjatë veprimtarisë së saj.”.

3. Ngarkohet Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes për zbatimin e këtij vendimi.

**VENDIM Nr. 569, datë 17.7.2019**

## **PËR MIRATIMIN E KOMPETENCAVE, MËNYRËN E ORGANIZIMIT DHE TË FUNKSIONIMIT TË AGJENCISË KOMBËTARE TË BREGDETTIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 93/2015 “Për turizmin”, të ndryshuar, dhe të nenit 6, të ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI: I.

### **DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

1. Krijimin e Agjencisë Kombëtare të Bregdetit (në vijim AKB), si person juridik, publik, buxhetor, në varësi të ministrit përgjegjës për turizmin (në vijim ministri), me seli në Tiranë.

2. AKB-ja financohet nga buxheti i shtetit, donacione të huaja dhe burime të tjera të ligjshme. Buxheti i AKB-së përbën zë të veçantë në buxhetin e ministrisë përgjegjëse për turizmin.

3. AKB-ja ka për mision mbrojtjen dhe zhvillimin e një mjedisi të qëndrueshëm të zonës bregdetare, nëpërmjet monitorimit dhe kontrollit të gjithë potencialit ekzistues të zonës bregdetare e detare dhe pasurive mjedisore që përfshihen brenda saj, si dhe kontrollin e

veprimtarive turistike në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit.

## II. KOMPETENCAT/PËRGJEGJËSITË FUNKSIONALE TË AGJENCISË KOMBËTARE TË BREGDETIT

AKB-ja ka këto kompetenca/përgjegjësi:

- a) Sigurimin e performancës në zonat bregdetare;
- b) Organizimin e punës për menaxhimin e integruar të zonës bregdetare;
- c) Organizimin e punës për nxitjen e investimeve në zonën bregdetare;
- ç) Organizimin e punës për bashkërendimin e programeve, të projekteve zhvilluese me rëndësi për menaxhimin e integruar të zonës bregdetare;
- d) Sigurimin e zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit, nëpërmjet inspektimit dhe kontrollit të veprimtarive turistike.

## III. ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I AGJENCISË KOMBËTARE TË BREGDETIT

1. AKB-ja e shtrin veprimtarinë e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe në zonat, territoret, objektet e veprimtaritë që ndodhen ose zhvillohen, tërësisht ose pjesërisht, apo kanë ndikim në zonën bregdetare të Republikës së Shqipërisë.

2. AKB-ja organizohet në dy nivele:

- a) në nivel qendror, nëpërmjet drejtorisë qendrore;
- b) në nivel rajonal, nëpërmjet 4 (katër) agjencive rajonale.

3. Ministri miraton me urdhër shtrirjen territoriale të agjencive rajonale dhe qytetin/qarkun ku do të ngrihet agjencia rajonale.

4. AKB-ja drejtohet nga drejtori i Përgjithshëm, i cili organizon e drejton të gjithë veprimtarinë e kësaj agjencie dhe përgjigjet para ministrit. Drejtori i Përgjithshëm përfaqëson agjencinë në marrëdhënie me të tretë. Agjencitë rajonale drejtohen nga drejtuesit përkatës.

5. Struktura dhe organika e Agjencisë Kombëtare të Bregdetit miratohet nga Kryeministri, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore.

6. AKB-ja, në përputhje me kompetencat/ përgjegjësitë e veta, kryen këto detyra:

- a) Krijon dhe përditëson Inventarin Kombëtar të Zonës Bregdetare;
- b) Jep kontribut në informimin, konsultimin dhe aksesin e publikut gjatë hartimit dhe zbatimit të politikave e të strategjive të lidhura me menaxhimin e integruar të zonës bregdetare;
- c) Merr pjesë në hartimin e politikave e të strategjive kombëtare për menaxhimin e integruar të bregdetit dhe bashkërendimin e punës për zbatimin e tyre;
- ç) Propozon ndryshime dhe përmirëson kuadrin ligjor e nënligjor për menaxhimin e integruar të zonës bregdetare;
- d) Bashkëpunon me organet përkatëse për projektet dhe aktivitetet për mbrojtjen e zhvillimin e bregdetit dhe monitorimin e zbatimit të tyre;
- dh) Nxit dhe bashkëpunon me organizma, institucione, investitorë dhe aktorë të tjerë ndërkombëtarë apo vendas dhe i fton ata për pjesëmarrje e përfshirje në projektet dhe zhvillimet me rëndësi për menaxhimin e integruar të zonës bregdetare;
- e) Monitoron zbatimin me përpikëri të instrumenteve të planifikimit të territorit, të miratuara nga autoritetet qendrore e vendore në zonën bregdetare;
- ë) Kontrollon zbatimin e kriterëve dhe të kushteve nga subjektet që ushtrojnë veprimtari turistike, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi;
- f) Ushtron kontroll dhe inspekton në mjediset dhe në dokumentacionin e subjekteve që

ushtrojnë veprimtari turistike;

g) Inspekton dhe monitoron rregulloren për disiplinimin e zhvillimit të veprimtarive turistike detare, që zhvillohen në zonën bregdetare dhe respektimin e rregullave për përdorimin e pasurisë së patjetërsueshme publike në zonën bregdetare;

gj) Inspekton dhe kontrollon zbatimin e rregullave për kushtet dhe kriteret për ushtrimin e veprimtarive në stacionet e plazhit, sipas akteve nënligjore në fuqi;

h) Merr masa, vendos gjoba/masa administrative për shkeljet e konstatuara nga subjektet që ushtrojnë veprimtari turistike, në përputhje me dispozitat e ligjit;

i) Shqyrton ankesat për masat administrative dhe gjobat e vendosura ndaj subjekteve;

j) Ndjek procesin e ekzekutimit të detyrimeve monetare të subjekteve të gjobitura, me qëllim arkëtimin e shumave në favor të institucionit;

k) Lajmëron organet shtetërore kompetente në rastet kur vërehen shkelje administrative, veprime apo mosveprime në kundërshtim me ligjin, duke u propozuar organeve përkatëse marrjen e masave disiplinore ndaj personave përgjegjës, si dhe përgatit kallëzimin penal për veprat penale të vëna re gjatë ushtrimit të kontrollit dhe e paraqet atë pranë organeve përgjegjëse, sipas legjislacionit në fuqi;

l) Vlerëson nevojat dhe harton buxhetin vjetor e afatmesëm të institucionit;

ll) Siguron burimet njerëzore dhe garanton zhvillimin – trajnimin e tyre në përputhje me kërkesat e pozicionit të punës, si dhe kryen vlerësimin e performancës;

m) Mirëmban pajisjet dhe asetet në dispozicion për zhvillimin e veprimtarisë;

n) Kryen detyra të tjera të dhëna me akte ligjore dhe nënligjore.

#### 7. Agjencitë rajonale të bregdetit kryejnë këto detyra:

a) Përgjigjen para drejtorit të Përgjithshëm të AKB-së për zbatimin e detyrave të përcaktuara nga drejtoria qendrore e AKB-së;

b) Bashkëpunojnë për sigurimin e informacionit për ngritjen dhe përditësimin e Inventarit Kombëtar të Zonës Bregdetare;

c) Monitorojnë zbatimin me përpikëri të instrumenteve të planifikimit të territorit, të miratuara nga autoritetet qendrore e vendore në zonën bregdetare, si dhe raportimin e situatës në drejtorinë qendrore të AKB-së;

ç) Kontrollojnë zbatimin e kriterëve dhe të kushteve nga subjektet që ushtrojnë veprimtari turistike, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi;

d) Ushtrojnë kontroll dhe inspektimin në mjediset dhe në dokumentacionin e subjekteve që ushtrojnë veprimtari turistike;

dh) Inspektojnë dhe monitorojnë rregulloren për disiplinimin e zhvillimit të veprimtarive turistike detare, që zhvillohen në zonën bregdetare, dhe respektojnë rregullat për përdorimin e pasurisë së patjetërsueshme publike në zonën bregdetare;

e) Inspektojnë dhe kontrollojnë zbatimin e rregullave për kushtet dhe kriteret për ushtrimin e veprimtarive në stacionet e plazhit, sipas akteve nënligjore në fuqi;

ë) Marrin masa, vendosin gjoba/masa administrative për shkeljet e konstatuara nga subjektet që ushtrojnë veprimtari turistike, në përputhje me dispozitat e ligjit;

f) Inspektojnë dhe kontrollojnë zbatimin e rregullave për kushtet dhe kriteret për ushtrimin e veprimtarive në stacionet e plazhit, sipas akteve nënligjore në fuqi.

8. AKB-ja, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj, ka të drejtë të marrë nga organet e tjera shtetërore, qendrore e vendore, të gjithë ndihmën dhe të dhënat e nevojshme për ushtrimin e funksioneve që i janë caktuar. Institucionet shtetërore janë të detyruara të bashkëpunojnë me AKB-në, të shkëmbejnë të dhëna dhe të krijojnë të gjitha lehtësitë për përmbushjen e qëllimeve e të funksioneve gjatë veprimtarisë së saj.

9. Rregullorja që përcakton metodat e brendshme të punës dhe sjelljen e personelit të AKB-së miratohet nga ministri, me propozimin e drejtorit të Përgjithshëm.
10. Marrëdhëniet e punës së drejtorit të Përgjithshëm dhe të nëpunësve të AKB-së rregullohen sipas dispozitave të legjislacionit për nëpunësin civil. Marrëdhëniet e punës së punonjësve administrativë rregullohen në bazë të dispozitave të Kodit të Punës.
11. AKB-ja ka stemën, logon dhe vulën e saj zyrtare. Stema e AKB-së përbëhet nga stema e Republikës së Shqipërisë, me shënimet “Republika e Shqipërisë, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Bregdetit”, në përputhje me përcaktimet e vendimit të Këshillit të Ministrave, për mënyrën e përdorimit të stemës së Republikës së Shqipërisë.
12. Agjencitë rajonale të bregdetit kanë stemën, logon dhe vulën e tyre zyrtare. Stema e agjencive rajonale përbëhet nga stema e Republikës së Shqipërisë, me shënimet “Republika e Shqipërisë, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Bregdetit, Agjencia Rajonale e Bregdetit... (emri i qarkut/qytetit ku ka selinë agjencia)”, në përputhje me përcaktimet e vendimit të Këshillit të Ministrave, për mënyrën e përdorimit të stemës së Republikës së Shqipërisë.
13. Vula e AKB-së dhe vula e secilës agjenci rajonale të bregdetit kanë formën dhe elementet e përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave për rregullat e prodhimit, administrimit, kontrollit dhe ruajtjes së vulave zyrtare. Vulat prodhohen, administrohen dhe ruhen në përputhje me legjislacionin në fuqi.

#### IV. DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

1. Deri në fillimin e funksionimit të plotë të AKB-së, sipas përcaktimeve të këtij vendimi, struktura aktuale vazhdon funksionimin e saj sipas strukturës dhe organikës të miratuar.
2. Numri i punonjësve, asetet dhe fondet e miratuara për AKB-në dhe agjencitë rajonale riorganizohen sipas AKB-së, në nivel qendror e rajonal.
3. Nëpunësit civilë aktualë të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit, të cilët kryejnë funksionet e inspektimit për kundërvajtjet administrative në fushën e turizmit, funksione të cilat kalojnë në Agjencinë Kombëtare të Bregdetit, transferohen pranë AKB-së, në zbatim të legjislacionit të nëpunësit civil, në rastin e mbylljes e të ristrukturimit të institucioneve.
4. Vendimi nr. 31, datë 22.1.2014, i Këshillit të Ministrave, “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit”, i ndryshuar, shfuqizohet.
5. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Departamenti i Administratës Publike për zbatimin e këtij vendimi.

- ✚ Agjencia Kombëtare e Bregdetit është krijuar në Janar të vitit 2014, bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 31, datë 22.1.2014 “Për Krijimin dhe Mënyrën e Organizimit e të Funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit” i ndryshuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 295, datë 8.4.2015 i cili është (i shfuqizuar) me funksion kryesor: *mbrojtjen e zonës bregdetare, promovimin dhe monitorimin e projekteve, ndjekjen e zhvillimit të zonës bregdetare e të planeve të miratuara nga autoritetet e planifikimit*. AKB do të kontrollojë në mënyrë të vazhdueshme nëpërmjet stafit të saj të gjithë vijën bregdetare, duke verifikuar në terren respektimin e legjislacionit si dhe duke sanksionuar shkeljet e kryera nga subjektet private.
- ✚ Me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 569, datë 17.07.2019 “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit, misioni i AKB-së është përcaktuar në: *mbrojtjen dhe zhvillimin e një mjedisi të qëndrueshëm të zonës bregdetare, nëpërmjet monitorimit dhe kontrollit të gjithë potencialit ekzistues të zonës bregdetare e detare dhe pasurive mjedisore*

*që përfshihen brenda saj, si dhe kontrollin e veprimtarive turistike në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit.*

Për sa më sipër rezulton se sipas legjislacionit edhe në vitin 2019 përsëri krijohet AKB e cila është krijuar në vitin 2014, gjithashtu në përmbajtjen e legjislacionit rregullues të AKB-së nuk përfshihet mbrojtja dhe monitorimi i ujërave detare nga ndotjet megjithëse mbrojtje e bregut të detit ka lidhje dhe me ujërat e larjes në bregun e detit, por funksioni i saj lidhet kryesisht me mbrojtjen e bregdetit.

- Sipas kuadrit ligjor në fuqi, AKB bashkëpunon me të gjitha institucionet qendrore dhe vendore për përcjelljen e informacionit të mbledhur nga monitorimet në terren. Pas konstatimeve të ndryshme dhe sipas natyrës së rastit, materialet i kalohen institucioneve përkatëse për trajtim, çka do të thotë se vetëm informohen por çfarë ndodh më vonë a zgjidhen apo jo.
- Në bazë të detyrave të ngarkuara AKB nuk ka personel, si dhe infrastrukturë mbështetëse, logjistike zyra, etj. etj., të mjaftueshëm për realizimin e tyre.
- Gjithashtu nga kuadri ligjor në fuqi mund të konstatojmë se për mbrojtjen e detit AKB i referohet edhe ligjeve të përgjithshme mbi “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën “Për mbrojtjen e mjedisit detar dhe të zonës bregdetare të detit Mesdhe, (Konventa e Barcelonës 1976)”, Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë, Ligji Nr. 10431, datë 9.6.2011 Për Mbrojtjen e Mjedisit, i ndryshuar, ligjin nr. 111/2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore” i ndryshuar.

Në të gjitha ligjet në fuqi nuk ka një rregullim specifik apo përcaktim të vijës bregdetare, por në ligje të ndryshme ka dispozita të ndryshme, ndaj nevojitet unifikimi i të gjitha dispozitave në një ligj të vetëm.. Nga legjislacioni në fuqi konstatohet ekzistenca e disa institucioneve qendrore që operojnë në bregdet çka tregon se ka një mbivendosje të kompetencave mes tyre. Ligji 115/2014 Për Ndarjen Administrativo-Territoriale të Njësive të Qeverisjes Vendore, nuk ka përcaktime për bregdetin, me përjashtim të përmendjes së vijës bregdetare si kufi, në hartat që shoqërojnë këtë ligj.

Ligji nr.9251, datë 08.07.2004 “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë”

Neni 13 (Mjedisi detar)

1. Mjedisi detar janë pasuritë e nënujet, te sipërfaqes se fundit dhe te nëntokës se fundit të detit, si pjese e pasurisë kombëtare te shtetit shqiptar.
2. Ai shtrihet gjate gjithë vijës së bregdetit shqiptar dhe vazhdon deri ne kufirin e zonës ekskluzive ekonomike.
3. Ujërat ekonomike te përcaktuara me marrëveshje dypalëshe i ratifikon Këshilli i Ministrave.
4. Mjedisi detar përbëhet nga
  - a) vija e bregdetit shqiptar;
  - b) plazhet, portet, radat e porteve dhe territoret tokësore te tyre;
  - c) lagunat, grykëderdhjet e lumenjve ne det, liqenet e vijës se ujit, qe komunikojnë vazhdimisht ose përkohësisht me detin;
  - ç) ujërat e brendshme detare, territoriale dhe ekonomike, sipas përcaktimit te nenit 12 të këtij Kodi.

Neni 19 (Pronësia detare)

1. Janë në pronësi të shtetit dhe në administrim të organeve shtetërore, që mbulojnë fushat përkatëse të veprimtarive detare, ujërat e brendshme territoriale, deti territorial, vija bregdetare, ujërat e liqeneve dhe të lumenjve të lundrueshëm, trojet, kalatat dhe

çdo objekt tjetër i paluajjtshëm në territorin e portit, përfshirë muret rrethuese të tij dhe akuatoriumin, si dhe instalimet e sinjalizimit, te ndriçimit dhe te komunikimit brenda territorit të portit, në kanalin hyrës dhe në rade.

2. Janë në pronësi të subjekteve publike ose private makineritë dhe instalimet portuale, pajisjet e tjera, objektet e lëvizshme portuale dhe mjetet detare.

3. Shfrytëzimi dhe të drejtat e tjera të pronësisë së anijeve mund të realizohen nga çasti i regjistrimit të tyre në regjistrin përkatës të mjeteve lundruese.

4. Shfrytëzimi dhe të drejtat e tjera të pronësisë në platformat detare dhe në pajisjet mbi e nënujore realizohen nga çasti i dhënies së lejes së veprimtarisë.

5. Me ligj të veçantë mund të ndalohet pronësia e subjekteve private në lloje të caktuara mjeteve lundruese.

- Në vijim të punës për përmirësimin e legjislacionit dhe hartimit të një kuadri ligjor specifik për mbrojtjen e bregdetit, Agjencia Kombëtare e Bregdetit (në vijim AKB), ka kryer një analizë të legjislacionit aktual, si rezultat i të cilit është arritur në përfundimin se është i nevojshëm ndërhyrja me një ligj specifik për bregdetin.

Gjatë 5 viteve të funksionimit të AKB-së janë konstatuar problematika me:

- a) ndërtimet pa leje;
- b) mungesa e efektivitetit të pushtetit vendor;
- c) rreziku i zënies së hapësirave publike të përbashkëta.

- AKB është e mendimit se administrimi bregdetit duhet të kryhet në mënyrë unike nga një institucion i posaçëm shtetëror, i ngritur për këtë qëllim, si dhe me një strukturë organizative që do të përshtatet kompetencave të reja të këtij institucioni.

Si rezultat:

- AKB duhet të kontrollojë në mënyrë të vazhdueshme nëpërmjet stafit të saj të gjithë vijën bregdetare, duke verifikuar në terren respektimin e legjislacionit si dhe duke sanksionuar shkeljet e kryera nga subjektet private;
- AKB duhet të bashkëpunojë me organet e pushtetit qendror dhe vendor edhe për sa i përket aspekteve të lidhura me bregdetin siç janë kontrolli i territorit dhe ndërtimeve, mbrojtja e mjedisit, menaxhimi i ujërave, peshkimi dhe akuakultura, veprimtaritë turistike, etj. Në këto raste AKB do t'i sinjalizojë organeve kompetente rastet e konstatuara prej saj me qëllim krijimin e një modeli bashkëpunimi të veprimtarisë së organeve shtetërore.
- Përsa i përket veprimtarive turistike dhe veçanërisht modelit të plazheve, AKB me punën e saj ka qenë bashkëpunuese me të gjitha institucionet qendrore dhe vendore për menaxhimin e plazheve dhe ka propozuar disa herë ndryshime në modelin e menaxhimit të plazheve, të cilat ende janë në proces diskutimi, por vetëm kaq çka do të thotë se të gjitha kanë mbetur në letër dhe diskutime të vazhdueshme pa marrë hapa konkretë dhe arritur rezultatet e kërkuara.
- Në lidhje me menaxhimin e vijës bregdetare, AKB, pas eksperiencës në terren dhe pas studimeve të një sërë modelesh në vende Evropiane ajo ka dërguar dy propozime:

**a) Modeli Francez;**

Ky model konsiston në krijimin e një institucioni shtetëror të cilit i është besuar administrimi dhe planifikimi i një pjese të territorit të bregdetit Francez.

Duke patur parasysh legjislacionin e komplikuar Francez në funksion të pushtetit vendor, është parë e arsyeshme që shteti Francez të operojë nëpërmjet Konservatorit Litoral si administrator dhe garantues i mbrojtjes së vijës bregdetare. Për këtë arsye Konservatori i janë dhënë në administrim pjesë të vijës bregdetare plazhe, ishuj, kështjella apo asete të



tjera. Këto asete administrohen nga Konservatori në të mirë të publikut me një buxhet operativ i cili nxirret nga asetet turistike, si dhe nga donacione të ndryshme. Konservatori trashëgon edhe prona private të cilat i administron, me kushtin që ato të mos tjetërsohen, por të jenë të hapura dhe të vizitueshme nga publiku. Në këtë mënyrë Konservatori operon si një entitet në dobi të publikut dhe në ruajtje të vijës bregdetare Franceze ndaj interesave financiare të biznesit privat. Duhet theksuar se Konservatori administron 10% të turizmit Francez, si dhe një pjesë të vijës bregdetare në vendet e ish kolonive Franceze.

#### **b) Modeli i Malit të Zi;**

Mali i Zi me një vijë bregdetare sa 1/3 e Shqipërisë e administron këtë aset publik në mënyrë vertikale nga veriu në jug nëpërmjet një institucioni publik të quajtur: "Ndërmarrja Publike e të Mirave Detare". Kjo ndërmarrje administron plazhet, molet e vogla, lungomaret, shtëpitë e peshkatarëve, licencat e peshkimit, si dhe çdo gjë që ka lidhje me detin deri në një distancë prej 200 m nga vija e ujit. Kjo ndërmarrje është përgjegjëse për planifikimin, administrimin (që nga plehrat e deri tek molet apo infrastrukturë detare), si dhe ankandin publik për dhënien e plazheve në administrim. Sipas modelit të ankandit Mali i Zi mbledh nga 6 deri në 8 milion euro të ardhura në sezon duke i ri investuar ato në plazhet e veta dhe në këtë mënyrë garanton një standard të lartë.

AKB pasi i pa nga afër këto dy modele ka propozuar modelin e Malit të Zi si më afër situatës aktuale në Shqipëri.

### **C.**

#### **LIGJ**

Nr. 8905, datë 6.6.2002

#### **PER MBROJTJEN E MJEDISIT DETAR NGA NDOTJA DHE DEMENTIMI**

Ne mbështetje të neneve 78, 81 pika 1 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**

**I REPUBLIKES SE SHQIPERISE**

**V E N D O S I:**

**KREU I**

**DISPOZITA TE PERGJITHSHME**

**Neni 1**

**Qëllimi**

Ky ligj ka për qëllim mbrojtjen e mjedisit detar të Republikës së Shqipërisë nga ndotjet e dëmtimet, parandalimin dhe shmangien e tyre, të shkaktuara nga veprimtaritë njerëzore në det e në zonën bregdetare, të cilat prishin cilësinë e ujit, dëmtojnë burimet e detit e të bregdetit, rrezikojnë faunën dhe florën, kërcënojnë shëndetin e njeriut, si dhe vështirësojnë zhvillimin normal të veprimtarive në këtë mjedis.

**Neni 20**

**Aktet nënligjore**

Ngarkohen Këshilli i Ministrave dhe ministritë përkatëse të nxjerrin aktet nënligjore për zbatimin e këtij ligji.

**Neni 21**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare

Shpallur me dekretin nr. 3379, datë 24.6.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,

**Rexhep Meidani**

Kështu krijimi i një sistemi ligjor siç u cilësua dhe më lart në përputhje me midis tyre duke krijuar harmoni midis institucioneve, nuk është bërë duke kryer studim për këtë fushë. Studimi duhet të ishte kryer apo realizuar para këtyre ndryshimeve, bashkimeve, kalimeve, apo krijimit të institucioneve të reja dhe të ishin i analizuar mirë të gjithë faktorët gjithëpërfshirës në këtë proces sepse është e nevojshme të ketë një zgjidhje që ti rezistojë kohës e të mundësojë qasjen më efikase në këtë fushë, duke u mbështetur në:

- vlerësimet dhe zbatimin e legjislacionit të mëparshëm, në bazë të përvojës së fituar;
- përvojën e të punësuarve në institucionet e sistemit të mbrojtjes mjedisore që ballafaqohen çdo ditë me probleme;
- konsultime individuale dhe me përfaqësues të gjitha institucioneve e ministrive, grupeve të interesit që përfaqësojnë sektorin joqeveritar/civil në lidhje me sistemin e menaxhimit të mbrojtjes së deteve nga ndotjet;
- bashkëpunimin me partnerë privatë dhe organizata jo qeveritare (OJQ) potenciale të shquara e të njohura të cilat me përvojën dhe kapacitetin e tyre mund të kontribuojnë në mënyrë të konsiderueshme në si në përcaktimin ashtu edhe në implementimin e qëllimeve dhe masave të përcaktuara për përmirësimin e sistemit menaxhimit të mbrojtjes së deteve nga ndotjet;
- konsultimin dhe me strategji e dokumente tjera rajonale, që kanë të bëjnë me mjedisin dhe ndotjet e deteve në vendet e tjera evropiane, në mënyrë që njohuritë e këtyre vendeve të përdoren për të dhënë rezultatet më të mira të mundshme në sistemin e menaxhimit të ruajtjes së deteve nga ndotjet.

\*\*\*\*\*

Me gjithë punën e bërë nga AKB politikat e saj nuk janë plotësisht të orientuara drejt zhvillimit efikas dhe të qëndrueshëm të mbrojtjes së deteve, me qëllim rritjen e nivelit ekonomik, ruajtjes florës dhe faunës detare dhe të cilësisë së jetës të brezave të sotëm dhe të ardhshëm, kjo dhe për mungesë të një baze të plotë ligjore megjithatë ajo është pjesë e disa projekteve kështu, ajo është pjesë dhe e projekteve me financim të huaj, si partner, në disa projekte që do të zhvillohen në zonën bregdetare, të tilla si:

### **1. "FISHFEST".**

- **"European Fish Tourism Festival" (Festivali Evropian i Turizmit të Peshkimit "FISHFEST").**
- Në fokus të këtij projekti është zhvillimi një produkti inovativ të turizmit tematik ndërkombëtar (European Fish Tourism Festival, EFTF) i përqendruar në traditat Evropiane të peshkimit dhe komunitetet bregdetare. Ky festival do të kontribuojë në shumëllojshmërinë dhe rritjen e ofertave turistike ndërkombëtare të peshkimit në Evropë, duke u bërë dhe një mundësi për vende të reja pune, përfshirje sociale dhe ringjallje të komuniteteve që varen nga ky sektor. Ky projekt rrit përvojat e udhëtimit të turistëve, duke mbledhur në një format të përbashkët një gamë të gjerë të objekteve turistike të lidhura me peizazhet bregdetare evropiane, kulturën e peshkimit dhe traditat kulinarike.

### **2. "REGLPORTS"**

#### **"Nautical Tourism Development and Promotion of Regional Ports".**

- Përmbledhja e objektivave të programit konsiston në: përmirësimin e kushteve të zhvillimit të sipërmarrjeve të vogla dhe të mesme në zonën ndërkufitare, reklamimi i atraktivitetit të pasurive natyrore dhe kulturore me qëllim zhvillimin e një ekonomie të qëndrueshme, rritja e bashkëpunimit ndërmjet partnerëve kryesorë të zonës për ofrimin e produkteve kulturore dhe kreative që janë risi, rritja e bashkëpunimit ndërkufitar mbi strategjitë në lidhje me

peizazhet ujore, promovimi i praktikave dhe mjeteve të reja për të reduktuar emetimet e karbonit dhe për të përmirësuar efikasitetin e përdorimit të energjisë në sektorët publikë, rritja e koordinimit ndërmjet partnerëve të përfshirë për të nxitur lidhjet e qëndrueshme ndërkufitare në fushën e bashkëpunimit. Deti Adriatik karakterizohet nga një mjedis unik bregdetar me potencial të rëndësishëm për zhvillimin e turizmit. Ky potencial nuk është shfrytëzuar plotësisht, ndërkohë që aktivitetet turistike janë kryesisht të përqendruara në një qasje diellore, deti dhe rërë sezonale. Megjithatë, ekzistojnë forma alternative të turizmit që mund të zgjasin sezonin turistik, të sigurojnë kushtet thelbësore për rritjen ekonomike rajonale.

### **3. “Blue Coast”,**

#### **“Climate – Smart Coastal Practices for Blue Governance”.**

- Në fokus të këtij projekti është përmirësimi i nivelit të mbrojtjes dhe rritja e efikasitetit në menaxhimin e këtyre përpjekjeve për breshkën e detit Careta Careta në kufirin midis Greqisë dhe Shqipërisë dhe vendosja e lidhjeve për të lejuar veprime të përbashkëta për menaxhimin efikas të këtyre banorëve në lidhje me ndryshimin e kushteve klimaterike. Objektivi i parë është mbrojtja, ruajtja dhe aktiviteti i menaxhimit në të gjithë habitatin bregdetar dhe detar për breshkën të llojit “Careta” në zonën e Zakynthos dhe Himarës për eliminimin / zbutjen e kërcënimeve kryesore dhe presioneve atmosferike. Vendosja e një vëzhguesi ndërkufitar për një menaxhim eficient të habitatit – shkëmbim të eksperiencave dhe ekspertizës. Gjetja e një mënyre të re monitorimi për të dhënat mbi ajrin, detare dhe bregdetare duke kontribuar në vlerësimin e shëndetit të habitatit dhe një monitorim afat gjatë. Krijimi i një qendre kulturore për komunitetin dhe aktorët kryesorë si peshkatarët për shembull, duke kontribuar në reduktimin e aktiviteteve me impakt negative që ndodhin në këtë zonë. Mbrojtjen e mjedisit dhe promovimin e përshtatjes dhe zbutjes së ndryshimeve klimatike, parandalimin dhe menaxhimin e rrezikut përmes: veprimeve të përbashkëta për mbrojtjen e mjedisit; promovimin e përdorimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore, efikasitetin e burimeve natyrore, burimet e ripërtëritshme të energjisë dhe zhvendosjen drejt një ekonomie të sigurve dhe të qëndrueshme, duke nxitur investimet për të evidentuar rreziqet specifike, duke siguruar apo krijuar sisteme menaxhimi të katastrofave natyrore dhe përgatitjen në rast emergjencash.

### **4. “WELCOME”**

#### **“WatEr Landscapes sustainability through reuse of Marine littEr (Qëndrueshmëria e peizazheve ujore nëpërmjet ripërdorimit të mbetjeve të ngurta detare).**

- Në fokus të këtij projekti, janë çështje që lidhen me menaxhimin e mbetjeve detare (marine litter) të cilat gjithmonë e më shumë janë objekt studimi e menaxhimi sot në Evropë e veçanërisht në zonën e Mesdheut, duke u konsideruar si një nga kërcënimet më serioze të zonave bregdetare. Projekti “WELCOME” ka rëndësi për bregdetin shqiptar për shkakun se ai do të jetë një kontribut i veçantë në përpjekjet për menaxhimin e problemit të mbetjeve të ngurta që përfundojnë në det, si edhe në krijimin e modeleve të mbrojtjes së peizazhit bregdetar dhe në veçanti të dunave ranore nëpërmjet ripërdorimit të mbetjeve që rikuperohen.

\*\*\*\*\*

Nga auditimi dhe përgjigjet e pyetësorëve rezulton se për ndotjet e deteve nuk ka strategji prandaj, një numër sfidash mbeten për t'u adresuar edhe gjatë kësaj periudhe kohore që nuk ka strategji për mbrojtjen e deteve nga ndotjet ku të jenë të përcaktuara objektivat drejtimet, politikat për mbrojtjen e deteve nga ndotjet dhe ndotësit, në përputhje me drejtimet e

strategjinë e Qeverisë dokument që duhet të ofrojë zgjidhje të qëndrueshme për sfidat e sektorit, në bazë të një metodologjie gjithëpërfshirëse bazuar mbi vlerësime reale të sektorit. Dokumenti strategjik duhet të hartohet mbi bazën e përdorimit të qëndrueshëm të potencialeve natyrore, kulturore dhe historike për zhvillimin e produkteve të cilësisë lartë dhe të shumëllojshme, e arritshme lehtësisht gjithashtu mbi parime rigorozë që sigurojnë zhvillim të qëndrueshëm të sektorit, duke e vlerësuar respektin ndaj mjedisit si kriter të pa negociuar. Strategjia duhet të forcojë frymën e integruar, duke i bërë bashkë një numër aktorësh në realizimin e objektivave dhe zbatimin e planit të veprimit.

\*\*\*\*\*

Nga auditimi rezulton se nuk ka përpunime të plotë të kompetencave territoriale sipas ndarjes së re administrative duke krijuar vështirësi në menaxhimin dhe ushtrimin e detyrimeve të plota për monitorimin e ndotjeve të ujërave detare sidomos gjatë brigjeve të detit. Prandaj duhet fokusuar më shumë në hartimin dhe marrjen parasysh të politikave dhe direktivave e konventave rajonale evropiane për menaxhimin e integruar të zonave bregdetare, dhe duke u fokusuar veçanërisht në përkufizimet dhe referencat e tyre për rajonin bregdetar sipas ndarjes së re territoriale. Gjithashtu duhet patur edhe parasysh sintetizimi i strategjive kombëtare sektoriale, studimeve kërkimore dhe kërkimeve të mëparshme të zhvilluara për këtë si dhe konceptet themelore duhet lidhen me qëndrueshmërinë, mbrojtjen e mjedisit dhe krijimin e efikasitetit social, mjedisore dhe ekonomike, sfidat hapësinore urbane duke analizuar marrëdhëniet midis shoqërisë dhe mjedisit tonë natyror.

Rëndësia e politikave të integruara për zhvillimin e zonës bregdetare duhet të jetë një nga prioritetet më të rëndësishme sepse deri tani ka qenë jo-formal dhe me mungesa dialogu gjithëpërfshirës, i cili të udhëheqë zhvillimin ekonomik dhe territorial përgjatë bregdetit shqiptar apo koordinimi midis qeverisjeve lokale.

\*\*\*\*\*

Gjithashtu nga auditimi rezulton se me gjithë punën e bërë nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Bregdetit, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, etj., në mbrojtje të deteve nga ndotjet dhe ndotësit mbetet ende shumë për të bërë në drejtim të :

- Rritjes së përgjegjësisë dhe bashkëpunimit institucional të gjitha strukturave shtetërore për përmirësimin e sistemit të menaxhimit dhe monitorimit të ruajtjes deteve nga ndotjet;
- Përcaktimit të piramidës institucioneve shtetërore me detyrat përkatëse duke filluar nga ministria të cilën merren me menaxhimin, monitorimin dhe ruajtjen e ujërave të detit nga ndotjet, sepse nga përgjigjet e pyetësorit nga ana e MTM rezulton “ *Monitorim i cilësisë së ujërave detare bëhet nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit që nënkontraktton Institutin e Shëndetit Publik, të cilët disponojnë edhe laborator. Menaxhimi i ujërave bëhet nga Agjencia Kombëtare e ujërave në varësi të MIE*”
- Të përcaktimit nga ana e Ministrisë Turizmit dhe Mjedisit të listës apo piramidës e shoqatave apo organizatave vendase dhe të huaja me detyrat përkatëse të cilën kanë projekte në monitorimin dhe ruajtjen e ujërave të detit nga ndotjet;
- Të përpunimit dhe përshtatjes legjislativë për menaxhimin dhe monitorimin e mbrojtjes së deteve nga ndotjet dhe ndotësit me legjislativën e BE i cili nuk është arrit plotësisht me gjithë punën e bërë për përafrimin e tij. Kështu prioritet është përfarimi i legjislativës me direktivën nr. 2008/56/EC, për mbrojtjen e ujërave detare në Shqipëri

ku lider është Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë në bashkëpunim me institucionet e tjera;

- Propozimeve konkrete dhe shtimit të buxhetit nga ana e MTM për investime në shërbim të përmirësimit cilësisë së ujit të deteve në mbrojtje të njeriut, florës dhe faunës, aktiviteteve sportive, subjekteve privat, etj. me pretekstin se investimet për mbrojtjen e cilësisë e ujërave nuk kryen nga MTM por nga MIE. Shtimi i investimeve do të bëjë të mundur rehabilitimin e zonave të ndotura e të dëmtuara të ujërave detare dhe ndërkuftare;
- Realizimit të strategjisë së munguar për mbrojtjen e deteve nga ndotjet ku të jenë përcaktuar objektivat drejtimit, politikat për mbrojtjen e deteve nga ndotjet dhe ndotësit, në përputhje me drejtimit e strategjinë e Qeverisë. Gjithashtu politikat e Ministrisë Turizmit dhe Mjedisit e institucioneve në varësi të saj duhet të jenë të orientuara drejt zhvillimit efikas dhe të qëndrueshëm të mbrojtjes së deteve, me qëllim rritjen e nivelit ekonomik, ruajtjes florës dhe faunës detare dhe të cilësisë së jetës të brezave të sotëm dhe të ardhshëm;
- Krijimit nga ana e Ministrisë Turizmit dhe Mjedisit, dhe AKB të hartës së munguar të vendeve të derdhjes së ujërave të përdorura të trajtuara dhe të pa trajtuara si dhe vendeve derdhjes së ujërave të ndotura në të gjithë vendin si dhe përcaktuar subjektet që derdhin ujërat e përdorura në det ose në gropa septike pranë bregut të deti. Megjithatë sipas AKM ajo është në procesin e përfundimit të hartës vendeve të derdhjes së ujërave të ndotura nga subjektet privatë në të gjithë vendin kështu:
  - ka zhvilluar një hartë me subjektet e identifikuar si ndotëse në lumenj,
  - vendet e derdhjes së ujërave të ndotura janë të përcaktuara me koordinata në lejet mjedisore,
  - identifikimi i subjekteve si ndotëse në lumenj është bërë nga Projekti "Identifikimi i burimeve të ndotjes në lumenjtë kryesorë të vendit dhe forcimi i kontrollit të ndotjes së lumenjve", gjatë vitit 2016.

Për sa me sipër realizimi i këtyre hartave do të bëjë të mundur edhe monitorimin e derdhjeve të ujërave të përdorura të trajtuara dhe të pa trajtuara në të gjithë vendin jashtë impianteve të trajtimit dhe pastrimit të tyre;

- Krijimit të saktë nga ana e MTM të hartës vendeve të depozitimit të mbetjeve urbane në të gjithë vendin dhe në mënyrë të veçantë atë të zonave bregdetare gjë të cilën sipas përgjigjeve të pyetësorit e ka MIE e cila ka publikuar një hartë të realizuar nga vlerësimet e fundit së bashku me KFW dhe paraqitur në këtë projekt raport gjë e cila do të bëjë të mundur dhe monitorimin e vazhdueshëm të tyre dhe marrjen e masave përkatëse;
- Krijimit nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, dhe AKB të hartës vendeve të derdhjes lumenjve në det mungesa e së cilës bën të pamundur këqyrjen dhe monitorimin e vendeve të derdhjes tyre në det nga ndotjet që sjellin me vete në grykëderdhjet e tyre nga shkarkimet e ujërave të përdorura, mbetjeve urbane, karburanteve, mbetjeve të ngurta, etj.;
- Krijimit nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të hartës vendeve të kryerjes së veprimtarive ekonomike në det si rritjes dhe përpunimit të peshkut apo dhe gjallesave të tjera detare, ku të jenë të pasqyruar të dhënat e subjekteve të cilët ushtrojnë veprimtarinë ekonomike në fushën e akuakulturës dhe që janë pajisur me leje mjedisit;
- Krijimit nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe AKB të hartës së vendeve të kryerjes sportive ujore, turizmit nënujor, etj., megjithëse sipas strategjisë MTM turizmi është prioritet, duke synuar të nxitë diversifikimin e turizmit në mënyrë që të kemi një turizëm

më të qëndrueshëm dhe gjithëvjetor. Objektivat që synohen janë si më poshtë megjithëse këtu vlen të theksohet se në këto objektiva nuk përfshihen sportet ujore, apo turizmi detar kështu ato janë:

- Centralizmi i procesit të planifikimit në turizëm, reformim i institucioneve, agjencive që merren me turizmin;
- Vendosje e rregullt në treg e të gjithë operatorëve ekonomikë në fushën e turizmit (agjenci, operatorë turistikë, udhërrëfyes dhe struktura mikpritëse);
- Përmirësimi i legjislacionit do të shoqërohet edhe me përmirësimin e të dhënave si mjeti kryesor për matjen ekonomike të turizmit;
- Mobilizim i aktorëve që merren me turizmin dhe komunikim i vazhdueshëm me komunitetin,
- Kontroll i cilësisë dhe i standardeve në strukturat mikpritëse.

## Gjetje

Me gjithë punën e bërë dhe reformat e ndërmarra nga institucionet shtetërore sistemi i menaxhimit të mbrojtjes së deteve nga ndotjet dhe ndotësit në mbrojtje të mjedisit, zhvillimit të ekonomisë detare dhe turizmit, në mbrojtje të florës dhe faunës në dete vazhdojnë të kenë mangësi sepse:

- ✘ Ministria e Turizmit dhe Mjedisit në bashkëpunim me institucionet e varësisë nuk ka hartuar strategji për mbrojtjen e deteve nga ndotjet ku të jenë përcaktuar objektivat drejtimit, politikat, në përputhje me drejtimit e strategjisë Qeverisë. Strategji e orientuar drejt zhvillimit efikas dhe të qëndrueshëm të mbrojtjes së deteve, me qëllim rritjen e nivelit ekonomik, ruajtjes florës dhe faunës detare dhe të cilësisë së jetës të brezave të sotëm dhe të ardhshëm;
- ✘ në përmbajtjen e legjislacionit rregullues të AKB-së nuk përfshihet mbrojtja dhe monitorimi i ujërave detare nga ndotjet dhe ndotësit megjithëse mbrojtja e bregut të detit ka lidhje dhe me ujërat e larjes në bregun e detit, por funksioni i saj lidhet kryesisht me mbrojtjen e bregdetit;
- ✘ AKB bashkëpunon me të gjitha institucionet qendrore dhe vendore për përcjelljen e informacionit të mbledhur nga monitorimet në terren, por pas konstatimeve të ndryshme dhe sipas natyrës së rastit, materialet i kalohen institucioneve përkatëse për trajtim, por çfarë ndodh më vonë AKB nuk ka informacion;
- ✘ AKB nuk ka personel, si dhe infrastrukturë mbështetëse, logjistikë zyra, fonde, investime etj. etj., të mjaftueshëm për realizimin e mbrojtjes së deteve nga ndotjet dhe ndotësit;
- ✘ në të gjitha ligjet në fuqi nuk ka një rregullim specifik apo përcaktim të vijës bregdetare, por në ligje të ndryshme ka dispozita të ndryshme, ndaj nevojitet unifikimi i të gjitha dispozitave në një ligj të vetëm;
- ✘ nuk ka një ligj specifik në mbrojtjen mjedisore vetëm për administrimin e bregdetin, ku të përfshihet si deti ashtu dhe bregu i tij i cili të kryhet në mënyrë unike nga një institucion i posaçëm shtetëror, i ngritur për këtë qëllim, me një strukturë organizative që do ti përshtatet kompetencave të reja të këtij institucioni;
- ✘ konstatohet ekzistenca e disa institucioneve qendrore që operojnë në bregdet çka tregon se ka një mbivendosje të kompetencave mes tyre. Ligji 115/2014 Për Ndarjen Administrativo-Territoriale të Njësisive të Qeverisjes Vendore, nuk ka përcaktime për bregdetin, me përjashtim të përmendjes së vijës bregdetare si kufi, në hartat që shoqërojnë këtë ligj;

- ✘ nuk ka përputhje të plotë të kompetencave territoriale sipas ndarjes së re administrative duke krijuar vështirësi në menaxhimin dhe ushtrimin e detyrimeve të plota për monitorimin e ndotjeve të ujërave detare sidomos gjatë brigjeve të detit;
- ✘ Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe AKM nuk ka hartuar aktet nënligjore, rregullore, për shpalljen e zonave në rrezik ku përcaktohen programet, masat dhe detyrimet e tjera përkatëse, me qëllim reduktimin dhe parandalimin e ndotjes së ujërave nga substancat e dëmshme, në mbrojtjen e ujërave detare dhe ruajtjes florës dhe faunës detare;
- ✘ Ministria e Turizmit dhe Mjedisit nuk ka kryer auditime për të matur performancën e shërbimit të ofruar në mbrojtjen e deteve nga ndotësit dhe ndotjet;
- ✘ Ministria e Turizmit dhe Mjedisit nuk ka raporte kontrolli të ruajtjes gjendjes natyrore të faunës dhe florës të ujërave detare dhe ndërkufitare;
- ✘ Gjithashtu nga auditimi rezulton se me gjithë punën e bërë nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Bregdetit, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, etj., në mbrojtje të deteve nga ndotjet dhe ndotësit ka akoma mangësi në drejtim të :
  - rritjes së përgjegjësive dhe bashkëpunimit institucional të gjitha strukturave shtetërore për përmirësimin e sistemit të menaxhimit dhe monitorimit të ruajtjes deteve nga ndotjet;
  - përcaktimit të piramidës institucioneve shtetërore me detyrat përkatëse
  - mos evidentimit nga ana e Ministrisë Turizmit dhe Mjedisit të listës apo piramidës e shoqatave apo organizatave vendase dhe të huaja me detyrat përkatëse të cilën kanë projekte në monitorimin dhe ruajtjen e ujërave të detit nga ndotjet;
  - të përputhjes dhe përshtatjes legjisacionit për menaxhimin dhe monitorimin e mbrojtjes së deteve nga ndotjet dhe ndotësit me legjisacionin e BE;
  - mungesave në fonde për investime në shërbim të përmirësimin cilësisë së ujit të deteve në mbrojtje të njeriut, florës dhe faunës, aktiviteteve sportive, subjekteve privat, etj. ;
  - mungesës nga ana e Ministrisë Turizmit dhe Mjedisit, dhe AKB të hartës me vendet e derdhjes së ujërave të përdorura të trajtuara dhe të pa trajtuara si dhe e vendeve derdhjes së ujërave të ndotura në të gjithë vendin gjithashtu duke përcaktuar subjektet që derdhin ujërat e përdorura në det ose në gropa septike pranë bregut të deti. AKM është në procesin e përfundimit të hartës vendeve të derdhjes së ujërave të ndotura nga subjektet privatë në të gjithë vendin kështu:
    - ka zhvilluar një hartë me subjektet e identifikuar si ndotëse në lumenj,
    - vendet e derdhjes së ujërave të ndotura janë të përcaktuara me koordinata në lejet mjedisore,
    - identifikimi i subjekteve si ndotëse në lumenj është bërë nga Projekti "Identifikimi i burimeve të ndotjes në lumenjtë kryesorë të vendit dhe forcimi i kontrollit të ndotjes së lumenjve", gjatë vitit 2016.
  - mungesës nga ana e MTM të hartës vendeve të depozitimit të mbetjeve urbane në të gjithë vendin;
  - të mangësive në monitorimin e vendeve të derdhjes lumenjve në det si rezultat i mungesës hartës grykëderdhjeve tyre;
  - mungesës së informacionit nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të vendeve të kryerjes së veprimtarive ekonomike në det;
  - mungesës së informacionit nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe AKB të vendeve të kryerjes sportive ujore, turizmit

## Konkluzione:

- Trashëgimia është vlerë e përcjellë brez pas brezi. Ajo përbën vlerë të mjedisit natyror dhe, si e tillë, është natyrore, por edhe vlerë materiale e shpirtërore e shoqërisë dhe, si e tillë, është kulturore. Vlerat e saj mund të kenë rëndësi kombëtare dhe cilësohen si "Trashëgimi Natyrore Kombëtare". Ato mbrohen nga ligjet kombëtare. Çdo vend i kulturuar e cilëson dhe e trajton si të shenjtë trashëgiminë natyrore dhe kulturore, sepse me to është i lidhur identiteti kombëtar. Vazhdimisht trashëgimia natyrore kombëtare është kërcënuar dhe kërcënohet nga veprimtaria njerëzore mbi mjedisin dhe vlerat e tij. Kjo e ka bërë të domosdoshme gjetjen dhe aplikimin e mënyrave e rrugëve për mbrojtjen e saj;
- Legjislacionit është i rëndësishëm në të gjitha fushat ai shërben si rregullatori më i mirë i të gjithë marrëdhënieve në shoqërinë njerëzore pse jo dhe në atë të gjallesave të tjera që u binden verbërisht ligjeve të natyrës duke dhënë kështu një shembull të mirë dhe për ne qenien njerëzore që vetë natyra e solli në majë të piramidës ekzistenciale. Njohja, zbatimi dhe harmonizimi i legjislacionit është shumë i rëndësishëm sepse shërben si urë lidhëse midis institucioneve qendrore, pushtetit vendor dhe komunitetit, gjithashtu tre komponentët e mësipërm të legjislacionit sjellin besueshmëri, efikasitet, siguri dhe sukses. Është shumë e rëndësishme të krijohet një bazë e plotë ligjore për mbrojtjen e mjedisit detar si pjesë e natyrës, nëpërmjet zhvillimit të qëndrueshëm të saj dhe veçanërisht në:
- Përmirësimet ligjore kanë si qëllim t'u sigurojë atyre të cilëve iu drejtohet një rregullim sa më të saktë dhe të kuptueshëm të problemit që shqyrtohet duke ju përmbajtur rregullimit objektiv të rrethanave, referuar karakteristikave të identifikueshme, duhet të përmbajnë shprehje të qarta dhe të sakta të drejtave dhe detyrimeve dhe të ofrojnë një zgjidhje të qëndrueshme, e cila duhet të jetë:
  - në përputhje me Kushtetutën e vendit;
  - në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara dhe me angazhimet që rrjedhin nga pjesëmarrja e Shqipërisë në organizatat ndërkombëtare;
  - në përputhje me nocionet bazë të arsyes dhe logjikës;
  - praktike;
  - me sa më pak efekte të padëshirueshme anësore;
  - në përputhje e të drejtës së brendshme me acquis-në e BE-së është një tjetër qëllim që duhet të mbahet parasysh
  - sa më efçente nga pikëpamja e kostos, për sa i takon raportit mes qëllimit të legjislacionit dhe mënyrave që përdoren për ta arritur atë.
- Përshtatja, përmirësimet ligjore dhe hartimi i strategjisë për sistemin e mbrojtjes së deteve nga ndotjet dhe ndotësit bëjnë që ky sistem të ecin me ritmin e kohës, kushtimit të vëmendjes ndaj problematikave që e kanë shoqëruar në këto vitet e fundit duke e reformuar nëpërmjet adresim të plotë të fenomeneve që rregullojnë organizimin, funksionimin, institucionalizimit, rritjen e transparencës, përgjegjshmërisë dhe efektivitetit, të tij në funksion të transformimit të ujërave detar në një mjedis në përputhje me standardet më të lartat të BE.
- Kryerja e këtyre përmirësimeve është e rëndësishme duke patur parasysh atë që mbrojtja e ujërave të deteve nga ndotjet është e rëndësishme për qytetarët, nxit punësimin, zhvillon ekonominë, rrit turizmin që të kushtojnë më shumë burime për zhvillimin e forcës së punës si dhe për të siguruar monitorimin e tij që t'u përgjigjet gjithmonë e më mirë nevojave të individëve, punëdhënësve dhe ofruesve.



- Pa një sistem mëndje hapur menaxhimi të mbrojtjes së deteve nga ndotjet dhe ndotësit do të jetë i pamundur trajtimi dhe zgjidhja e shumë problemeve, të cilat kanë të bëjnë me mbrojtjen e shëndetit njeriut, zhvillimin e turizmit ujqor, mbrojtjen e florës dhe faunës detare zhvillimit të biznesit në det, etj.
- Përshtatja, përmirësimet ligjore dhe hartimi i strategjisë për sistemin e mbrojtjes së ujërave detarë, do të konsistojnë gjithashtu në garantimin e cilësisë së tyre, në përputhje me kërkesat e BE. Është shumë e rëndësishme kryerja e reformave të vazhdueshme në mirë menaxhimin të mbrojtjes së ujërave të deteve nga ndotjet në mënyrë të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse sepse ofron përfitime social-ekonomike të barabarta dhe për brezat e ardhshëm, sipas parimeve të politikave mjedisore të BE-së. Reformat institucionale kontribuojnë në efikasitetin e ndërmarrjeve që merren me ndotjet e deteve duke qartësuar çështjet e pronësisë dhe përgjegjësitë e menaxhimit si dhe për më tepër, duke rritur autonominë e tyre krijohet mundësia për rritjen e performancës;

### **Rekomandime:**

- ✓ Ministria e Turizmit dhe Mjedisit në bashkëpunim Agjencinë Kombëtare të Bregdetit, Agjencinë Kombëtare të Mjedisit dhe institucionet e saj të varësisë, të hartojnë strategji për mbrojtjen e deteve nga ndotjet ku të jenë përcaktuar objektivat drejtimet, politikat, në përputhje me drejtimet e strategjisë Qeverisë;
- ✓ AKB në bashkëpunim me Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe institucionet ligjvënëse, të marrin masa për përmirësimin e gjithë paketës ligjore, me një strukturë organizative që do të përshtatet kompetencave të reja të këtij institucioni, për administrimin dhe mbrojtjen e mjedisit bregdetar e detar nga ndotjet dhe ndotësit, zhvillimit të turizmit detar, mbrojtjes florës dhe faunës detare;
- ✓ AKB në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit të mundësojë plotësimin e strukturës së saj me personel infrastrukturë mbështetëse, logjistikë zyra, fonde, investime etj. etj., të mjaftueshëm për realizimin e mbrojtjes së deteve nga ndotjet dhe ndotësit;
- ✓ AKB në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, institucionet ligjvënëse, të marrin masa për unifikimin e të gjitha dispozitave të ndryshme ligjore në një ligj të vetëm për përcaktimin e saktë të vijës bregdetare duke bërë të mundur dhe shmangien e mbivendosje të kompetencave mes tyre në zbatim të ligjit 115/2014 “Për Ndarjen Administrativo-Territoriale të Njësisive të Qeverisjes Vendore”;
- ✓ AKB në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, institucionet ligjvënëse të kërkojë përmirësime ligjore për përputhje të plotë të kompetencave territoriale sipas ndarjes së re administrative në menaxhimin dhe ushtrimin e detyrimeve të plota për monitorimin e ndotjeve të ujërave detare sidomos gjatë brigjeve të detit;
- ✓ Ministria e Turizmit dhe Mjedisit në bashkëpunim me AKM, institucionet ligjvënëse të hartojë aktet nënligjore, rregullore, për shpalljen e zonave në rrezik, me qëllim reduktimin dhe parandalimin e ndotjes së ujërave nga substancat e dëmshme, në mbrojtjen e ujërave detare dhe ruajtjes florës dhe faunës detare;
- ✓ Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të realizojë auditime për të matur performancën e shërbimit të ofruar në mbrojtjen e deteve nga ndotësit dhe ndotjet si dhe realizimin e Raporteve të kontrollit të ruajtjes gjendjes natyrore të faunës dhe florës të ujërave detare dhe ndërkufitare;

- ✓ Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Bregdetit, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, të rrisin bashkëpunimin në mbrojtje të deteve nga ndotjet dhe ndotësit në drejtim të :
  - rritjes së përgjegjësiave për përmirësimin e sistemit të menaxhimit dhe monitorimit të ruajtjes deteve nga ndotjet;
  - evidentimit nga ana e Ministrisë Turizmit dhe Mjedisit të listës apo piramidës e shoqatave apo organizatave vendase dhe të huaja me detyrat përkatëse të cilën kanë projekte në monitorimin dhe ruajtjen e ujërave të detit nga ndotjet;
  - të përputhjes dhe përshtatjes legjisacionit për menaxhimin dhe monitorimin e mbrojtjes së deteve nga ndotjet dhe ndotësit me legjisacionin e BE;
  - të rritjes fondeve për investime në shërbim të përmirësimin cilësisë së ujit të deteve në mbrojtje të njeriut, florës dhe faunës, aktiviteteve sportive, subjekteve privat, etj.;
  - përcaktimit nga ana e Ministrisë Turizmit dhe Mjedisit, të hartës me vendet e derdhjes së ujërave të përdorura të trajtuara dhe të pa trajtuara si dhe e vendeve derdhjes së ujërave të ndotura në të gjithë vendin;
  - rritjes së përgjegjësiave në monitorimin e vendeve të derdhjes lumenjve në det si kjo dhe rezultat i mungesës hartës grykëderdhjeve tyre;
  - krijimit të një bazë të dhënash nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të vendeve të kryerjes së veprimtarive ekonomike në det;
  - krijimit të një bazë të dhënash nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe AKB të vendeve të kryerjes sportive ujore, dhe turizmit ujqor;

### **3.1.2 A garanton efektivitet sistemi i menaxhimit e monitorimit të detit nga ndotjet, turizmin natyror, kryerjen biznes, përfitim e të ardhurave, etj., në shërbim të njeriut, si trashëgimi natyrore që i përket brezave?**

Është e qartë se të gjitha strategjitë për mbrojtjen e mjedisit bëjnë thirrje për zvogëlim të ndotjes, ndonëse arritja e ndonjë përmirësimi të dukshëm nënkupton, që politikanët dhe publiku duhet të adresojnë çështjet ekonomike të ngritura nga kontrolli i ndotjes. Në një ekonomi të tregut, mallrat dhe shërbimet prodhohen si përgjigje ndaj kërkesës së konsumatorëve, e cila në shumicën e rasteve është e ndjeshme ndaj çmimit. Veç kësaj, debati mjedisor ka zbuluar se është vështirë të matet ndikimi i saktë i ndotjes, pasi që ndotja mund të dëmtojë shëndetin e disa njerëzve, gjë që do të kërkojë nga ata të kërkojnë trajtim mjekësor, i cili duhet të paguhet nga komuniteti i gjerë apo nga vetë individët varësisht nga sistemi i kujdesit mjekësor, përkundër kostos që ata e paguajnë për sa i përket vuajtjes. Pra, zvogëlimi i ndotjes bëhet në formë të kompromiseve në mes të ambientit të pastër të cilin e kërkon publiku, masës së përmirësimit të cilin industritë janë në gjendje ta arrijnë sa i përket teknologjisë dhe efektin e përgjithshëm të çmimeve dhe ekonomive kombëtare.

Pjesëmarrja e publikut në procesin e vendimmarrjes është vitale për demokracinë dhe shtetin e së drejtës. Pjesëmarrja në vendimmarrje krijon një urë komunikimi në mes të autoriteteve publike në një anë dhe qytetarëve në anën tjetër, në çështjet që përfshijnë interesin e përgjithshëm dhe publik. Përmes pjesëmarrjes së publikut në procesin e vendimmarrjes, qytetarëve ju sigurohet e drejta e pjesëmarrjes, të kontrollit dhe monitorimit të aktiviteteve dhe veprimtarive të organeve lokale dhe qendrore në çështjet që ndikojnë në jetën e tyre në kuptimin publik, ekonomik, social, shëndetësor dhe mjedisor. Një interaksion i tillë mundëson shkëmbimin e ideve dhe komenteve që janë relevante për autoritetet publike në procesin e dizajnit të programeve, dokumenteve dhe planeve të natyrës publike.

Ndërmjet këtij auditimi dëshirojmë të skicojmë dhe adresojmë rrugën për përmbushjen dhe plotësimin e përparësive strategjike gjithëpërfshirëse për mbrojtjen e ujërave detare nga ndotjet dhe ndotësit florën dhe faunën natyrore detare, e për të ndihmuar në zhvillimin e qëndrueshëm të menaxhimit; administrimit të integruar në strategjitë, politikat, planet, programet dhe veprimtaritë në nivel kombëtar, rajonal e vendor; konsiderimit të popullsisë të në zonat detare si faktor të rëndësishëm në realizimin e mbrojtjes dhe zhvillimit të kësaj pasurie kombëtare natyrore, duke i përfshirë ata në vendimmarrje dhe hartimin e planeve të administrimit të integruar për mbrojtjen e tij. Të gjitha këto bëjnë të mundur që, të nxisin zhvillimin e qëndrueshëm, sidomos të turizmit, biznesit, të rriten ndjeshëm të ardhurat e banorëve vendas, të përmirësohet cilësia e jetës së tyre dhe ruajtjen e ujërave detare si trashëgimi për brezat.

**\*\*\*\*\***

Shqipëria ka një vijë bregdetare me gjatësi rreth 500 km. Zona me ekskluzivitet ekonomik është rreth 12.000 km<sup>2</sup>. Bregdeti Adriatik është një fushe aluvionale 4-50 km e gjerë në përgjithësi ranore me një gjatësi prej 259 km. Në të hasen një serë deltash të vogla dhe lagunash të formuar nga derdhja e 9 lumenjve: Buna, Drini, Mati, Ishmi, Erzeni, Darci, Shkumbini, Semani dhe Vjosa. Disa nga deltat janë akoma aktive dhe në rritje. Janë katër gjire të rëndësishëm: Gjiri i Drinit, Rodonit, Lalzit dhe ai i Durrësit. Pjesa nga Durrësi deri në gjirin e Vlorës karakterizohet nga një bregdet i ulët aluvional dhe një ultësire aluvionale e gjerë e krijuar nga sedimentet e lumenjve Shkumbin, Seman, dhe Vjosë. Lagunat kanë një sipërfaqe totale prej 150

km<sup>2</sup>, një volum uji prej 350 milion m<sup>3</sup> dhe janë të një rëndësie të veçantë për peshkimin, turizmin dhe akuakulturën. Bregdeti i Jonit shtrihet në jug për 170 km nga Gadishulli i Karaburunit deri në kepin e Stillos. Kjo pjesë e bregdetit është kryesisht shkëmbore me shkëmbinj që bien thikë në det ku gjenden disa nga zonat natyrore më të pa paprekura. Akumulimet aluvionale hasen vetëm në plazhin e Palasës, Borshit dhe në afërsi të Liqenit të Butrint.


Ndotja në ujërat detare është ende një fushë jo shumë e hulumtuar në vendin tonë edhe për faktin se nuk ka një institucion kërkimor shkencor që merret drejtpërdrejtë me këtë punë. Kjo ka bërë të mundur që të dhënat merren nga një sistem i thjeshtë monitorimi mjedisor që kryesisht mbulon zonën bregdetare si edhe të dhënavë sporadike që vijnë nga projekte të ndryshme të mbështetur nga donatorët.

Prodhimi industrial në Shqipëri dhe në veçanti ai i lidhur me industrinë e nxjerrjes dhe përpunimit të mineraleve, prodhimin metalurgjik dhe atë kimik, ka patur një rënie drastike pas viteve 90, pasojë kjo e transformimeve politike, siç ndodhi dhe në vendet e tjera ish komuniste të Evropës Lindore dhe Qendrore. Shumica e teknologjive të përdorura përpara këtij viti është e vjetruar dhe jo konkurruese për ekonominë e tregut të lirë. Aktualisht, shumica e aktiviteteve industriale të përpunimit të mineraleve, si ato të gizës, çelikut, bakrit, plehrave kimike, kimikateve, lëkurës, tekstileve dhe të ushqimeve, të cilat para 1990 ishin aktivitetet kryesore që shkaktinin ndotje të mjedisit, tani janë mbyllur dhe shumë impiante prodhimi janë shkatërruar. Industria e mineraleve e sotme është përqendruar në nxjerrjen dhe përpunimin e hidrokarbureve, në nxjerrjen e materialeve të ngurta (gipsit, alabastër, argjilës, gurëve, mermer dhe kuarcit).

Gjatë viteve të fundit vendi e ka orientuar zhvillimin e tij ekonomik kryesisht drejt bujqësisë, mbarështimit të blegtorisë, industrisë ushqimore dhe turizmit. Në ditët e sotme aktivitetet ekonomike shkaktare të ndotjes së mjedisit janë prodhimi i ushqimit për blegtorinë, industria ushqimore, transporti dhe aktivitetet urbane. Aktivitetet urbane janë ndër kontribuuesit kryesore të ndotjes së elementeve mjedisore ajrit, ujit, tokës.

Shqipëria ka vetëm disa impiante të trajtimit të ujërave të ndotura urbane të ndodhur në Velipojë. Shëngjin, Durrës, Vlorë, Sarandë, etj., por në pjesën më të madhe ujërat e përdorura të gjeneruara nga qendrat urbane përfshirë këtu dhe Tiranën, shkarkohen në ujërat sipërfaqësore, duke përfunduar në Detin Adriatik dhe Jon, pa ndonjë lloj trajtimi.

Mbetjet inerte bashkë me ato të ngurta urbane, hidhen në zona të cilat nuk janë zgjedhur në mënyrë të përshtatshme si nga ana sanitare ashtu dhe ajo mjedisore. Në të njëjtat vende depozitimi shkarkohen jo vetëm mbeturinat urbane por dhe ato të rrezikshme. Bateritë e makinave, bateri të tjera dhe në disa raste dhe mbeturinat spitalore shkarkohen në të njëjtat vend-depozitime me ato të mbeturinave urbane. Këto vend-depozitime janë një kërcënim potencial për ndotjen e ujërave sipërfaqësore dhe atyre nëntokësore, dhe një burim i vazhdueshëm i ndotjes. Asnjë prej tyre nuk i përmbush parametrat për mbrojtjen e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, të ajrit dhe të tokës.



Në këtë hartë tregohen qartë gjendja shumë e keqe e venddepozitimeve të mbetjeve urbane të cilat janë nga ndotësit kryesorë të ujërave kështu një pjesë e konsiderueshme e tyre janë pranë bregut të detit dhe duhet të largohen kjo shënuar me të verdhe si dhe ato të shënuar më të kuqe duhen mbyllur sepse rezulton se ato janë kryesisht pranë lumenjve.

*Kërcënimet që vijnë prej përdorimit të brigjeve detare nga ana jonë ose e njeriut kështu:*

Ekosistemet detare shqiptare janë nën presion të konsiderueshëm. Risqet janë të lidhura me vlerën e brendshme të ekosistemeve, por edhe me humbjen e biodiversitetit dhe habitateve natyrore të cilat luajnë një rol kryesor në shëndetin e njerëzve, stilin e jetës, prodhimin e ushqimit dhe disponueshmërinë e burimeve natyrore për zhvillimin ekonomik dhe mirëqenien e popullatave bregdetare.

*Mungesa e Menaxhimit të Mbetjeve dhe ujërave të përdorura Përafërsisht 60% e popullsisë së*

Shqipërisë po jeton në zonat bregdetare. Ndotja e burimeve në zonat ujore bregdetare është ulur ndjeshëm, për shkak të mbylljes së pjesës më të madhe të industrive, por ka patur një rritje të ndotjes urbane në zonat bregdetare prej zhvillimit të turizmit kryesisht në bregdetin e Adriatikut dhe prej rritjes së numrit të banorëve në qytetet kryesore si Tirana dhe Durrësi. Ndërtimet turistike në zonën bregdetare nuk janë paraprirë ose shoqëruar nga infrastruktura e nevojshme si furnizimi me ujë dhe kanalizimi i ujërave të përdorura, mbledhja, transporti dhe eliminimi higjienik i mbetjeve të ngurta. Kjo situatë ka rritur sasinë e mbetjeve të ngurta. Pjesa më e madhe e ujërave të ndotura shkarkohen pa trajtim në det, edhe në vitet e fundit janë ndërtuar vetëm 3-4 impiante pastrimi të ujërave të përdorura.

*Ndikimet nga Bujqësia* Pas privatizimit të tokës, prodhimi bujqësor është ulur me ritme të shpejta. Nga njëra anë, ka patur migrim të njerëzve nga zonat rurale drejt atyre më urbane si dhe jashtë vendit, dhe nga ana tjetër ka patur rritje të shpenzimeve të lidhura me prodhimin bujqësor, duke ndikuar të dyja në uljen e prodhimit bujqësor. Një rezultat pozitiv është se përdorimi i kimikateve në bujqësi ka qenë goxha i kufizuar.

*Zhvillimi Bregdetar* Ndikimet e zhvillimit bregdetar (bujqësor, industrial, etj.) dhe urbanizimi janë ndër kërcënimet kryesore të cilat janë intensifikuar gjatë viteve të fundit. Ky ndryshim i rëndësishëm në rritjen demografike bregdetare kontribuon në degradimin e peizazheve, erozionin e tokës, rritjen e shkarkimit të mbeturinave në det, humbjen dhe fragmentimin e habitateve natyrore, si dhe përkeqësimin e gjendjes së specieve vulnerabël apo të rrezikuara. Zhvillimi i aktiviteteve në zonat bregdetare (industria e peshkimit, bujqësia, turizmi, urbanizimi) ka krijuar mundësi ekonomike, por gjithashtu ka ndikuar në nivelin e jetesës së banorëve të zonës.

*Zhvillimi i Akuakulturës* Akuakultura ushtron një trysni të lokalizuar dhe relativisht të fortë në mjedis në varësi të zonës dhe zhvillimit të saj. Akuakultura mbështetet nga shumë politika publike dhe ngre pyetje në lidhje me ndikimin e saj veçanërisht në mjedis, peshkim dhe në grupin e lëndëve të para shoqëruese të nevojshme për ta furnizuar. Zhvillimi i akuakulturës mund të rezultojë në humbjen e ose modifikime të habitateve të rëndësishme bregdetare. Përdorimi i ushqimit, antibiotikëve dhe akumulimi i ekskrementeve nga peshqit mund të kontribuojë në uljen e cilësisë së ujit. Kultivimi i peshkut ushtron trysni shtesë mbi burime peshkore dhe për disa peshq jep një rezultat të ulët duke konsideruar volumin dhe peshën e ushqimit që nevojitet për të ushqyer peshkun e kultivuar.

Është e rëndësishme marrja në konsideratë e ndjeshmërisë së sistemeve detare dhe bregdetare dhe balancimi i aspekteve socio-ekonomike dhe kulturore të grupeve tradicionale të interesit në një kontekst të tillë nën trysni, për të garantuar si aftësinë ri përsëritëse të këtyre ekosistemeve, ashtu edhe promovimin e praktikave të shfrytëzimit të qëndrueshëm të burimeve të ri përtëriteshe.

Pothuajse asnjë, apo shumë pak të dhëna dhe harta të shpërndarjes janë në dispozicion për pjesën më të madhe të habitateve dhe specieve, dhe kjo nuk lejon një vlerësim të besueshëm të statusit të mbrojtjes së tyre apo një bazë për monitorimin duke kufizuar kështu aftësinë për të identifikuar zonat me prioritet të menaxhimit, objektivat dhe synimin.

Një problematikë tjetër që është konstatuar nga auditimi dhe përgjigjet e pyetësorëve rezultojnë në shitjen dhe gatimin në restorante të “midhjes hurmë”. Vjelja dhe tregtimi i kësaj lloji midhje, (lat. Molusku lithofaga) apo ai që njihet ndryshe dhe me emrin dateri, e dëmton shumë mjedisin nënujor, shkëmbinjtë gëlqerorë dhe brezin koralor të vendit”. Ky fenomen konstatohet në masë të gjerë në subjektet që ushtrojnë aktivitetin kryesisht në Vlorë por edhe në qytetet e



Durrësit, Lezhës Sarandës pa përjashtuar Tiranën si kryeqytet megjithëse nuk ka det ato sillen nga vendet bregdetare. Shpesh prezenca e këtij produkti deti në menu justifikohet si jo i vjelë në bregdetin Shqiptarë, por i importuar nga vende të tjera si Greqia etj., gjë e cila duhet verifikuar nga institucionet kompetente. Nxjerrja e kësaj midhje nga fundi i detit të ujërave të bregdetit tonë sjell dëmtimin në mënyrë të pakthyeshme të shkëmbinjve koralore ku kjo specie rritet, aq më tepër që për kryerjen e këtij procesi përdoren lëndë plasëse, prandaj nevojitet marrja e masave të menjëhershme dhe kërkimi i bashkëpunimit nga të gjitha institucionet shtetërore, për zbatimin e ligjit që ndalon sikurse në gjithë Evropën gjuetinë dhe tregtimin e këtij lloj molusku. Kjo lloj guaskë midhje është e ndaluar me ligj të konsumohet, si në Shqipëri ashtu edhe në vendet evropiane, për shkak të problematikave që shkakton nxjerrja e tij, duke qenë se dëmtohen në mënyrë të pakthyeshme shkëmbinjtë korolor.

Gjithashtu ndotjet në fundin e detit vijnë edhe nga ushtrimi i aktivitetit të kultivimit të peshkut në det nga mbetjet që krijohen në fundin e detit ku vlen të theksohet se në bazë të informacioneve të marra kultivuesit e këtyre peshqve përdorin ushqime me më shumë yndyrë që peshku të rritet shpejt gjë e cila krijon shumë mbetje në fund të detit duke e dëmtuar shumë fundin e tij, prandaj është e mira që rezervate të tilla përpara se të jepen lejet përkatëse të ndërtohen në zona mirë studiuar dhe ku ujërat të lëvizin apo të ketë rryma detare dhe jo në gjire të mbyllura sepse i dëmtojnë ato.



*Një kërcënim tjetër janë dhe ndjeshmëritë nga ndryshimi i klimës kështu. Deti Mesdhe konsiderohet si një nga detet ku pasojat e ndryshimit të klimës do të jenë më të dukshmet në vitet që do të pasojnë. Shumë zona tashmë janë prekur nga këto ndikime, veçanërisht erozioni bregdetar nga ngritja e nivelit të detit dhe ndryshimet në reshje. Shumë shkencëtarë dhe frekuentues të detit kanë vëzhguar mbërritjen e evolucionit hapësinor-kohor të specieve të reja detare, disa prej të cilave janë pushtuese.*

Niveli i detit, temperatura, reshjet, dhe stuhitë pritet të ndryshojnë në mënyrë të ndjeshme me ndryshimet klimatike duke ndikuar drejtpërdrejt në lagunat bregdetare. Të gjitha ndikimet e rritjes së temperaturës, nivelit të detit, e stuhive, si dhe ndjeshmëria në modelet e motit ka gjasa që të ndikojnë tek komunitet e banoreve të cilat vlerësojnë praninë dhe rëndësinë e ekosistemeve të lagunës.

Një rritje e temperaturës në sipërfaqen e detit nuk ka gjasa që të ketë ndikim të drejtpërdrejtë negativ duke qenë se shumica e bimësisë detare, duke përfshirë bimën e Posidonia –s dhe Cymodocea-s, janë termofile. Gjithsesi, algat termofilike dhe ndoshta bimë të tjera detare mund të konkurrojnë në mënyrë aktive me speciet vendase. Produktiviteti i planktonit mund të bëhet

mjaft i shumëllojshëm në sistemet detare litorale dhe estuarinë, dhe ky ndryshim mund të ketë ndikime të ndjeshme në ekologjinë dhe produktivitetin e sistemit.

Komunitetet natyrore të lidhura me zona të ulëta bregdetare pritet që të lëvizin në brendësi të tokës për shkak të përmytjes graduale, për sa kohë ka hapësira të disponueshme të patrazuara për këtë migrim. Komunitete të caktuara, duke përfshirë dunat ekzistuese bregdetare, ligatinat e kripura kanë gjasa të reduktohen në sipërfaqe. Kanalet e pritshme më të hapura midis ligatinave bregdetare dhe detit në të ardhmen do të ndryshojnë ekosistemet aktuale, gradualisht drejt një ekosistemi tërësisht të kripur. Ndryshimet në këto zona ligatinash do të ndikojnë shumë specie shpendësh të cilat varen nga sistemet e njelmëta nëpërmjet humbjes së foleve, riprodhimit, dhe habitateve të dimërimit.

Aktivitetet e peshkimit përgjatë zonave të bregdetit të Shqipërisë tashmë janë prekur nga ndryshimet e klimës veçanërisht në dekadën e fundit. Eutrofikimi i disa prej zonave ligatinore, rritja e nivelit të detit dhe temperaturave të ujit e shoqëruar me një rritje të kriptomërisë kanë çuar në fenomene të pazakonta si zhvillimi i fitoplanktonit toksik. Për pasojë, në disa zona peshkimi të molusqeve, janë regjistruar shfaqje jonormale të niveleve të larta të fitoplanktonit toksik.

Specie të ndryshme të peshqve preferojnë temperatura të ndryshme për mjedisin e tyre të jetesës. Asnjë prej tyre nuk e mirëpret një ndryshim të menjëhershëm. Sa më shumë të zgjatë temperatura jo e mirëpritur, dhe sa më afër të jenë speciet ndaj kufirit maksimal të tolerancës termike, aq më shumë trysni psikologjike do të ketë mbi to. Nëse kjo trysni ndodh rregullisht, ajo mund të çojnë në ndryshime të shpërndarjes gjeografike të specieve apo të ciklit të jetës. Ndikimet e klimës gjithashtu mund të çojnë në zhdukjen e një specije dhe krijojnë hapësira për një specie tjetër që i përshtatet më mirë kushteve të reja (Harvell *et al.*, 1999, 2002; Hughes, 2000). Këto modifikime pa diskutim kanë pasoja negative si në ndërveprimet e specieve ashtu edhe në biodiversitetin, dhe modifikojnë dukshëm aspektin e peizazhit nënujor.

Adriatiku, i njohur për sasinë e peshqve pelagjikë, ka përjetuar një rënie të madhe në familjet e peshqve të vegjël midis viteve 1992 dhe 1995 (Bombace, 2001). Në vitet 1980', sasia e aqugës u reduktua ndjeshëm, nga një maksimum biomase prej 640,000 tonësh në vitin 1978 në rreth 16,000 ton në vitin 1987. Sipas Bombace, shkatërrimi i këtij lloji peshku nuk mund të lidhet me peshkimin mbi kapacitetet, por më shumë me ndryshimet në rrjetin trofik (d.m.th., ndryshimi i vendeve të peshqve në zinxhirin ushqimor), dhe, veçanërisht, kushtet hidroklimatike (Salat, 1996), që mund të kenë ndikuar në shkallën e mbijetesës të vezëve të aqugës dhe larvave të saj. Në disa raste, ndikimet mbi llojet e peshqve mund të rezultojnë në ndryshime në ciklin e jetës. Ky fenomen, ka të bëjë veçanërisht me speciet që shtegtonin në vjeshtë drejt habitateve të tyre të dimërimit, por që sot qëndrojnë më shumë në Mesdheun e veriut dhe atë qendror (Bombace, 2001). Ky është rasti, për shembull, i gofës (*Seriola dumerlii*), destinacioni dimëror i të cilit është zakonisht Mesdheu jugor, me një shtegtim drejt veriut në verë. Sot, ndodh mjaft shpesh që ky pelagjik i madh të qëndrojë deri në dimër në basenin e veriut. Po kështu, toni (*Thunnus thynnus*), një shtegtar nga Atlantiku, qëndron për një kohë të gjatë në veri dhe në qendër të Detit Adriatik, duke e servirur kështu veten ndaj peshkimit lokal në periudha më të gjata (Bombace, 2001).

Ndryshime drastike po ndodhin në ekosisteme të ndryshme mesdhetare, duke përfshirë komunitetet nënujore shpellore. Disa krustace që jetojnë në shpella po zhduken me shpejtësi. Rritja e masave mucilagjenore është gjithashtu një problematikë. Kjo specie misterioze është raportuar rregullisht në Detin Tiren dhe atë Adriatik gjatë 20 viteve të fundit. Origjina e këtyre fenomeneve ndryshon sipas basenit përkatës. Në ujërat eutrofike të detit Adriatik, këto masa mucilagjene prodhohen nga shfaqja e fitoplanktonit, i shkaktuar nga ndryshimet e papritura në



prurjet e lumit Po dhe përmbajtjet e elementëve ushqyes. Në detin Tiren, ajo që raportohet në shumicën e rasteve është përhapja e kontingjentit të algave fijezorë, por që mbetet mister shkaku i shfaqjes së tyre. Pavarësisht origjinës, duke u grumbulluar në shtratin e detit këto masa kanë ndikime të dëmshme për popullatat e fundit të detit (UNEP/MAP-RAC/SPA).

Ngjarje klimaterike ekstreme mund të shkaktojnë trysni të menjëhershme, e cila shqetëson funksionimin normal të një sistemi biologjik. Speciet ndryshojnë nga sasia e nxehtësisë që ato mund të durojnë. Ato reagojnë ndaj ndryshimeve të temperaturave nëpërmjet përshtatjeve psikologjike, biokimike dhe molekulare. Por, nëse kushtet janë të pa tolerueshme, dhe ato nuk mund të largohen, ato do të përfshihen nga sëmundjet dhe ngordhja. Speciet e brishta sessile, ato që fiksohen në një vend, rrjedhimisht ndikohen më shumë (UNEP/MAP-RAC/SPA).

Grupet e ndikuara janë kryesisht sfungjerët dhe knidarëve (një phylum i cili përfshin iriqin e detit, koralet dhe kandilin e detit), bryozoarët (“kafshët myshk”), molusqet dhe tunikatët/membranorët (ushqyes filtrues). Ndërmjet specieve më të prekura janë një pjesë e madhe e endemikëve mesdhetarë, disa specie me vlera të mëdha tregtare, dhe elementët bazë të ekosistemit që në disa raste mund të strukturojnë peizazhet (gorgoniat) (UNEP/MAP-RAC/SPA).

*Ndotësit dhe burimet e tyre :*

*Shkodra* Problemet kryesore mjedisore janë shkarkimet e ujërave e përdorura të pa përpunuara dhe mbeturinat e ngurta urbane. Qyteti i Shkodrës ka një sistem kanalizimesh të ujërave të përdorura që grumbullon 85% të ujërave të përdorura. Për momentin ujërat e përdorura shkarkohen direkt pa asnjë trajtim në lumin Drin diku para bashkimit të tij me Bunën.

*Lezha* Bujqësia është veprimtaria ekonomike kryesore. Disa aktivitete të tjera ekonomike janë peshkimi, përpunimi i peshkut, rritja blegtoriale dhe turizmi. Gjatë muajve të verës numri i banoreve të qytetit të Shëngjinit trefishohet nga turistët. Pika e hedhjes së mbeturinave për këto dy qytete është 1.5 km larg nga Lezha dhe është në kondita mjedisore dhe sanitare të papërshtatshme. Një pjesë e mbeturinave urbane, përfshirë mbeturina inerte nga ndërtimet dhe prishjet, hidhen përgjatë lumit Drin ose në liqenin e Kënellës.

*Kurbini* Qytetet e Laçit dhe të Milotit i hedhin plehrat në afërsi të lumit të Delbnisht, ndërsa Mamurrasi i hedh afër përroit të Drojës, rreth 1 km larg nga qyteti. Në rastet e vërshimeve të mëdha këta dy lumenj marrin me vete një pjesë të madhe të mbeturinave të hedhura. Në kompleksin kimiko-metalurgjik të Laçit janë të grumbulluara 300,000 ton mbetje të ngurta nga të cilat 70%  $Fe_2O_3$  dhe 20-22%  $SiO_2$ . Në dambën e uzinës së bakrit të këtij kompleksi gjenden 400,000 ton skorie. Këto skorie përmbajnë kryesisht hekur dhe oksid silici, por kanë edhe sasi të vogla seleniumi dhe arseniku. Uzina ka pushuar së funksionari në fillimet e viteve 90.

*Durrësi* Aktivitetet industriale u pakësuan në mënyrë drastike gjatë viteve 1990-1992. Në ditët e sotme prodhimi industrial është i orientuar kryesisht drejt përpunimit të qumështit, prodhimit të cigareve, pijeve alkoolike, konfeksioneve dhe mobileve. Durrësi është qendra kryesore turistike e vendit. Ngarkesa bakteriale në zonën e plazhit është gjetur shumë e lartë gjatë periudhës së verës. Ujërat e përdorura të qyteteve të vogla si Shijaku dhe Sukthi shkarkohen direkt në lumin Erzen që derdhet në detin Adriatik në gjirin e Lalzit.

Cilësia e ujit në plazhet që nuk kanë shkarkime direkte ujërash të përdorura është brenda normave të lejuara për plazhet.

Porti i Durrësit dhe zonat në afërsi të tij janë të ndotura nga shkarkime të paligjshme nga anijet. Ndotësit janë kryesisht me origjinë organike (karburante dhe vajra). Një burim tjetër ndotjeje për zonën e Durrësit janë plazhet me një shtrirje prej 20 km. Ndërtimet e shumta turistike gjatë 10 vjetëve të fundit të cilat nuk u shoqëruan me infrastrukturën e nevojshme sidomos

kanalizimet dhe trajtimi i ujërave të përdorura, janë bërë shkak për një ndotje serioze të gjithë vijës së plazheve. Plehrat hidhen në Porto Romano në një zonë në afërsi të detit. Mbeturinat nuk trajtohen dhe djegia e tyre është e zakonshme. Kulesa e fushës së plehrave rrjedh në të njëjtin kanal me ujërat e përdorura dhe përfundon në det. Plehrat e Shijakut dhe Sukthit hidhen në shtratin e Erzenit duke rritur me tej nivelin e ndotjes së këtij lumi.

*Kavaja* Aktiviteti ekonomik kryesor është bujqësia. Industria është shumë pak e zhvilluar dhe përfaqësohet vetëm me disa punishte të vogla ushqimore dhe për përpunimin e qumështit. Janë prezentë dhe disa aktivitete të vogla të nxjerrjes së materialeve të ndërtimit. Në jug të qytetit të Kavajës në afërsi të lumit të Darcit janë dy fabrika të vogla të regjies/përpunimit të lëkurës. Ujërat e këtyre fabrikave shkarkohen në lumë i cili derdhet në detin Adriatik.

Aktualisht vetëm 30% e popullsisë së Kavajës është e lidhur me kanalizimet e ujërave të përdorura. Parametrat e ujërave të përdorura për këtë qytet ashtu si edhe për shumë qytete të tjera në Shqipëri nuk janë matur dhe nuk dihen. Ujërat e përdorura shkarkohen në përroit e Leshnicës që derdhet në det në afërsi të plazhit të Golemit. Në verë prurja natyrale e këtij përroi është me pak 100l/sekonde gjë që bën që ngarkesa relative e ndotjes në këtë përrua të rritet ndjeshëm duke rritur rrezikun për shëndetin e pushuesve në plazhin e Golemit. Plehrat hidhen në pjesën juglindore të qytetit në një fushë mbeturinash që nuk përmbush asnjë standard sigurie mjedisore dhe sanitare.

*Rrethi i Tiranës* Tirana vetë nuk ka dalje në det por është qendra kryesore ekonomike dhe tregtare në vend. Aktivitetet kryesore industriale janë: industria ushqimore, konfeksionet, këpucët, tulla dhe materialë të tjera ndërtimi. Shumë aktivitete janë në brendësi të qytetit dhe shkarkojnë ujërat e tyre teknologjike në rrjetin e ujërave të përdorura urbane. Një pjesë e aktiviteteve ekonomike shkarkojnë ujërat e tyre të ndotura në përroit e Lanës po ashtu dhe një pjesë e qytetit.

Sistemi i kanalizimit të ujërave të përdorura mbulon 89% të banoreve. Një pjesë e madhe e rrjetit të kanalizimeve është rreth 40 vjeçare dhe punimet mirëmbajtëse janë të pamjaftueshme. Vetëm 20% e rrjetit ka kapacitet të mjaftueshëm për të përballuar prurjet e larta në rastet e reshjeve të dendura. Volumi total i ujërave të derdhura në lumin e Tiranës dhe përroit e Lanës në pika të ndryshme llogaritet të jetë mbi 2000l/sek. Lumi i Tiranës dhe Lana përfundojnë në detin Adriatik.

Mbetjet urbane hidhen në pikën e Sharrës, rreth 5 km nga qendra e qytetit në një luginë që rrjedh në lumin Erzen. Vend-depozitimi i Sharrës është një zonë 400 x 150 metra. Mbetjet hidhen në këtë gropë pa asnjë trajtim paraprak dhe vetë djegia është një fenomen konstant. Tymi i çliruar përmban një disa substanca kimike helmuese që mund të kenë ndikim negativ në shëndetin e banoreve që jetojnë në afërsi të kësaj fushe. Instituti i Shëndetit Publik llogarit që sasia e dioksinave dhe furaneve të çliruara në atmosfere nga djegia e plehrave është e barabartë me shkarkimet e këtyre ndotësve nga gjithë rrethet e tjera të marra së bashku. Si rezultat i mungesës së impianteve për trajtimin e mbeturinave të rrezikshme në Sharre përfundojnë gjithë llojet e mbeturinave përfshirë edhe ato industriale, të ndërtimit dhe ato spitalore.

*Lushnja* Historikisht rrethi i Lushnjës është dalluar për prodhime bujqësore dhe në të kaluarën ka qenë prodhuesi kryesor i drithërave. Aktivitetet e vetme industriale të një rëndësie të veçantë kanë qenë fabrika e letrës që përdorte si lëndë të parë kashtën e grurit dhe Plastika Lushnjë. Të dy këto fabrika u mbyllën në vitin 1991. Aktualisht prodhimi industrial konsiston në disa fabrika përpunimi qumështi dhe disa punishte ushqimore dhe një fabrikë tullash.

Volumi i ujërave të përdorura derdhen të papërpunuara, gjithashtu mbeturinat hidhen në një sipërfaqe prej 2.5 ha në një zonë 1 km larg nga rrethinat e qytetit dhe gjithë ujërat sipërfaqësore

të kësaj fushe plehrash rrjedhin në përroin e Lunjes i cili përfundon në detin Adriatik. Divjaka është një qytet i vogël me rreth 10,000 banorë. Kjo qendër e banuar ndodhet në afërsi të Pyllit të Divjakës, Lagunës së Karavastasë e cila është shpallur zone RAMSAR. Ky qyteti gjeneron rreth 300 m<sup>3</sup> ujëra të përdorura dhe rreth 7 ton mbeturina të ngurta në ditë. Nuk ka ndonjë zonë të përcaktuar për hedhjen e mbeturinave të cilat hidhen përgjatë rrugës që lidh qytetin me parkun kombëtar të Divjakës. Studimi i kryer për piken e grumbullimit të plehrave për qytetin e Divjakës dhe plazhin nuk është zbatuar për mungesë fondesh.

*Rrethi i Elbasanit* Ndodhet në pjesën qendrore në brendësi të vendit. Ky qytet nuk ka dalje direkt në det por ka qenë dhe është një nga rrethet më të industrializuara. Përpara vitit 1991 ka pasur kryesisht aktivitetet industrial si metalurgjik, fabrika kimike, përpunim nafte, prodhim çimentoje, tulla dhe industri ushqimore. Në qytetin e Elbasanit u ndërtuan sipërfaqet më të mëdha me sera. Në ditët e sotme janë në prodhim vetëm një pjesë e kapacitetit të uzinës së prodhimit të çelikut nga skrapet, fonderia e prodhimit të Fe-Cr dhe fabrika e çimentos.

Si rezultat i aktivitetit të reduktuar industrial situatat mjedisore është përmirësuar. Në mënyrë të veçantë ka pasur përmirësim cilësia e ujit në lumin Shkumbin. Aktivitete të tjera industriale në këtë rreth janë ato të përpunimit të qumështit, përpunim druri, prodhimi i vajit të ullirit, prodhimi i birrës dhe konfeksionet.

Ujërat teknologjike dhe ujërat e ndotura urbane shkarkohen në lumin e Shkumbinit në disa pika përgjatë rrjedhës. Kanalizimet mbulojnë rreth 80% të banesave në qytetin e Elbasanit. Analizat kimike dhe bakteriologjike të Shkumbinit kanë treguar nivele të larta ndotje kryesisht me origjinë organike, nitrate dhe fosfor si dhe nivele të larta të *E. Coli*. Niveli i ndotjes ulët mjaft disa kilometra poshtë rrjedhës si rezultat i aftësive vetë pastruese të rrjedhës lumore.

Nga studime të kryera nga Universiteti i Tiranës në grykëderdhjen e Shkumbinit, Semanit dhe Vjosës janë gjetur nivele shume të larta të Cr dhe të Ni. Shpjegimi i këtyre fakteve kërkon studime të mëtejshme, por mendohet se duhet të atribuohet transportit të materialeve të errodura nga formacionet në të cilat këto lumenj rrjedhin.

*Fieri* ashtu si edhe rrethi i Elbasanit, gjatë viteve të regjimit komunist ka qenë një nga rrethet më të industrializuara. Në të kaluarën aktivitetet kryesore industriale ishin industria kimike (tre fabrika prodhim plehrash azotike), nxjerrja e naftës (2000 puse nafte), dy rafineri nafte dhe një termocentral me nafte dhe gaz, si dhe shumë fabrika prodhim ushqimesh. Në ditët e sotme janë aktive vetëm një numër i vogël i këtyre fabrikave të cilat punojnë me një kapacitet të kufizuar. Rrafineria e vetme e naftës akoma aktive në Shqipëri është ajo e Ballshit. Të tre fabrikat e plehrave kimike janë mbyllur qysh nga viti 1991 dhe po këtë fat ka pasur dhe shumica e industrive ushqimore.

Zona e Patos Marinzës në të cilën ndodhen 2000 puset e naftës vazhdon të jetë mjaft e ndotur. Nafta e shkarkuar në mjedis për dhjetëra vite me radhë ka ndotur tokën dhe lumi i Gjanicës që rrjedh në këtë zonë është një nga lumenjtë më të ndotur në Shqipëri. Fshatrat dhe qyteti i Ballshit që ndodhen në këtë zonë janë nën veprimin e vazhdueshëm të këtyre ndotësve. Rafineria e naftës në Ballsh përdor një teknologji të vjetër që shkakton shkarkimin e gazrave helmues në atmosfere dhe të ujërave të ndotura teknologjike në ujërat sipërfaqësore. Studimi i UNEP e ka klasifikuar zonën e Patos-Marinzes dhe rafinerinë e Ballshit ndërmjet zonave më të ndotura në Shqipëri.

Bazuar në llogaritjet e bëra nga kompanitë që merren me nxjerrjen e naftës, sasia e naftës që derdhet në mjedis në zonën e fushës naftëmbajtëse është 4-8 t/ditë. Llogaritjet që rafineria e Ballshit shkarkonte në lumen e Gjanicës në një vit një sasi prej 22,500 ton naftë. Sasia e ujërave teknologjike të shkarkuar në Gjanice pas trajtimit në impiantin e trajtimit është 250 m<sup>3</sup>/ore. Një sasi kaq e madhe nafte e shkarkuar në lumen e Gjanices ka demtuar rëndë jetën në këtë

lumë si dhe ka depërtuar në shtresat ujëmbajtëse që përdoren nga fshatrat e zonës përgjatë rrjedhjes.

Në një nga fabrikat e prodhimit të plehrave kimike, megjithëse inaktive tashmë prej me tepër se 10 vjet, gjendet një stok prej 850 m<sup>3</sup> solucion kripërash të arsenikut me një koncentrim prej 25-30 gr/l As. Mendohet se jo vetëm toka dhe ujërat sipërfaqësore janë tashmë të kontaminuar me arsenik, por edhe shtresat ujëmbajtëse nëntokësore duhet të jenë ndotur me arsenik. Vendodhja e kësaj fabrike është pranë lumit të Gjanices dhe mostra tokë të marre rreth 50 metra larg nga kollonat ku ruhet arseniku, kanë pasur nivele arseniku dhjetë herë më të larta se nivelet e lejuara të këtij elementi në tokat industriale. Kjo fabrike është identifikuar nga UNEP si një ndër pikat e nxehta të ndotjes në Shqipëri.

Rrjeti i kanalizimeve të ujërave të përdorura mbulon rreth 80% të ndërtesave. Me këtë rrjet janë të lidhur gjithashtu disa fshatra në afërsi të qytetit. Fshatrat e tjera i shkarkojnë ujërat e përdorura në kanalet kulluese/vaditëse që derdhen në lumin e Gjanicës, Semanit ose direkt në det. Regjistrohën mbi 50 pika shkarkimesh të ujërave të përdorura në lumin e Gjanicës me një prurje totale maksimale prej 700 l/sek. Llumrat e gropave të përdorura në shumicën e rasteve derdhen në Gjanice ose në kanalet vaditëse. Ka disa raste kur ky llum përdoret si pleh organik në bujqësi.

Analizat e ujit të lumit të Gjanices kanë treguar një shkallë të lartë ndotje nga nafta, amoniaku, nitratet, fosfatet, lëndë pezull dhe *E. Coli*. Niveli i ndotjes në lumin Seman, pas bashkimit me Gjanicës është ndjeshëm më i ulët edhe për arsye të faktorit hollues nga ujërat e Semanit.

Mbeturinat e ngurta urbane për qytetin e Fierit përfshirë këtu dhe mbeturinat që vijnë nga aktivitetet tregtare në qytet hidhen tek pika e hedhjes së plehrave është 5 km larg nga qendra e qytetit në një zone prej 10.5 ha.

*Vlora* Rrethi i Vlorës shtrihet në kufirin ndarës midis zonës veriore dhe asaj jugore të zonës bregdetare dhe laget nga deti Adriatik dhe ai Jon njëkohësisht. Në Vlorë përpara vitit 1991 kishte të zhvilluar industrinë kimike, material ndërtimit, atë ushqimore dhe energjetike. Pothuajse të gjitha këto industri në ditët e sotme nuk janë në prodhim. Aktualisht në rrethin e Vlorës funksionojnë disa fabrika konfeksionesh, prodhim këpucësh, nxjerrje mermeri, pijesh alkolike dhe prodhim vaji ulliri.

Aktiviteti më i rëndësishëm industrial përpara vitit 1990 ka qenë fabrika e prodhimit të sodës (chlor-alkali) dhe PVC e cila tashmë është krejtësisht e shkatërruar dhe jashtë prodhimit. Territori i kësaj fabrike ndodhet në veri të qytetit të Vlorës. Një nga prodhimet e kësaj fabrike ishte soda elektrolitike ku si rezultat i teknologjisë së vjetër dhe mungesës së mirëmbajtjes kishte shkarkime të mëdha të merkurit në mjedis. Nivele të larta të zhivës regjistrohën edhe sot në toke, ujin e detit, ujërat nëntokësore dhe ajrin në afërsi të fabrikës.

*Saranda* Aktivitetet kryesore në këtë rreth janë turizmi, bujqësia dhe tregtia. Ujërat e përdorura përmes një kanali derdhen në kanalin e Çukës dhe me pas në detin Jon. Aktualisht uji i ndotur derdhet në gjirin e Sarandës afër qytetit. Mbetjet e ngurta urbane depozitohen të pa trajtuara në një vend afër Volloderit, rreth 6 km në lindje të Sarandës.

Kështu për sa më sipër mund të themi se shumica e shumë dukurive që vihen re në zonën detare e bregdetare mbesin në nivelin e konstatimeve pasi vlerësimet sasiore të shkallës së ndotjes në zonën bregdetare janë të vështira për tu realizuar. Monitorimi i elementeve mjedisore nuk është i plotë si në parametra ashtu dhe në hapësirë dhe kohe, si rezultat i kufizimeve financiare me të cilat ballafaqohen institucionet. Po e njëjta mund të thuhet lidhur me studimet mbi impaktin mjedisor në bregdet.

*Zonat ujore janë të rrezikuara edhe nga aktivitetet që zhvillohen në tokë kështu:* Ekosistemi detar, megjithëse i dëmtuar pa dyshim nga shkarkimet e pakontrolluara të ujërave të ndotur nga burimet më bazë në toke, është përgjithësisht në një gjendje të mirë dhe vlerat e tij ekologjike dhe ekonomike mund të jenë të konsiderueshme.

Zhvillimi social-ekonomik i vendit gjatë dhjetë vjetëve të fundit është reflektuar gjithashtu në gjendjen mjedisore të zonës bregdetare. Mbyllja e shumë sektorëve potenciale të ekonomisë së Shqipërisë gjatë viteve të para të dekadës së fundit të shekullit të njëzetë, si nxjerrja e mineraleve dhe industria e përpunimit, metalurgjike, kimike, nxjerrja dhe përpunimi i naftës, letra, dhe materialet e ndërtimit, shkaktuan një rënie drastike të prodhimit industrial. Gjendja e re shkaktoi një ulje të standardit të jetesës së njerëzve, kryesisht të asaj pjese të popullatës, që u prek nga mbyllja e vendeve të punës.

Ky fenomen ishte më i theksuar në veri, në pjesën verilindore, dhe juglindore të vendit ku ishin vendosur shumë aktivitete industriale dhe në veçanti nxjerrja dhe përpunimi i mineraleve dhe aktivitete metalurgjike. Në të njëjtën kohë mundësia për burime alternative për mbijetesë është akoma e kufizuar.

Gjatë vjetëve të tranzicionit një fenomen e ri lindi si migrimi i pakontrolluar i popullsisë nga zonat e përmendura më sipër në zonën bregdetare duke përfshirë Tiranën. Në periferitë e qyteteve kryesore mijëra banesa u ndërtuan pa infrastrukturën e nevojshme (rrugë, burime ujore, kanalizime ujërash të përdorura, transport dhe hedhjen e mbeturinave të ngurta).

Erozioni është një ndër faktorët më problematikë që prek më shumë se 1/3 e bregdetit Adriatik. Përveç faktorëve natyrore, ai është favorizuar kryesisht nga aktiviteti njerëzor që konsiston në:

- ndërtimi i digave për hidrocentrale ose rezervuarve për përdorim bujqësor, që ka ulur sasinë e lëndës pezull të transportuar nga lumenjtë në bregdet;
- shfrytëzimi i inerteve nga shtretërit e lumenjve për ndërtime;
- devijimi i rrjedhës së lumenjve për bonifikime ose qëllime bujqësore.

Zona bregdetare në të gjitha plazhet e saj janë “sulmuara” nga ndërtimet e paligjshme, të cilat nuk u paraprinë nga plane urbanistike dhe infrastrukturën respektive, veçanërisht përse i përket kanalizimeve dhe trajtimit të ujërave të përdorura dhe menaxhimit të mbetjeve të ngurta dhe urbane. Të gjitha ndryshimet ekonomike dhe sociale janë reflektuar në gjendjen e përgjithshme të mjedisit të vendit në veçanti të zonës bregdetare dhe mjedisit ujor.

Ndotësit e ndryshëm industriale, kryesisht nga industria kimike, metalurgjike, nafta dhe letra, janë reduktuar aktualisht vetëm në disa pika të nxehta, që gjenerojnë ndotje, nga mbetjet e akumuluar gjatë viteve të punës të industrive respektive.

Nga ana tjetër, si rezultat i rritjes së numrit të banorëve në zonën bregdetare, turizmit dhe aktiviteteve tregtare, ka një rritje të sasisë dhe ngarkesës ndotëse së ujërave të ndotura, të shkarkuara në kanalet, lumenjtë dhe lagunat bregdetare dhe direkt në det. Veçanërisht gjatë verës, ka një ndikim në rritje të prezencës njerëzore, kryesisht të reflektuar në mbetjet e ngurta urbane, përgjatë plazheve kryesore (Durrës, Vlorë, Sarandë, Divjakë, Shëngjin, Velipojë) si pasojë e pranisë së madhe të turistëve.

I gjithë sistemi i lagunave është i kërcënuar në afat kohor të gjatë nga sedimentimi, mbushje me llum, fenomeni i anaerobise hipertrofike, ndotja industriale dhe ajo shtëpiake.

Ndryshimet në modelin e konsumit të produkteve ushqimore dhe të mirave, bumi i importit të tyre, kanë rritur dhe modifikuar sasinë dhe strukturën e mbetjeve urbane të ngurta.

Në përgjithësi, përbërja e këtyre mbetjeve nuk kufizohet vetëm në mbetjet shtëpiake dhe aktivitete tregtare, por pothuajse në të gjithë qytetet e mëdha dhe të vogla të Shqipërisë, në mbetjet urbane të ngurta përfshihen mbetjet nga aktivitetet të tjera ekonomike, materialet

ndërtimi dhe gjithashtu edhe mbetjet spitalore.

Sistemi i grumbullimit, transportit dhe depozitimit të mbetjeve të ngurta urbane është akoma larg persa i përket parametrave të shëndetit njerëzor dhe atyre të mbrojtjes së mjedisit. Aktualisht në shumicën e qyteteve të mëdha dhe të vogla në Shqipëri, mbetjet e ngurta urbane depozitohen në vende jo të përshtatshme nga pikëpamja higjienike dhe mjedisore. Asnjë nga fushat e plehrave nuk është përzgjedhur duke u bazuar në kriteret shëndetësore dhe mjedisore. Shpëlarjet nga vend-depozitimet e plehrave shkojnë në ujërat sipërfaqësore dhe ujërat nëntokësore, duke përfshirë edhe detin.

Përgjegjësia për menaxhimin e ujërave të përdorura dhe mbetjeve të ngurta urbane, sipas ligjit të ri për kompetencat e njësisve të qeverisjes vendore që hyri në fuqi në Janar 2003, transferohet nga Ministria tek Bashkitë dhe Komunat. Draft ligji për menaxhimin e mbetjeve të ngurta përmban disa masa strikte të lidhura me përgjegjësitë e qeverisjes vendore në menaxhimin e mbetjeve. Një program kombëtar duhet të zbatohet në vend-depozitimet e ekzistues të mbetjeve, për të reduktuar ndotjen sa më shumë që të jetë e mundur deri në mbylljen e tyre përfundimtare.

Kjo përgjegjësi e re menaxhimi për qeverisjen vendore kërkon mbështetjen e nevojshme me burime njerëzore dhe financiare dhe masa respektive për kuadrin rregullator ligjor dhe institucional.

*Ndikimi i burimeve ndotëse me bazë në tokë (BNT) në ekosistemin e bregdetit Adriatik* Fatkeqësisht, studimet rreth vlerave dhe degradimit eventual të ekosistemit detar janë të rralla dhe një inventar i përgjithshëm nuk është kryer asnjëherë. Duke parë që ndotja industriale tani është aktive kryesisht në pikat e nxehta, burimet kryesore të ndotjes të ujërave bregdetare janë ujërat e ndotura urbane dhe mbetjet e ngurta urbane. Kjo e fundit shkaktohet nga rrjedhjet e vend-depozitimeve të plehrave ose nga hedhja direkt e këtyre mbetjeve të ngurta në shtretërit e lumenjve.

Pak njohuri ka për mjedisin detar përgjatë Bregdetit Adriatik dhe për efektet e ndotjes për 30 vjetet e fundit, nga shkarkimi në det i lumenjve të ndotur si dhe nga shkarkimi direkt i ujërave industriale dhe urbane të ndotura të pa trajtuara. Me përjashtim të zonave të vogla gjatë bregdetit në afërsi të qyteteve të mëdha dhe zonave industriale, inspektimi tregon ujëra vizualisht të qarta dhe të pa ndotur. Megjithatë, kërkime sistematike në ekosistemet detare dhe efektin e ndotjes nuk janë kryer.

Problemi i ndotjes në mjedisin detar bëhet akoma me serioz sepse deti Adriatik është lehtësisht i ekspozuar ndaj ndotjes për shkak të shkëmbimit të kufizuar të ujit dhe bregdetit të gjatë. Zonat me kushte stanjante ose pjesërisht stanjante janë veçanërisht të ndjeshme ndaj ndotjes për shkak të shkëmbimit të ngadaltë të ujit.

Pasurimi i ujërave natyrore me lëndë ushqyese (eutrofikimi), kryesisht azot në ujërat detare por gjithashtu fosfor, është shoqëruar me rritjen e prodhimit të algave parësore dhe rritje të algave shqetësuese në zonat bregdetare dhe zonat e deteve të mbyllura dhe gjysmë të mbyllura. Ngarkesa të rritura të ushqyesve në disa zona të ujërave bregdetare, kanë shkaktuar eutrofizim në rritje dhe burimet kryesore të lëndëve ushqyese në ujërat bregdetare janë nga shkarkimi i ujërave të përdorura.

Pasojat e eutrofikimit mund të risin frekuencën e lulëzimit të algave (disa herë toksike), rritjen e turbullirës së ujit, shtimin e llumit, mungesën e oksigjenit në ujërat e thella dhe ngordhjen masive të peshqve dhe faunës bentike. Shenja të një eutrofikimi të tillë mund të vërehen në gjirin e Sarandës, Shëngjin, Liqenin e Kënells dhe gjirin e Porto Romanos.

Laguna e Kune-Vainit është një zone e mbrojtur e rëndësishme për vlerat e veta të pasura natyrore. Aktivitetet ekonomike në qytetin e Lezhës, aktiviteti bujqësorë intensiv i zhvilluar në

zonën aluviale si dhe rritja progresive e popullsisë dhe ndërtimet e ardhshme, përfaqësojnë rrezik potencial për ekuilibrin natyror dhe për ruajtjen e biodiversitetit dhe ekosistemeve ujore. Efektet e kontaminimit të ujërave të lagunës mund të ndodhin gjithashtu nga ujërat sipërfaqësore, nga kullimi i fushave bujqësore dhe stacionet e pompimit të instaluar për të mbajtur të kulluara fushat pas rënies së shirave, mund të rrisin rrjedhën e kontaminuesit. Si pasojë në ujërat e lagunës mund të ndodhe procesi i eutrofikimit.

Të dhënat e kufizuara për lagunën e Karavastasë kanë treguar që është në një gjendje serioze eutrofikim. Shkaqet duket duhen gjetur në reshjet që bien në zonën e pellgut ujëmbledhës, që nga profilet e lëndës organike në sedimente, nuk duket të jetë një fenomen i kohëve të fundit.

Gjendja e eutrofizimit të lagunave është rreziku me serioz për peshkimin, meqenëse në një sistem ku temperaturat e ujit janë gati mbi 30°C në qershor, risku i hipereutrofizimit, që çon në një krizë anaerobike, është shumë i lartë.

*Impakti i burimeve ndotëse me bazë në tokë BNT në ekosistemin e bregdetit të Jonit Në të gjithë gjatësinë prej 170 km të detit Jon vetëm dy zona konsiderohen të ndotura nga aktivitetet urbane dhe industriale: gjiri i Vlorës dhe gjiri i Sarandës.*

Ekosistemi i gjirit të Vlorës ka qenë nën ndikimin e aktiviteteve industriale dhe urbane të qytetit të Vlorës prej disa dekadash. Gjatë 10 viteve të fundit ndotjet e shkarkuara në gjiri kanë qenë kryesisht të përbëra nga ujërat e përdorura dhe në disa raste nga derdhja ilegale e ujërave të larjes nga anijet në port apo të akostuara në gjiri.

Është e njohur ndotja me merkur në zonën industriale në pjesën veriore të qytetit. Disa vërtetime të kryera nga eksperte shqiptarë, kanë demonstruar vlerat e larta të merkurit në toke në zonën industriale (ish uzina e sodës-PVC), dhe gjithashtu edhe në sedimentet në det në gjirin e Vlorës, përballë zonës. Të njëjtat vërtetime në biotë kanë treguar gjithashtu të njëjtën dukuri. Megjithatë duhet të nënvizohet edhe një herë se lidhur me impaktin e BNT-ve në gjirin e Vlorës të dhënat e monitorimit gati mungojnë sikurse edhe në pjesën tjetër të bregdetit të Shqipërisë.

Një problem tjetër që mund të krijojë impakte negative në mjedisin detar është shkarkimi i mbetjeve të ngurta të transportuara në det nga përrenjtë dhe lumenjtë. Vërtimet e kryera nga zhytësit amatore në gjirin e Vlorës dhe të Sarandës flasin për masa të mbetjeve plastike dhe metalike. Në disa zona të këtij gjiri është zhdukur *Posidonia oceanica*. Degradimi i livadheve detare është më i dukshëm në gjirin e Sarandës.

Në një sipërfaqe tjetër në afërsi të portit të Vlorës, përballë Akademisë së Marinës, në një thellësi 5-6 m është gjetur një livadh në gjendje të degraduar. Në këtë zonë është gjetur gjithashtu një lloj ekzotik me origjinë tropikale, *Caulerpa racemosa*, që është i ri për këtë mjedis. Kjo bimë e dëmshme eliminon *Pocanica*, e cila është tipike për këtë zonë. Shtrirja e *Caulerpa racemosa* bazuar në kërkimet paraprake mund të shkaktojë ndryshime të dukshme në habitatin detar.

Rreth 600 specie detare jo-indigjene kanë arritur në ujërat bregdetare të Evropës nëpërmjet transportit detar, akuakulturës dhe aktiviteteve të tjera njerëzore. Në pellgun e Mesdheut 500 nga llojet e përmendura më lart kanë arritur kryesisht përmes kanalit të Suezit, ndërsa me pak se 100 lloje dihet se kanë ardhur nga brigjet e oqeanit Atlantik, detit të Veriut dhe detit Balltik. Transporti detar është mënyra kryesore e ardhjes së këtyre llojeve ndërsa akuakultura radhitet e dyta.

Livadhet e popullatave të *Posidonia oceanica* janë reduktuar për shkak të modifikimit të përbërjes së sedimenteve nga shkarkimet e ndotjeve industriale dhe urbane në këto zona, sidomos në zonën Sarandë-Ksamil. Kjo është shoqëruar me rritjen e turbullirës së ujit që redukton

ekspozimin e fundit të detit ndaj dritës duke ndikuar në reduktimin e livadheve të *Posidonia oceanica* në dekadat e fundit. Në zonat detare me një përmbajtje të ulët ushqimore një shkarkim i mbetjeve organike mund të shkaktojë eutrofikim të ujërave sipërfaqësore në krejt zonën. Rritja e prodhimit biologjik mund të jetë me përfitim për ujërat sipërfaqësore përmes rritjes së prodhimit të peshkut, por mund të ketë efekte serioze në ujërat e thella. Rritja e lëndës organike të dekompozuar mund të çojë në mungesën e oksigjenit dhe mund të shkatërrojë faunën e nën detit. Duket që natyra do ta ketë shumë të vështirë që të restaurojë kushtet e oksidimit kur ka filluar një cikël i tillë plehërimi.

Një shqetësim imediat për njerëzit është prania e një numri të madh agjentesh patogjene që mund të shkaktojnë sëmundje. Ndotja potenciale e ushqimeve nga deti, sidomos e molusqeve, që në gjirin e Sarandës dhe në lagunën e Butrintit janë shumë të rëndësishme në aspektin tregtar për peshkimin në Shqipëri (midhjet *Mytilus galloprovincialis*), ka qenë e shoqëruar me praninë e patogjeneve.

Ndotja nga ujërat e përdorura është përgjegjëse direkte për mbylljen e shumë zonave për rritjen e midhjeve në Evropë. Molusqet mund të akumulojnë dhe të mbajnë organizma patogjene dhe lende toksike organike dhe inorganike që janë të pranishme në zonat e rritjes. Gjatë viteve të fundit kultivimi i midhjeve praktikisht është ndaluar, për shkak të bllokimit të eksporteve të imponuar nga BE për arsye sanitare në tetor 1994 për të gjitha produktet gjalla të sektorit të peshkimit. Kërkesa kryesore për eksportin e molusqeve të gjallë në BE, lidhet me krijimin e një sistemi monitorimi të molusqeve, që të garantojë sigurinë e midhjeve të grumbulluara në sipërfaqet ujore. Aktualisht Shqipëria po ndeshet me ndalimin për shkak të shpërthimit të mëparshëm të kolerës në molusqet e gjallë. Kjo çështje tani është adresuar nëpërmjet zhvillimit të një sistemi monitorimi për të certifikuar zonat e bregdetit shqiptar dhe të ujërave detare nga ku mund të grumbullohen dhe eksportohen molusqet.

\*\*\*\*\*

Nga auditimi dhe përgjigjet e pyetësorëve rezulton se: Në zbatim të rekomandimet e Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSh) dhe BE, duhet të kryhet monitorimi mikrobiologjik i ujërave bregdetare që përdoren për qëllime rekreative, gjë e cila kërkon një ndjekje të vazhdueshme të cilësisë mikrobiologjike të ujërave të larjes, kombinuar me inspektimin sanitar të plazheve. Për këtë kërkohet sigurimi i një numri të caktuar të dhënash, të marra gjatë një periudhë kohe në vazhdimësi, për nxjerrjen e rezultateve të besueshme. Sipas rekomandimeve të BE dhe ËHO/UNEP. Për çdo stacion kampionimi të seleksionuar, duhet të kryhet një seri prej të paktën 10 kampionimesh në vit. Në rastet kur ndotja mikrobiologjike është e vazhdueshme dhe mbi normat e lejuara numri i mostrave duhet të rritet me një frekuencë 1 javore veçanërisht gjatë sezonit të plazhit.

Gjithashtu monitorimi i ujërave detare është shumë i rëndësishëm për të arritur edhe objektivat e BE në minimizimin e ndotjeve që vijnë nga plastika, derdhja e mbetjeve urbane, vajrat dhe hidrokarburet, mbeturinat e peshkimit, ruajtja dhe zhvillimi i zonave turistike ruajtja e flora dhe faunës, etj., prandaj duhet që të monitorohen të analizohen gjithë faktorët ndotës që:

- të kryejë vlerësimin e faktorëve ekspozues të ndotjeve të plazheve, me qëllim sigurimin e cilësisë dhe mbrojtjen e shëndetit publik nga efektet negative të ndotjes së plazheve.
- të evidentojë vendet me rrezikshmëri më të lartë për shëndetin e popullatës nga ndotja e ujërave.
- të përcaktojë burimet direkte dhe indirekte të ndotjes së plazheve.
- të mundësojë klasifikimin e plazheve sipas shkallës së pastërtisë mikrobiologjike të tyre.



- të japë rekomandimet përkatëse për reduktimin e ndotjes në vendet e identifikuar si të tilla.
- të krijojë një bazë të dhënash lidhur me gjendjen e mjedisit në zonat bregdetare të monitoruara, për krahasimin e tyre në vite.
- të bëjë interpretimin shkencor të dhënave të grumbulluara nga monitorimi që t'u shërbejë autoriteve kompetente qendrore e vendore vendim marrëse, për menaxhimin dhe planifikimin e zonave bregdetare me synim nxitjen e turizmit bregdetar, si një nga faktorët kryesorë të zhvillimit të qëndrueshëm të vendit tonë në të ardhmen.
- të sugjerojë plotësimin e legjislacionit në fushën e mbrojtjes së ujërave.

Për vitin 2019 nga monitorimi mikrobiologjik i ujërave bregdetarë të larjes në plazhet e Velipojës, Shëngjinit, Tales, Durrësit, Gjiri i Lalzit, Kavajës, Divjakës, Semanit, Vlorës, Palasës, Dhërmiut, Drimadhës, Himarës, Livadh, Jalës, Borshit, Qeparoit, Lukovës, Ksamilit, Sarandës, Pogradecit, Linit në zbatim të kontratës së shërbimit nr. 425, datë 05.04.2019 ndërmjet Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe Institutit të Shëndetit Publik, për “Monitorimin mikrobiologjik të ujërave bregdetarë të larjes në plazhet e Republikën e Shqipërisë”, për periudhën e monitorimit 15 Maj – 30 Shtator. Është kryer inspektimi higjeno-sanitar si dhe janë marrë mostra të ujërave larës për vlerësimin mikrobiologjik të cilësisë së ujërave bregdetarë të larjes në Shqipëri në 119 stacione monitorimi në plazhet kryesore të bregdetit të tilla si: Velipojës, Shëngjinit, Tales, Durrësit, Gjirit të Lalzit, Kavajës (Golemi, Spille, Qerret) Divjakës, Semanit, Vlorës (Orikum, Zvërnec), Dhërmiut, Palasës, Himarës, Borshit, Qeparoit, Livadhes, Jalës, Sarandës, Ksamilit,

Mostrat e ujërave bregdetarë të larjes u analizuan për 2 tregues bakteriologjike:

- 1- *Intestinal Enterococci* (IE) – Metoda ISO 7899-1
- 2- *Escherichia Coli* (*E.coli*)– Metoda ISO 9308-3, e Membranave Filtrante (MF)

**Plazhi i Velipojës:** Në vijën bregdetare të Velipojës, brezi ranor është i pastruar pa prani të mbetjeve, me prezencë të koshave të mbeturinave. Në 9 seritë e monitoruara në të gjitha stacionet e monitorimit të analizuar në plazhin e Velipojës, sipas rezultateve mikrobiologjike (vlerësimi për prani të mikroorganizmave *E. Coli* dhe *S. Fecal*) *nuk ka ngarkesë mikrobike* e ujërave në këto plazhe.



## ANALIZAT BAKTERIOLOGJIKE TË DETIT PLAZHI I VELIPOJËS 2019

Nr. Stacion	Vendi i kampionimit	vlerat mesatare	vlerat mesatare
ALB		FC- Norma 250	IE - Norma 100
1	B-R Belavista	88	86
2	Hotel Adriatik	42	29
3	B-R Fantazia	30	29
4	Hyrja Plazh	34	36
5	Pallatet e Reja	73	88
6	Dolçe Vita	49	64
7	Pranë Lagunës Vilunit	56	42

**Plazhi i Shëngjinit :** Për shkak të prishjen të disa objekteve informale, ka patur prani të mbetjeve inerte të cilat u vërejtën pas çdo fushate mostrimi, nuk u mottwn masash nga ana e pushtetit vendor për largimin e tyre. Me prani të pakët të koshave si dhe të tualeteve. Në 9 seritë e monitoruara, në të 5 pikat e monitorimit të analizuara në plazhin e Shëngjinit, sipas rezultateve analitike (vlerësimi për prani të mikroorganizmave E. Coli dhe S. Fecal) *nuk ka ngarkesë mikrobike* të ujërave në këto plazhe.



## ANALIZAT BAKTERIOLOGJIKE TË DETIT PLAZHI I SHENGJINIT 2019

Nr. Stacion	Vendi i kampionimit	Vlerat mesatare	Vlerat mesatare
ALB 1		FC-Norma 250	IE-Norma 100
1	Ish kabinat	52	74
2	Hotel "Dora"	46	48
3	Hotel "Kristian"	41	48
4	B-R Gjahtari	34	27
5	Kune	39	36

**Plazhi Tale :** Në vijën bregdetare Tales brezi ranor është i pastruar përgjithësisht nga sipërmarrje e subjekteve private, me prani të pakët të koshave si dhe të tualeteve. Ka rritje tw numrit të pushuesve pas çdo serie monitorimi. Gjatë 9 serive të monitorimit në të 3 pikat e monitorimit të analizuara në plazhin e Tales sipas rezultateve analitike (vlerësimi për prani të

mikroorganizmave E. Coli dhe S. Fecal) nuk ka ngarkesë mikrobike të ujërave në këto plazhe.

#### ANALIZAT BAKTERIOLOGJIKE TË DETIT PLAZHI TALE 2019

Nr. Stacion	Vendi i kampionimit	Vlerat mesatare	
		FC - Norma 250	IE - Norma 100
1	Hyrja qendrore, djathtas, tek Palmat	23	14
2	Në qëndër të hyrjes qendrore, tek Antena	23	13
3	Majtas hyrjes qendrore, Bar-Restorant USA	27	15

**Plazhet e Durrësit:** Në vijën bregdetare të plazhit në qytetin e Durrësit, brezi ranor është i pastruar nga ana e Bashkisë, por në disa stacione mostrimi vërehet prani e lështerikëve si dhe mbetjeve nga deti (Currilat, etj.), si dhe prani e pakët e koshave dhe e tualeteve. Përgjithësisht nga sipërmarrje e subjekteve private, u konstatua plugimi i brezit ranor, vendosja e koshave të mbeturinave si dhe të tualeteve, të pranishme mbetje të ngurta për shkak të shtrimit të shëtitorës.

Pikë e ndotur mikrobiologjikisht vazhdon të jetë pika pas Kanalit tek Plepat, ku vërehet prani e shkarkimeve të ujërave urbane të pa trajtuara në ujërat pritëse bregdetare në mënyrë direkte. Nga të dhënat laboratorike vërehet ngarkesë mikrobike (mbi 100 cfu të *Escherichia Coli* (FC), dhe/ose *Enterococcus Intestinalis* (IE)) në pikën 15 të monitorimit (pas Kanalit tek Plepat) në të gjitha fushatat e mostrimit; në pikën e 16 të monitorimit (Shkëmbi i Kavajës) në fushatën e 1, 2, 7, 8 dhe 9 të mostrimit; në pikën e 3 të monitorimit (Plazhi i Zhironit) në fushatën e 4, 7, 8 dhe 9 të mostrimit; në pikën e 7 të monitorimit (Plazhi Gostivari) në fushatën e 6 dhe 7 të mostrimit. Në fushatën e 7 të monitorimit referuar rezultateve laboratorike rezultojnë me ndotje mikrobike pikat 8, 12, 15, 16, 17, 18 e 19 të monitorimit.



#### ANALIZAT BAKTERIOLOGJIKE TË DETIT PLAZHI I DURRËSIT 2019

Nr. Stacion	Vendi i kampionimit	Vlerat mesatare	
		FC - Norma 250	IE - Norma 100
<b>ALB 2</b>			
1	Plazhi Currila 1	91	85
2	Plazhi Currila 2	68	54
3	Plazhi Zhiron (Kështjella)	306	208

4	Ura e Dajlanit	78	75
5	Plazhi Filadelfia (Hotel & SPA Palace)	62	86
6	Plazhi Teuta Vivas (Hotel VIVAS)	67	67
7	Plazhi Gostivari (Piceri-Restorant Gostivari)	153	234
8	Apollonia (Hotel Canal-Grande)	151	226
9	Hekurudha (tek Policia)	107	123
10	Hotel Adriatik	85	79
11	Plazhi Iliria (Pista)	55	50
12	Iliria pranë Bllokut (Hotel Vila Lule)	95	81
13	Ministria e Rendit	57	89
14	Kompleksi Tropikal	82	101
15	Pas Kanalit (Plepa)	704	821
16	Shkëmbi i Kavajës (Restorant Tirona)	267	336
17	Bar-Hotel Hoti	138	128
18	Plazhi Benilva	143	211
19	Plazhi Hotel Andi	144	87
20	Kompleksi Xixa	103	87
21	Kompleksi Xhardino	179	138

**Plazhi Gjiri i Lalzit:** Në këtë vit, në programin e monitorimit, në vijën bregdetare të plazhit të Gjirit të Lalzit janë shtuar dy pika monitorimi, përkatësisht pranë Kompleksit Alioma (pika 4) si dhe pranë fshatit Turistik Lura 3 (pika 5 e monitorimit). Gjatë inspektimit janë vërejtur plugim dhe pastrim të brezit ranor, me prani të koshave të mbeturinave. Në 9 seritë e monitoruara, në të 3 pikat e monitorimit të analizuara në plazhin e Gjirit të Lalzit, sipas rezultateve analitike (vlerësimi për prani të mikroorganizmave E. Coli dhe S. Fecal) *nuk ka ngarkesë mikrobike të ujërave në këto plazhe.*



#### ANALIZAT BAKTERIOLOGJIKE TË DETIT PLAZHI I GJIRIT TE LALZIT 2019

Nr. Stacion	Vendi i kampionimit	vlerat mesatare	vlerat mesatare
ALB 2		FC-Norma 250	IE- Norma 100
1	Kepi i Rodonit	54	41
2	Fshati Turistik Lura	60	37
3	Plazhi publik pas Lurës	56	51



3	Gjiri i Lalezit - Kompleksi Alioma	53	52
3	Gjiri i Lalezit - Fshati Turistik Lura 3	89	77

**Plazhi i Kavajës (Golem) :** Në plazhet e Kavajës ka rritje të numrit pushuesve pas çdo serie monitorimi. Në zonën ranore të bregdetit në plazhit e Kavajës, në disa fushata mostrimi u vërejtën mbeturina urbane, leshterikë, me prani të pakët të koshave të mbeturinave dhe tualeteve.

Në plazhin e Kavajës cilësia e ujërave bregdetarë të larjes për 9 seritë e monitorimit *nuk ka ngarkesë mikrobiologjike* të ujërave në këto plazhe, përveç pikës 1 (Majami) dhe pikës 2 (Vjena) të monitorimit në fushatën e 9 rezultatet analitike konstatuan ndotje mikrobike të ujërave në këto plazhe.



#### ANALIZAT BAKTERIOLOGJIKE TË DETIT PLAZHI GOLEM 2019 ( KAVAJË )

Nr. Stacion	Vendi i kampionimit	Vlerat mesatare	Vlerat mesatare
ALB 2		FC-Norma 250	IE-Norma 100
1	Majami Beach	127	137
2	Vjena	116	127
3	Golem-Kosmira	87	84
4	Vapori mbytur	82	92
5	Piceri Jurgen	79	66
6	Piceri Argjendi	75	85
7	Mak Albania	64	45
8	Lokali Reshatit	56	44
9	Bunckeri Bardhë	63	52

**Plazhi i Qerretit:** Nga inspektimi higjeno sanitar, brezi ranor ka rezultuar i pastër, me prani të pakët të tualeteve dhe të koshave të mbeturinave. Në 9 seritë e monitoruara, në të 3 pikat e monitorimit të analizuara në plazhin e Qerretit, sipas rezultateve analitike (vlerësimi për prani të mikroorganizmave E. Coli dhe S. Fecal) *nuk ka ngarkesë mikrobike* të ujërave në këto plazhe .

### ANALIZAT BAKTERIOLOGJIKE TË DETIT PLAZHI QERRET 2019 (KAVAJË).

Nr. Stacion	Vendi i kampionimit	Vlerat mesatare	Vlerat mesatare
<b>ALB 2</b>		<b>FC- Norma 250</b>	<b>IE- Norma 100</b>
1	Qerret, Ish Fusha Sportit	55	68
2	Qerret, Kompleksi Belavista	75	73
3	Qerret, Bar-Kafe Holiday	78	74


**Plazhet i Spillesë :** Brezi ranor i pastër, si inisiativë e subjekteve turistike private vërehet angazhim i tyre në lidhje me ruajtjen dhe pastrimin e brezit ranor, me prani të koshave të mbeturinave dhe tualete. Në 9 seritë e monitoruara, në të 3 pikat e monitorimit të analizuara në plazhin e Spilles, sipas rezultateve analitike (vlerësimi për prani të mikroorganizmave E. Coli dhe S. Fecal) *nuk ka ngarkesë mikrobike* të ujërave në këto plazhe.

### ANALIZAT BAKTERIOLOGJIKE TË DETIT PLAZHI SPILLE 2019 (KAVAJË)

Nr. Stacion	Vendi i kampionimit	vlerat mesatare	vlerat mesatare
<b>ALB 2</b>		<b>FC- Norma 250</b>	<b>IE- Norma 100</b>
1	Spille Djathtas, Bar-Rest. Martiri	59	51
2	Spille Qender, Hotel Basana	57	62
3	Greth i Mesëm, Palmat e fundit	60	78

**Plazhet e Vlorës :** Me gjithë kontrollet dhe masave të marra nga Pushtetit Vendor, vërehet përgjatë zonës Lungo Mares shkarkime ujërash në det në 4 pika (kanale). Ndonëse janë reduktuar derdhjet e ujërave të zeza nga shtëpitë dhe subjektet private në zonën e Shkollës së Marinës (pika 3 e monitorimit) nga ana e strukturave përgjegjëse të pushtetit vendor, vërehet marrja e masave për ulje e ngarkesës mikrobike por jo eliminimi i saj. U konstatua prani e koshave të mbeturinave.

Duke vlerësuar të dhënat laboratorike *ka ngarkesë mikrobiologjike* {mbi 100 cfu të *Escherichia Coli* (FC), dhe/ose *Enterococcus Intestinalis* (IE)} në pikën 3 (Shkolla e Marinës) në të gjitha fushatat e monitorimit, ndërsa në pikën 1 të monitorimit (Plazhi i Vjetër Kampi i Pionerit) dhe në pikën 2 (Plazhi i Vjetër, Kabinat) *ka ngarkesë mikrobiologjike* në fushatën e 9 të monitorimit. Në të gjitha fushatat e mostrimit janë vërejtur prani e pushuesve vendas dhe të huaj.



Nr. Stacion	Vendi i kampionimit	vlerat mesatare	vlerat mesatare
ALB		FC-Norma 250	IE- Norma 100
1	Plazhi Vjetër K.Pionierit	124	184
2	Plazhi Vjetër, Kabinat	114	137
3	Shkolla e Marinës	637	497
4	Plazhi i Ri	176	259
5	Ish Vilat Bllokut	30	20
6	Jonufër	59	29
7	Plazhi Paradisë	26	11
8	Plazhi B-R L. Borshi	40	15
9	Radhimë Hotel Grand	30	24
10	Freskia	38	38

**Plazhi i Zvërnecit :** Gjatë inspektimit higjeno sanitar të bregdetit, ka në brezin ranor, disa fushata mbeturina të dala nga deti, leshtërikë, me prani të pakët të koshave të mbeturinave dhe të tualeteve. Në 9 seritë e monitoruara, në të 3 pikat e monitorimit të analizuara në plazhin e Zvërnecit, sipas rezultateve analitike (vlerësimi për prani të mikroorganizmave E. Coli dhe S. Fecal) *nuk ka ngarkesë mikrobike* të ujërave në këto plazhe.

#### ANALIZAT BAKTERIOLOGJIKE TË DETIT PLAZHI I ZVERNECIT (VLORE) 2019

Nr. Stacion	Vendi i kampionimit	vlerat mesatare	vlerat mesatare
		FC-Norma 250	IE-Norma 100
1	Para Xhemalit (djathtas)	28	16
2	Bar-Restorant Olsi (ne mes)	33	55
3	Bar-Restorant Kapiteni (majtas)	47	35

**Plazhi i Orikumit :** Gjatë inspektimit higjeno-sanitar të bregdetit ka patur pak herë grumbullime mbeturinash, por në përgjithësi ka rezultuar i pastër. U vërejt se prania e koshave por tualetet ishin të rralla. Në 9 seritë e monitoruara, në të 3 pikat e monitorimit të analizuara në plazhin e Orikumit, sipas rezultateve analitike (vlerësimi për prani të mikroorganizmave E. Coli dhe S. Fecal) *nuk ka ngarkesë mikrobike* të ujërave në këto plazhe.





## ANALIZAT BAKTERIOLOGJIKE TË DETIT PLAZHI I ORIKUMIT (VLORE) 2019

Nr. Stacion	Vendi i kampionimit	vlerat mesatare	vlerat mesatare
<b>ALB 5</b>		<b>FC-Norma 250</b>	<b>IE-Norma 100</b>
1	Kompleksi Orikum	27	13
2	Bar- Restorant Aleksandër	22	19
3	Para Repartit Pashaliman	14	9

**Plazhi i Palasës :** Gjatë inspektimit higjieno sanitar ka patur prani e mbetjeve të sjella nga deti, mungesa e tualeteve, me prani të pakët të koshave të mbeturinave. Për shkak të punimeve që po kryhen nga Subjekti privat, në ndërtimin e infrastrukturës si dhe të godinave të Resortit Turistik, u vërejtën në pjesën e bregdetin sasi inertesh. Pa prani të banjatorëve, pa prezencë të koshave të mbeturinave. Cilësia e ujërave për plazhin e Palasës në të nëntë fushatat e monitoruara rezulton shumë e mirë, për të dy stacionet e monitorimit për periudhën e sezonit turistik sipas rezultateve mikrobiologjike (vlerësimi për prani të mikroorganizmave E. Coli dhe S. Fecal) *nuk vërehet ngarkesë* mikrobike.

## ANALIZAT BAKTERIOLOGJIKE TË DETIT PLAZHI I PALASES 2019

Nr. Stacion	Vendi i kampionimit	Vlerat mesatare	Vlerat mesatare
<b>ALB 2</b>		<b>FC-Norma 250</b>	<b>IE-Norma 100</b>
1	Plazhi I Palases 1	5	5
2	Plazhi I Palases 2	4	4

**Plazhet e Dhërmiut, Drimadhes :** Në plazhet e Dhërmiut, brezi bregdetar është i pastruar, me prezencë të koshave të mbeturinave. Në pikat 2 e 3 të monitorimit kishte të pranishme mbetje të ngurta nga prishja e ndërtimeve si dhe për shkak të punimeve në shëtitoren e Dhërmiut.

Në 9 seritë e monitoruara në të 5 stacionet e monitorimit (3 pika monitorimi në Dhërmi dhe 2 pika monitorimi në Drimadhe), sipas rezultateve analitike (vlerësimi për prani të mikroorganizmave E. Coli dhe S. Fecal) *nuk vërehet ngarkesë mikrobike* e ujërave në këto plazhe.





## ANALIZAT BAKTERIOLOGJIKE TË DETIT PLAZHI I DHËRMIUT 2019

Nr. Stacion	Vendi i kampionimit	vlerat mesatare	vlerat mesatare
<b>ALB 5</b>		<b>FC-Norma 250</b>	<b>IE-Norma 100</b>
1	Tek Lisi	5	7
2	Hotel Anastasia	89	135
3	Kampi Punëtor Majtas	18	12
4	Plazhi Drimadhe 1	14	18
5	Plazhi Drimadhe 2	18	10

**Plazhi Borsh :** Në plazhet e Borshit, brezi bregdetar është i pastruar, me prezencë të koshave të mbeturinave. Në 9 seritë e monitoruara në të 3 stacionet e monitorimit në plazhet e Borshit, sipas rezultateve analitike (vlerësimi për prani të mikroorganizmave E. Coli dhe S. Fecal) *nuk vërehet ngarkesë mikrobike* e ujërave në këto plazhe.



## ANALIZAT BAKTERIOLOGJIKE TË DETIT PLAZHI I BORSHIT 2019

Nr. Stacion	Vendi i kampionimit	vlerat mesatare	vlerat mesatare
<b>ALB 6</b>		<b>FC-Norma 250</b>	<b>IE-Norma 100</b>
1	Borshi Djathtas	67	53
2	Borshi Qëndër	70	47
3	Borshi Majtas, Panoram	34	27

**Plazhi Qeparo :** Gjatë inspektimit të plazhit të Qeparoit është vërejtur herë pas here prania e mbetjeve të sjella nga deti, prezencë e pakët e koshave për mbetjet urbane dhe e nyjeve sanitare. Në 9 seritë e monitoruara në të 2 stacionet e monitorimit në plazhin e Qeparoit, sipas rezultateve analitike (vlerësimi për prani të mikroorganizmave E. Coli dhe S. Fecal) *nuk vërehet ngarkesë mikrobike* e ujërave në këto plazhe.

**Plazhi Himarës :** Në plazhin e Himarës, brezi bregdetar i pastruar, me prezencë të koshave të mbeturinave. Në 9 seritë e monitoruara në të 4 stacionet e monitorimit në plazhet e Himarës,


sipas rezultateve analitike (vlerësimi për prani të mikroorganizmave E. Coli dhe S. Fecal) *nuk vërehet ngarkesë mikrobike* e ujërave në këto plazhe. Në fushatën e 1 të monitorimit në pikën 2 (Pas shkëmbit) dhe në pikën 4 (Hotel Likoka) të monitorimit sipas rezultateve analitike u vërejt ndotje mikrobike, me tendencë të uljes së vlerave të ndotjes mikrobike.



#### ANALIZAT BAKTERIOLOGJIKE TË DETIT PLAZHI I HIMARËS 2019

Nr. Stacion	Vendi i kampionimit	vlerat mesatare	vlerat mesatare
ALB 5		FC-Norma 250	IE-Norma 100
1	Himarë Qëndër	105	77
2	Pas Shkëmbit	114	134
3	Potam Alqi	46	39
4	Hotel Likoka	103	70

**Plazhi Livadhe :** Kjo vijë bregdetare tashmë monitorohet nga 3 stacione, pasi në programin monitorues janë shtuar dhe 2 stacione të tjera. Ka mungesë e koshave të mbeturinave në brezin bregdetar. Numri i pushuesve është shtuar ndjeshëm nga seria në seri. Në 9 seritë e monitoruara në të 3 stacionet e monitorimit në plazhet e Livadhes, sipas rezultateve analitike (vlerësimi për prani të mikroorganizmave E. Coli dhe S. Fecal) *nuk vërehet ngarkesë mikrobike* e ujërave në këto plazhe.



Nr. Stacion	Vëndi i kampionimit	vlerat mesatare	vlerat mesatare
<b>ALB 6</b>		<b>FC-Norma 250</b>	<b>IE-Norma 100</b>
1	Plazhi Livadhe 1	36	21
2	Plazhi Livadhe 2	34	11
3	Plazhi Livadhe 3	22	8

**Plazhi i Jalës :** Dy stacione të monitorimit në plazhet e Jalës janë futur në programin monitorues të këtij viti. Në vijën bregdetare të këtij, nuk ka sistem kanalizimesh të ujërave të përdorura, grumbullimi i ujërave mbeturinë kryhej nëpërmjet gropave septike të cilat zhvotohen nga subjektet private. Brezi bregdetar i pastër dhe me prani të koshave të mbeturinave.

Në 9 seritë e monitoruara në të 2 stacionet e monitorimit në plazhet e Jalës, sipas rezultateve analitike (vlerësimi për prani të mikroorganizmave E. Coli dhe S. Fecal) *nuk vërehet ngarkesë mikrobike* e ujërave në këto plazhe.



#### ANALIZAT BAKTERIOLOGJIKE TË DETIT PLAZHI I JALËS 2019

Nr. Stacion	Vendi i kampionimit	vlerat mesatare	vlerat mesatare
<b>ALB 5</b>		<b>FC-Norma 250</b>	<b>IE-Norma 100</b>
1	Jale Djathtas	9	9
2	Jale Majtas	35	9

**Plazhi i Sarandës :** Gjatë inspektimit rezulton të ketë prani të nyjave sanitare si dhe e koshave të mbeturinave. Në stacionin 6 të monitorimit (Kanali i Çukës), sipas rezultateve analitike u konstatua *ndotje mikrobike* në fushatën 1, 2, 3, 6 dhe 7 të mostrimit, ndërsa në pikën 3 të monitorimit (Plazhi i ri) u konstatua *ndotje mikrobike* në fushatën e 3 të monitorimit.



## ANALIZAT BAKTERIOLOGJIKE TË DETIT PLAZHI I SARANDËS 2019

Nr. Stacion	Vendi i kampionimit	vlerat mesatare	vlerat mesatare
ALB 6		FC-Norma 250	IE-Norma 100
1	Plazhi Limion	59	47
2	Plazhi Pllakat	69	46
3	Plazhi i Ri	187	213
4	Plazhi i Fëmijëve	113	167
5	Hotel Grand	140	69
6	Kanali Cukës - Dodona	153	103

**Plazhi i Lukovës :** Tre stacionet e monitorimit të plazheve të Lukovës janë futur në programin monitorues të këtij viti. Brezi bregdetar i pastër dhe me prani të koshave të mbeturinave. Në 9 seritë e monitoruara në të 3 stacionet e monitorimit në plazhet e Lukovës, sipas rezultateve analitike (vlerësimi për prani të mikroorganizmave E. Coli dhe S. Fecal) *nuk vërehet ngarkesë mikrobike* e ujërave në këto plazhe.



## ANALIZAT BAKTERIOLOGJIKE TË DETIT PLAZHI I LUKOVES 2019

Nr. Stacion	Vendi i kampionimit	vlerat mesatare	vlerat mesatare
ALB 6		FC-Norma 250	IE-Norma 100
1	Lukova Djathtas	23	9
2	Lukova ne mes	30	22
3	Lukova Majtas	20	10


**Plazhi i Ksamilit :** Plazhet në vijën bregdetare të Ksamilit, janë shumë të pastra, me prani të koshave të mbeturinave dhe me tualete. Në 9 seritë e monitoruara në të 3 stacionet e monitorimit në plazhet e Ksamilit, sipas rezultateve analitike (vlerësimi për prani të mikroorganizmave E. Coli dhe S. Fecal) *nuk vërehet ngarkesë mikrobike* e ujërave në këto plazhe.



### ANALIZAT BAKTERIOLOGJIKE TË DETIT PLAZHI I KSAMILIT 2019

Nr. Stacion	Vendi i kampionimit		vlerat mesatare
ALB 6		FC-Norma 250	IE-Norma 100
1	Plazhi Rilindja	35	35
2	Plazhi Bora-Bora	28	42
3	Plazhi Kështjella	40	34

**Plazhi i Semanit dhe Darzezë:** Në plazhin e Semanit ka prani të mbetjeve të sjella nga deti, mungesa e koshave për mbeturina dhe njeje sanitare. Në plazhin e Darzezës vërehet prezenca e koshave për mbeturinat nga ana e pushtetit vendor. Në 9 seritë e monitoruara në të 3 stacionet e monitorimit në plazhet e Semanit dhe Darzezës, sipas rezultateve analitike (vlerësimi për prani të mikroorganizmave E. Coli dhe S. Fecal) *nuk vërehet ngarkesë mikrobike e ujërave në këto plazhe.*



## ANALIZAT BAKTERIOLOGJIKE TË DETIT PLAZHI I SEMANIT 2019

Nr. Stacion	Vendi i kampionimit	vlerat mesatare	
ALB 5		FC-Norma 250	IE-Norma 100
1	Hyrja ne plazh, tek Policia, Bunkeri	61	44
2	Kulla e Ujit	71	38
3	Plazhi Darzeze	69	33

**Plazhi Divjakë:** Në plazhin e Divjakës në brezin ranor, ka mungesa të koshave mbeturinave dhe tualeteve. Në një pjesë të konsiderueshme të vijës bregdetare konstatohet prani e leshterikëve, me gjithë prezencën e mjeteve të pushtetit vendor të cilat janë prezentë në çdo fushatë monitorimi, duke ngarkuar mbeturinat që sjell deti. Në 9 seritë e monitoruara në të 3 stacionet e monitorimit në plazhet e Divjakës, sipas rezultateve analitike (vlerësimi për prani të mikroorganizmave E. Coli dhe S. Fecal) *nuk vërehet ngarkesë mikrobike* e ujërave në këto plazhe.



## ANALIZAT BAKTERIOLOGJIKE TË DETIT PLAZHI I DIVJAKËS 2019

Nr. Stacion	Vendi i kampionimit	vlerat mesatare	
ALB 5		FC-Norma 250	IE-Norma 100
1	Hyrja ne plazh , tek Policia	45	43
2	Hyrja kryesore ne plazh	98	70
3	1000 m larg dhe majtas pikës 2	55	53

\*\*\*\*\*

Gjithashtu nga auditimi rezulton se me gjithë punën e bërë nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Bregdetit, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, etj., në mbrojtje të deteve nga ndotjet dhe ndotësit rezulton se:

- ❖ Sipas përgjigjes së pyetësorit nga ana e Ministrisë e Turizmit dhe Mjedisit institucionet në varësi kanë laboratorë të përshtatshëm mikrobiologjik/biokimik që kryejnë analiza për kontrollin e cilësisë së ujit të deteve kështu po sipas saj AKM disponon laborator të përshtatshëm mikrobiologjik/biokimik që kryejnë analiza për kontrollin e cilësisë së ujit



dhe është përgjegjëse për këtë dhe mund të marrë edhe masa korigjuese, megjithatë ajo nuk kryen analizat e ujit por ato realizohen:

- nga Instituti i Shëndetit Publik sipas kontratave të lidhura midis tyre për realizimin e programit të monitorimit mikrobiologjik të ujërave bregdetare të larjes;
- nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar për realizimin e programit të monitorimit me teme “Përcaktimi i statusit të trofisë në detet Adriatik dhe Jon nëpërmjet përdorimit të imazheve satelitore “MODIS” bazuar në përmbajtjen e klorofilës a, azotit dhe fosforit”;

Ndërsa në përgjigjet e pyetësorit të AKM ajo pranon se nuk ka laboratorë të përshtatshëm mikrobiologjik/biokimik që kryejnë analiza për kontrollin e cilësisë së ujit të deteve por ato kryhen nga laboratorit i ISHP i cili kontraktohet nga AKM për monitorimin mikrobiologjik mbi kontrollin e cilësisë së deteve;

- ❖ Nga ana e AKB janë të evidentuar rastet të ndotjes së ujërave të deteve, kështu gjatë monitorimit në terren janë vëzhguar ndotje të ujërave të deteve sidomos disa metra afër vijës bregdetare. Uji është i ndotur nga mbetje të ndryshme plastike të cilat vijnë si rezultat i konsumimit të produkteve (me materiale plastike) nga pushuesit, të cilët nga mungesa e koshave apo niveli i ulët i edukimit mjedisor i lënë mbetjet në pjesën e rërës të cilat më pas me ndihmën e erës dhe të dallgëve të detit kalojnë në ujë. Gjithashtu edhe nga monitorimi i lagunave rezultojnë probleme më të mëdha, kështu në Lagunën e Patokut dhe Lagunën e Kune-Vainit hidhen mbetje të ndryshme urbane, shkarkohen ujëra të ndotur etj.(foto ndotja e Lagunës së Patokut)



**Lezhë:** Është raportuar pranë Bashkisë Lezhë, Prefekturës Lezhë, ISHMPU, MTM, lidhur me konstatimin e ndotjeve në zonën e Kunes, pretendimin e subjekteve për derdhje të ujërave të papërpunuara në kënetë nga një impiant në Kune, ndotjet e pjesës publike në plazhin e Tales, problematikën me rrjetat dhe varkat e peshkatarëve të zonës, të cilat mbajnë erë të rëndë. Është raportuar lidhur me situatën në zonën bregdetare Shëngjin, ku janë konstatuar tre vendgrumbullime mbetjesh, të mbledhura gjatë sezonit turistik 2016. Në Knallë në vijimësi hidhen mbetje të llojeve të ndryshme, të konsumit të përditshëm dhe inerte. Hedhja e vazhdueshme e mbetjeve në Knallë po zvogëlon çdo ditë sipërfaqen e ujit. Knalla është habitat ku shumohen dhe ushqehen lloje të ndryshme speciesh, mbushja e vazhdueshme po rrezikon vet ekzistencën e kënetës së Knallës. Mbushjet kanë si qëllim përfitimin e sipërfaqeve, që më vonë mund të përdoren si hapësirë për të ndërtuar.

Shkarkimet e kamionëve kryhen në darkë nga informacioni i marrë në terren. Probleme me grumbullimin e mbetjeve ka edhe zona e mbrojtur e Kune – Vajin. Grumbuj mbetjesh të ndryshme, kryesisht plastike, gjenden në dy vende të kësaj hapësire bregdetare. Nga autoritetet vendore nuk është marrë asnjë masë për pastrimin e tyre, por në njërin nga vendet mbetjet janë djegur. Djegia e mbetjeve me bazë plastike në natyrë shkakton ndotjen e Ajrit, Ujit dhe Tokës, pasi djegia e plastikës në temperatura të ulta çliron dioksina të cilat përthithen nga bimët dhe kafshët (akumulohen në shtresën dhjamore të kafshëve) duke u bërë shkak për zhvillimin e sëmundjeve kancerogjene.

**Shkodër** Është raportuar pranë Bashkisë Shkodër, ISHMPU, ish - MZHETTS, lidhur me situatën në zonën bregdetare të Velipojës ku është konstatuar një pikë grumbullimi mbetjesh, e cila shtrihet në këto koordinata gjeografike 41°51'11"V dhe 19°26'55"L, përgjatë kanalit të hidrovorit. Grumbullimi i mbetjeve të ndryshme (plastike, urbane të konsumit të përditshëm, inerte etj...) në këtë zonë përbën problem për ndotjen e mjedisit. Sasi të konsiderueshme mbetjesh janë hedhur gjatë sezonit turistik veror 2017 pranë kanalit të hidrovorit, gjë e cila ka rrezikuar ndotjen e ujërave të kanalit, si rrjedhojë dhe ujin e detit. Aroma e keqe e mbetjeve ka krijuar shqetësim për pushuesit. Nga kontakti me Drejtorinë e Shërbimeve të Bashkisë Shkodër dhe firmën e pastrimit të kontratuar për Velipojën na u bë e ditur se asnjëra palë nuk kishte dijeni për këtë situatë dhe se Bashkia Shkodër nuk kishte dhënë asnjë autorizim për përdorimin e kësaj hapësire si vendgrumbullim mbetjesh. Firma e pastrimit është e kontratuar vetëm për pastrimin e koshave, e cila bën pastrimin e tyre dhe ngarkesën e dërgon në landfillin e Bushatit.

**Sarandë:** Në bregdetin e këtij qyteti ka ndotje të rërës dhe detit nga shpërthimi dhe filtrimi i gropave septike të ndërtuara jashtë kushteve teknike, gjithashtu disa subjekte hedhin rërë lumi të larë dhe disa të tjerë hedhin rërë nga linjat e përpunimit të inerteve, e cila ka përmbajtje gëlqerore duke shkaktuar ndotje mjedisore të vijës bregdetare;

**Durrës:** Është raportuar pranë Bashkisë Durrës, ISHMPU dhe ish - MZHETTS, lidhur me situatën në zonën bregdetare të Gjirit të Lalzit, ku është konstatuar se përgjatë të gjithë brezit ranor gjenden të pa çmontuara dhe të degraduara rreth 27 objekte me materiale të ndryshme (druri dhe hekuri). Brezi ranor është i ndotur nga mbeturina të ndryshme, për shkak dhe të stinës së dimrit çka ka sjellë akumulimin në sasi të mëdha të mbetjeve. Po e njëjta situatë konstatohet dhe në brezin e gjelbër të pishave, ku në vende të ndryshme përgjatë brezit gjendeshin sasi të mëdha mbetjesh të ndryshme. Përsa i përket ndërtimeve, në këtë zonë po punohet në pjesë të veçanta në brendësi të brezit të gjelbër, nga resortet turistike (fshatrat turistik “Lura dhe “Perla” etj.) punime të cilat sjellin dhe ndotje në sipërfaqe të veçanta. Në këtë zonë po punohet dhe për ndërtimin e rrjetit të ujësjellësit.

Mos marrja e masave për sistemimin e mjeteve motorike të peshkatarëve të zonës, të cilët aktualisht krijojnë ndotje dhe shqetësim për pushuesit.

Problematikë ka paraqitur menaxhimi i mbetjeve dhe largimi në kohë i tyre. Gjatë gjithë sezonit ka patur pirgje mbetjesh dhe kosha të tej mbushur duke prishur imazhin për turistët, rrjedhimisht dhe ndotje të ajrit me aroma të pakëndshme.

Në kompetencat e Agjencisë Kombëtare të Bregdetit përfshihet monitorimi i vijës bregdetare por nuk ka kompetenca për monitorimin e ujërave të deteve, specifikisht cilësia e ujërave. Për më tepër AKB për shkak të mungesës së burimeve njerëzore dhe infrastrukturës së nevojshme e ka të pamundur të realizojë monitorimin e ujërave të ndotura.

Gjithashtu një fenomen tjetër që konstatohet dhe vlen të analizohet është se duke qenë se pastrimi i ujërave detare nga ndotjet kërkon kosto financiare, kushte të përshtatshme,



kërkon studim të zonës, angazhim të disa institucioneve duhet që të merren masa përpara se ndotja të shkojë në det. Kështu nga monitorimet që AKB-ja, ka realizuar në terren me degët rajonale rezulton se pas përfundimit të sezonit turistik ka shumë mbetje plastike të cilat janë qëndrojnë në rërë gjatë gjithë kohës. Këto mbetje janë tapa të shisheve, bishta cigaresh, mbetje të tjera plastike të vogla të cilat me kalimin e kohës, nga ndryshimi i temperaturave kalojnë në fazën e asaj që quhet mikropastikë. Problemi me mikropastikën është një problem botëror ku shumë shtete të fuqishme botërore po bëjnë studime dhe po marrin veprime për pastrimin e deteve nga mikropastika që kanë kosto të madha financiare megjithëse ky proces rezulton i vështirë. Prandaj sugjerohet që për të ulur sa më shumë ndotjen e ujit të detit nga mikropastika vazhdimisht të bëhen studime dhe të merren aksione pastrimi të rërës deri në thellësi. Kjo do të sjellë një ulje të ndotjes së ujërave detare nga kjo mikropastikë.

Tani dhe në të ardhmen, përmirësimi i cilësisë së ujërave detare, është një problem i cili kërkon kosto të mëdha financiare për tu zgjidhur sidomos aty ku ujërat detare janë të ndotur sepse kërkon pastrim edhe monitorim të vazhdueshëm të situatës për sa i përket keq menaxhimit të mbetjeve. Prandaj duhet që tani dhe në të ardhmen për të përmirësuar cilësinë e ujërave detare së pari duhet një ndërgjegjësim i personave fizikë apo juridikë që ndotin si dhe duke u mbështetur edhe në direktivat e BE për të pasur një menaxhim më të mirë e për të ulur ndotjen sugjerohet që të përdoret parimi "Ndotësi Pagan". Pra personi fizik apo juridik nëse me veprimtarinë e tij ndot ujërat detare duhet të mbajë përgjegjësi dhe ta kompensojë atë me një kosto monetare duke ndërhyrë në përmirësimin e mjedisit të ndotur dhe kthimin e tij në gjendje të pranueshme. Pavarësisht se cilësia e ujërave detare nuk matet me një vlerë monetare në këtë rast kjo është një mundësi e mirë zgjidhje e cila mund të rezultojë edhe në uljen e ndotjes së ujërave dhe marrjen e masave të tjera të cilat sjellim më pak ndotje.

Gjithashtu për të ulur ndotjen e ujërave detare nga mbetjet e ndryshme që vijnë si rezultat i ushtrimit të një aktiviteti përgjatë vijës bregdetare duhet të minimizohen mbetjet duke i ricikluar ato ose të përcaktohen zona të veçanta pranë qyteteve bregdetare duke hapur landfille sipas standardeve Evropiane në mënyrë që të gjitha këto mbetje të mos hidhen më në det por të depozitohen në këto hapësira. Është me rëndësi ndërtimi i këtyre landfilleve megjithëse jo mënyra më e mire e trajtimit të mbetjeve sipas kushteve edhe standardeve BE në mënyrë që shllami (uji i ndotur që vjen si rezultat i depozitimit të mbetjeve) të mos kalojnë nëntokë i pa trajtuar dhe të ndotë më shumë ujërat nëntokësorë. Ky problem është shumë evident në ditët e sotme sepse në vendin tonë ka "vendepozitime mbetjesh" dhe jo landfille të mirëfillta ku bëhet trajtimi i mbetjeve sipas të gjitha kushteve.

Gjithashtu në bazë të konventave dhe direktivave të ndryshme Evropiane cilësia e mjedisit është një e drejtë për çdo njeri. Pra njeriu ka të drejtë të jetojë në një mjedis të pastër dhe të ketë të drejtën e vendimmarrjes.

Shpesh herë banorët që jetojnë në zonat bregdetare kanë probleme të ndryshme dhe ankohen për ndotjen e ujërave siç është rasti në Shëngjin i një biznesi që ushtron aktivitetin e tij, fabrikë peshku, i cila ndot shumë ujërat detare. Për këtë problem AKB gjatë monitorimeve në terren ka marrë edhe mendimin e banorëve dhe të vetë subjekteve të tjera që ushtrjnë aktivitetin e tyre në fushën e turizmit dhe ka rezultuar se kjo është shumë shqetësuese megjithëse mendimi i tyre nuk merrej në konsideratë dhe ata nuk dinin ku të drejtoheshin për problemin që i shqetëson. Ky aktivitet ndot ujërat e pjesës bregdetare duke e bërë ujin të papërdorshëm nga pushuesit gjatë sezonit të verës si dhe ka aromë e pakëndshme. Ky problem sjell që edhe numri i pushuesve në këtë zonë është më i ulët në krahasim me pjesët e tjera përgjatë vijës bregdetare të plazhit të Shëngjinit.

\*\*\*\*\*

Konventa e *Aarhusit* paraqet një ndër mekanizmat kryesor të demokracisë në fushën e mjedisit, qytetarin e thjeshtë, nga një bartës detyrimesh e bën një partner aktiv në vendimmarrjen për çështjet mjedisore duke ia siguruar atij kështu: të drejtën për të qenë i informuar për situatën mjedisore ku jeton, të drejtën jo vetëm për të marrë pjesë aktive në vendimmarrje për çështje mjedisore, por të ketë edhe të drejtën e qasjes në mbrojtjen ligjore në rast të shkeljes të së drejtës së tij për një mjedis të pastër <sup>8</sup>.

Zhvillimi i shoqërisë njerëzore është karakterizuar nga rritja e shkallës së sundimit dhe e ndikimit të natyrës prej njeriut. Analizat e mjaft shkencëtarëve sjellin fakte se në të kaluar e largët, zhdukja e llojeve ndodhte, në përgjithësi, për shkaqe natyrore. Por, ata pohojnë se shkaku kryesor i krizës së tanishme është i ndryshëm, zhdukjet e sotme të llojeve shkaktohen nga veprimtaria njerëzore.

Aktualisht njerëzimi vepron “kundër natyrës” dhe me të drejt mund të quhet “shfarosësi i llojeve”. Pasojat kryesore të zhvillimit të shoqërisë njerëzore, kalimi nga një bujqësi tradicionale në atë intensive, nga një industri artizanale në atë moderne, rritja dhe përqendrimi i popullsisë në rajonet më të pasura, zhvillimi i turizmit etj., kanë sjell sot mjaft probleme. Në këto rajone popullatat e popullimet e bimëve e të kafshëve, të ngjeshura së tepërmi, u detyruan, nga kushtet e reja, të mbijetojnë. Por edhe në këtë situatë, krahas konkurrencës natyrore të vet specieve, përsëri iu nënshtruan ndikimit të veprimtarive humane, pasi ato përbëjnë burimin kryesor të jetesë, janë lëndë të para për industrinë, bujqësinë e turizmin. Sot, “oazet”, gjithnjë e më të vegjël të natyrës së egër, kanë mbetur të rrethuar dhe të izoluar prej një natyre tjetër, përmes të cilëve migracioni është ose i vështirë ose i pamundur. Në këto kushte, vëmendja e konservuesëve të Konventa e Aarhusit natyrës është përqendruar pikërisht në ruajtjen dhe menaxhimin e këtyre “oazeve” të egër, ku bimët, kafshët dhe proceset evolutive të mund të vijojnë të zhvillohen. Kjo politikë e ruajtjes së natyrës *in situ* (stacionare ose në arealin e tyre të përhapjes), nëpërmjet ngritjes së një sistemi zanash të mbrojtura, ka ardhur duke u zhvilluar dhe përpunuar më tej si një domosdoshmëri për ruajtjen afat-gjatë të resurseve natyrore dhe biologjike që kemi trashëguar dhe që do t’u përcjellim brezave që do të vijnë.

Natyra joshëse e vendit tonë, me bukuritë e saj ka lënë mbresa, ka qenë dhe burim frymëzimi jo vetëm për shqiptarët, por edhe për vizitorët e huaj e albanologë të shquar. Në veprat dhe shkrimet e tyre, për Shqipërinë, i evidencojnë këto vlera. Vlerat natyrore, herë pas here, me ndryshimet që pësojnë dhe rëndësinë që marrin, në periudha të ndryshme, duhet të jenë objekt i veprimtarisë së specialisteve të këtyre fushave.

Periudha që po jetojmë ku hapësirat e komunikimit, ardhja e shumë të huajve në vendin tonë, shtron edhe para specialisteve të mjedisit e të biodiversitetit, në veçanti, edhe të studiuesve të natyrës, në përgjithësi, detyra dhe vizione të reja, sidomos në drejtim të “ekspozimit të vlerave të Natyrës Shqiptare”. Janë të pakta botimet njohëse e prezantuese të peizazheve apo për parqet kombëtare, të faunës e florës së rrallë, shoqërimet e rralla, bimët endemike, nuk njihen sa duhen monumentet e natyrës, pyjet e kullotat, bota nënujore me bimësinë dhe speciet e saj, etj. Botime të tilla mungojnë si fletëpalosje, albume, guida turistike, monografi, libra të vegjël etj., për përdorim nga një masë më e gjerë, nxënësish e studentesh të vendit apo turistë e studiues të huaj. Njohja dhe ekspozimi i këtyre vlerave, në nivele të ndryshme të shoqërisë, jo vetëm që i ndërgjegjëson ata për t’i ruajtur, por edhe për t’i vënë në shërbim të saj, sidomos të ekoturizmit, nivelet dhe potencialet intelektuale nuk mungojnë.

---

<sup>8</sup> Konventa e Aarhusit

## Gjetje:

- ✘ ndotja në ujërat detare është ende një fushë jo shumë e hulumtuar në vendin tonë edhe për faktin se nuk ka një institucion kërkimor shkencor që merret drejtpërdrejtë me këtë punë. Kjo ka bërë të mundur që të dhënat merren nga një sistem i thjeshtë monitorimi mjedisor që kryesisht mbulon zonën bregdetare si edhe të dhënave sporadike që vijnë nga projekte të ndryshme të mbështetur nga donatorët;
- ✘ aktivitetet urbane janë ndër kontribuuesit kryesorë të ndotjes së elementeve mjedisore ajrit, ujit, tokës, ujërave e përdorura dhe të ndotura në pjesën më të madhe të gjeneruara nga qendrat urbane përfshirë këtu dhe Tiranën e cila prodhon një sasi sa gjysma e ujërave të ndotura të prodhuara në të gjithë vendi, shkarkohen në ujërat sipërfaqësore lumenj, duke përfunduar në Detin Adriatik dhe Jon, pa ndonjë lloj trajtimi;
- ✘ gjendja shumë e keqe e vend depozitimeve të mbetjeve urbane pranë bregut të detit të cilat janë nga ndotësit kryesorë të ujërave;
- ✘ ka patur një rritje të ndotjes urbane në zonat bregdetare si rezultat i zhvillimit të turizmit kryesisht në bregdetin e Adriatikut dhe migrimit të pakontrolluar të popullsisë në zonat bregdetare duke përfshirë Tiranën;
- ✘ ndërtimet turistike në zonën bregdetare nuk janë paraprirë ose shoqëruar nga infrastruktura e nevojshme si furnizimi me ujë dhe kanalizimi i ujërave të përdorura, mbledhja, transporti dhe eliminimi higjienik i mbetjeve të ngurta;
- ✘ urbanizimi bregdetar janë ndër kërcënimet kryesorë të cilat janë intensifikuar gjatë viteve të fundit në rritjen demografike bregdetare kontribuon në degradimin e peizazheve, erozionin e tokës, rritjen e shkarkimit të mbeturinave në det, humbjen dhe fragmentimin e habitateve natyrore, si dhe përkeqësimin e gjendjes së specieve vulnerabël apo të rrezikuara;
- ✘ zhvillimi i akuakulturës ka ushtruar trysni të lokalizuar në mjedis megjithëse akuakultura mbështetet nga shumë politika publike, ngre pikëpyetje në lidhje me ndikimin e saj veçanërisht në mjedis, peshkim dhe në grupin e lëndëve të para shoqëruese të nevojshme për ta furnizuar. Zhvillimi i saj mund të ndikojë në humbjen e ose modifikime të habitateve të rëndësishme bregdetare. Përdorimi i ushqimit, antibiotikëve dhe akumulimi i ekskrementeve nga peshqit mund të kontribuojë në uljen e cilësisë së ujit. Kultivimi i peshkut ushtron trysni shtesë mbi burime peshkore dhe për disa peshq jep një rezultat të ulët duke konsideruar volumin dhe peshën e ushqimit që nevojitet për të ushqyer peshkun e kultivuar;
- ✘ Ministria Turizmit dhe Mjedisit nuk kanë të dhëna dhe harta të shpërndarjes për pjesën më të madhe të habitateve dhe specieve të deteve, dhe kjo nuk lejon një vlerësim të besueshëm të statusit të mbrojtjes së tyre apo një bazë për monitorimin;
- ✘ gjuetia e vazhdueshme megjithëse e ndaluar e “midhjes hurmë”, (lat.Molusku lithofaga) apo ai që njihet ndryshe dhe me emrin dateri, ka dëmtuar në mënyrë të pakthyeshme shkëmbinj të koralore dhe brezin koralor të vendit në mjedisin nënujor;
- ✘ shumica e shumë dukurive që vihen re në zonën detare e bregdetare mbesin në nivelin e konstatimeve pasi vlerësimet sasiore të shkallës së ndotjes në zonën bregdetare janë të vështira për tu realizuar.
- ✘ monitorimi i elementeve mjedisore nuk është i plotë si në parametra ashtu dhe në hapësirë dhe kohe, si rezultat i kufizimeve financiare me të cilat ballafaqohen institucionet. Po e njëjta mund të thuhet lidhur me studimet mbi impaktin mjedisor në

- bregdet;
- ✘ Erozioni është një ndër faktorët më problematikë që prek më shumë se 1/3 e bregdetit Adriatik. Përveç faktorëve natyrore, ai është favorizuar kryesisht nga aktiviteti njerëzor që konsiston në:
    - ndërtimi i digave për hidrocentrale ose rezervuarve për përdorim bujqësor, që ka ulur sasinë e lëndës pezull të transportuar nga lumenjtë në bregdet;
    - shfrytëzimi i inerteve nga shtretërit e lumenjve për ndërtime;
    - devijimi i rrjedhës së lumenjve për bonifikime ose qëllime bujqësore.
  - ✘ i gjithë sistemi i lagunave është i kërcënuar në afat kohor të gjatë nga sedimentimi, mbushje me llum, fenomeni i anaerobise hipertrofike, ndotja industriale dhe ajo shtëpiake;
  - ✘ studimet rreth vlerave dhe degradimit eventual të ekosistemit detare janë të rralla dhe një inventar i përgjithshëm nuk është kryer asnjëherë si dhe pak njohuri ka për mjedisin detar përgjatë Bregdetit Adriatik dhe për efektet e ndotjes për 30 vjetet e fundit, nga shkarkimi në det i lumenjve të ndotur si dhe nga shkarkimi direkt i ujërave industriale dhe urbane të ndotura të pa trajtuara;
  - ✘ Pasurimi i ujërave natyrore me lëndë ushqyese (eutrofikimi), kryesisht azot në ujërat detare por gjithashtu fosfor, është shoqëruar me rritjen e prodhimtarisë parësore dhe rritje të algave shqetësuese në zonat bregdetare dhe zonat e deteve të mbyllura dhe gjysmë të mbyllura. Pasojat e eutrofikimit mund të risin frekuencën e lulëzimit të algave (disa herë toksike), rritjen e turbullirës së ujit, shtimin e llumit, mungesën e oksigjenit në ujërat e thella dhe ngordhjen masive të peshqve dhe faunës bentike. Shenja të një eutrofikimi të tillë mund të vërehen në gjirin e Sarandës, Shëngjin, Lagunën e Kunes, Lagunën e Karavastasë Liqenin e Kënellës dhe gjirin e Porto Romanos;
  - ✘ Gjithashtu nga auditimi rezulton se me gjithë punën e bërë nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Bregdetit, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, etj., në mbrojtje të deteve nga ndotjet dhe ndotësit ka mangësi në drejtim të :
    - ❖ Informacioneve jo të plota nga ana e Ministrisë e Turizmit dhe Mjedisit për institucionet në varësisë në drejtim të realizimit në laboratorë të përshtatshëm mikrobiologjik/biokimik të analizave për kontrollin e cilësisë së ujit të deteve;
    - ❖ nga AKB janë të evidentuar rastet të ndotjes së ujërave të deteve nga mbetje të ndryshme plastike si dhe nga monitorimi i lagunave rezultojnë probleme më të mëdha, kështu në Lagunën e Patokut dhe Lagunën e Kune-Vainit ku hidhen mbetje të ndryshme urbane, shkarkohen ujëra të ndotur etj.;
    - ❖ Agjencisë Kombëtare të Bregdetit përfshihet monitorimi i vijës bregdetare por nuk ka kompetenca për monitorimin e ujërave të deteve, si dhe për shkak të mungesës së burimeve njerëzore dhe infrastrukturës së nevojshme e ka të pamundur të realizojë monitorimin e ujërave të ndotura;
    - ❖ pastrimi i ujërave detare nga ndotjet kërkon kosto financiare, kushte të përshtatshme, kërkon studim të zonës, angazhim të disa institucioneve duhet që të merren masa përpara se ndotja të shkojë në det;
    - ❖ pas përfundimit të sezonit turistik ka shumë mbetje plastike të cilat janë qëndrojnë në rërë gjatë gjithë kohës. Këto mbetje janë tapa të shisheve, bishta cigaresh, mbetje të tjera plastike të vogla të cilat me kalimin e kohës, nga ndryshimi i temperaturave kalojnë në fazën e asaj që quhet mikroplastikë;
  - ✘ Efektet e ndotjes, në mjediset bregdetare e detare, mund të përmbliidhen si më poshtë:

- Ekosisteme dhe habitate të rrezikuara detare, në nivelin e ndërmjetëm dhe infralitoral (sidomos zona Shëngjin-Lezhë, Porto Romano, gjiri i Vlorës dhe Sarandës);
- Ekosisteme të rrezikuara bregdetare: deltat e lumenjve (sidomos Drini-Lezhe), pyjet aluviale dhe kënetore, lagunat (Kune, Vaini dhe Karavastaja) dhe liqenet bregdetare (Kënella);
- Risqet dhe impaktet ndaj biodiversitetit dhe disa nga impaktet kryesore negative kanë qenë: prishja dhe fragmentimi i habitateve, dëmtimi (gjiri i Porto Romanos, gjiret e Shëngjinit dhe Sarandës) dhe degradimi i habitateve dhe ekosistemeve, zhdukja e specieve apo kërcënimi për zhdukje i tyre, etj.;
- Reduktimi i livadheve me popullata të *Posidonia oceanica*, sidomos në zonat Shëngjin-Lezhës dhe Sarandës-Ksamili, por gjithashtu edhe gjirin e Porto Romanos dhe të Lalzi, në gjirin e Vlorës dhe të Gjipesë;
- cenohet riprodhimi i specieve të peshqve (psh. levreku) në ekosistemet detare të gjirit të Shëngjinit (sidomos në pjesën veriore - Rana e Hedhun), në gjirin e Porto Romanos dhe të Lalzit dhe në afërsi të gjirit të Sarandës e Ksamilit, etj.
- ka pasoja negative mbi zhvillimin e turizmit;
- ✗ AKB nuk zotëron kapacitetet e nevojshme njerëzore dhe materiale për një analizë e shkallës së ndotjes së ujit të lumenjve që derdhen në det në bazë të monitorimit të vendeve të derdhjes së lumenjve në det por vlerëson atë me sy të lirë për të konstatuar mbetjet plastike dhe mbetje të tjera të dukshme;
- ✗ Ministria e Turizmit dhe Mjedisit nga ana e saj nuk ka punonjës të ngaruar me problematikën e ndotjes ujërave detare e ndotësit e tyre si dhe nuk ka informacion për punonjësit e ngarkuar me monitorimin, verifikimin e kontrollin e ujërave detare nga ndotjet dhe ndotësit në formë piramidale duke filluar nga ministria e gjithë institucionet;
- ✗ Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, AKB dhe AKM nuk kanë realizuar pyetësorë për cilësinë e ujërave detare, për shërbimin e ofruar në mbrojtjen e deteve nga ndotjet dhe ndotësit?

### **Konkluzione:**

- Ruajtja e mjedisit ka të bëjë edhe me përmbushjen dhe plotësimin e përparësive strategjike gjithëpërfshirëse për mbrojtjen e ujërave detare nga ndotjet dhe ndotësit, florën dhe faunën natyrore detare, e për të ndihmuar në zhvillimin e qëndrueshëm të menaxhimit, administrimit, politikave, konsiderimit të popullsisë në zonat detare si faktor i rëndësishëm në realizimin e mbrojtjes dhe zhvillimit të kësaj pasurie kombëtare natyrore, duke i përfshirë ata në vendimmarrje dhe hartimin e planeve të administrimit të integruar për mbrojtjen e tij. Të gjitha këto bëjnë të mundur që, të nxisin zhvillimin e qëndrueshëm, sidomos të turizmit, biznesit, të rriten ndjeshëm të ardhurat e banorëve vendas, të përmirësohet cilësia e jetës së tyre dhe ruajtjen e ujërave detare si trashëgimi për brezat.
- Ka shumë rëndësi përmirësimi i sektorëve që mbrojnë dhe monitorojnë ndotjen e ujërave të deteve, me qëllim mbrojtjen e shëndetit publik nga efektet negative të ndotjes së tij, rritjes së veprimtarisë ekonomike, promovimit dhe rritjes turizmit e sporteve, ruajtje s së florës dhe faunës detare në drejtim të:
  - a) përmirësimi të kërkesave të cilësisë ujërave detare, monitorimit dhe përmirësimi të specifikimeve për analizat e parametrave të tij;

- b) përcaktimit të vlerave e parametrave që nuk gjenden në tabelat përkatëse sa herë që kjo është e nevojshme për mbrojtjen e shëndetit publik në një pjesë apo në gjithë ujërat detare të vendit;
  - c) përshtatjes së metodave analitike të ndryshme, pas verifikimeve përkatëse, në mënyrë që rezultatet përfundimtare të jenë të së njëjtës shkallë besueshmërie me rezultatet e përfituara me metodat e specifikuar më parë;
  - d) përzgjedhjes së vendeve në ujërat detare që përdorin ndërmarrjet e rritjes dhe përpunimit të peshkut;
  - e) përshtatjes së normave dhe udhëzimeve teknike;
  - f) etj.
- Angazhimi dhe bashkërendimi i veprimtarisë të institucioneve shtetërore do të garantojë një mjedis të shëndetshëm për qytetarët, ta ruajë atë nga ndotja dhe dëmtimi, nga aktiviteti njerëzor dhe veprimtaritë ekonomike, ta trajtojë si vlerë të shtuar dhe pasuri për gjenerim aktivitetesh ekonomike, veçanërisht turistike, si dhe ta ruajë atë si trashëgimi për brezat e ardhshëm.
  - Shfrytëzimi i qëndrueshëm i mjedisit, është një potencial i madh punësimi dhe mbrojtjen e tij duhet ta konsiderojmë si një detyrë të përbashkët për të gjithë qytetarët, organizatat mjedisore, shoqërinë civile, median, shkollën, shkencëtarët dhe sektorët e biznesit privat. Falë pozicionit gjeografik dhe shumëllojshmërisë së ekosistemeve në vendin tonë gjenden rreth 30% e florës evropiane. Ndotja, gjuetia e paligjshme dhe shfrytëzimi pa kriter i natyrës, kanë shkaktuar dëme të mëdha. Prandaj duhet të përmirësojmë situatën nëpërmjet vendosjes së masave rigorozë për ruajtjen e ujërave detare, nga ndotjet, duke kontrolluar rreptë gjuetinë, etj.
  - E ardhmja e vendit varet nga përdorimi i mençur i burimeve të tij natyrore, angazhimin për ruajtjen e trashëgimisë natyrore të rinovueshme dhe jo- të rinovueshme të vendit, për të mirën e gjeneratave të sotme dhe të ardhshme;
  - Mungesa e bashkëpunimit, fondeve, strategjive, planeve të menaxhimit, zbatimit të politikave kombëtare për të siguruar menaxhimin e qëndrueshëm në menaxhimin e ndotjeve në dete ndikon në:
    - ofromin e një kornizë për dialog dhe komunikim ndërmjet hartuesve të politikave, brenda dhe jashtë sektorit, si dhe palët e tjera përkatëse, për menaxhim të qëndrueshëm dhe zhvillim të politikave;
    - monitorimin dhe raportimin e gjendjes konkrete mbi zhvillimin e sektorit në mënyrë të përhershme dhe periodike;
    - vlerësimin e përparimin e menaxhimit të qëndrueshëm të AKB dhe në identifikimin nga ana e saj dhe strukturave të tjera shtetërore të çështjeve të reja që dalin në planin kombëtar;
    - formulimin dhe zbatimin, në kuadër të monitorimit e vlerësimi edhe të politikave e programeve kombëtare dhe lokale të AKB e institucioneve të tjera planeve vjetore të veprimeve;
    - sigurojë informata mbi vlerësimin, zhvillimin e qëndrueshëm të biodiversitetit;
  - Mungesa e fondeve, vlerësimit të gjendjes së treguesve, mungesa e kapaciteteve njerëzore, etj., janë problemi kryesor për zbatimin planeve të veprimit për AKB, të cilat mbeten çështje komplekse që mund të zgjidhet vetëm nga qeverisja, me anë të përmirësimit të interesit dhe kapaciteteve brenda kuadrit të politikave edhe integruese si vend aspirues për në BE, e cila kërkon:

- koordinim të përmirësuar horizontal dhe vertikal të komunikimit (p.sh. komunikimi brenda sektorit dhe komunikimi ndër-sektoriale),
- zgjidhjen e çështjeve legjislativë dhe juridiksionit të strukturave (p.sh. adresimin e plotë të strukturave që menaxhojnë, që mbrojnë, që monitorojnë dhe që do të kenë qasje në sistemin e të dhënave),
- përfshirja e palëve të interesuara dhe qartësimi i tyre (p.sh. trajtimin për perceptime të ndryshme dhe përmirësimin e të kuptuarit në sistem të treguesve),
- unifikimin e harmonizim në mbledhjen e të dhënave, reduktimin e raportimit dhe mbingarkesave nga institucionet përgjegjëse,
- Parandalimi i dëmtimeve nga faktorët natyrorë dhe njerëzorë ku parësore është rritja e bashkëpunimit me pushtetin vendor dhe me institucionet e tjera, marrja e masave mbrojtëse ndihmon në ruajtjen e florë dhe të faunës, të cilat kryesisht duhet të përqendrohen në:
  - ngritjen e sistemit të vrojtimit sinjalizimit për parandalimin e ndotjeve;
  - hartimin e skemave dhe grafikëve të grupeve të punës në qarqe në bashkëpunim me pushtetin vendor dhe strukturat lokale e të specializuara;
  - zhvillimit të inspektimit me grup pune mbi problematikat dhe parandalimin e ndotjeve të paligjshme, gjuetisë, dëmtim të biodiversitetit dhe ushtrim aktivitetesh të paligjshme nga subjekte private;
- Rreziku vjen nga dora e njeriut dhe mungesa e ndërgjegjësimit mund të çojë në dëmtime të mëdha mjedisore. Mungesa e gjatë e vëmendjes nga, faktorët klimatikë, por edhe presioni human, konsiderohen "armiqtë" kryesorë në ndotjet mjedisore, zhdukjen dhe minimizimin e shumëllojshmërisë në florë dhe faunë. Shqipëria njihet si vendi i koranëve, peshk i rrallë që rritet në liqenin e Ohrit (Pogradec), por sot ky lloj peshku është drejt zhdukjes apo dhe i gjuetisë së paligjshme të "midhjes dateri"

### **Rekomandime:**

- ✓ Ministria e Turizmit dhe Mjedisit në bashkëpunim me institucionet e varësisë të mundësojë hulumtimin e ndotjes ujërave detare rreth vlerave të degradimit eventual të ekosistemit tonë detar me efektet e ndotjes për 30 vjetët e fundit, nga shkarkimi në det i lumenjve të ndotur dhe shkarkimi direkt i ujërave industriale, urbanë e rurale të përdorura e të pa trajtuara;
- ✓ Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Bregdetit, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, të rrisin bashkëpunimin në mbrojtje të deteve nga ndotjet dhe ndotësit në drejtim të :
  - largimit të vend depozitimeve të mbetjeve urbane të ndërtuara pranë bregut të detit të cilat janë nga ndotësit kryesorë të ujërave;
  - kontrollit të zhvillimit turizmit në bregdetin e Adriatikut dhe Jonit shoqëruar në plotësimin e infrastrukturës e nevojshme si furnizimit me ujë dhe përdorimi i kanalizimeve të ujërave të përdorura, mbledhja, transporti dhe eliminimi higjienik i mbetjeve të ngurta;
  - kontrollit zhvillimit të akuakulturës e cila mund të ndikojë në humbjen ose modifikimin e habitateve të rëndësishme bregdetare;
  - realizimit nga Ministria Turizmit dhe Mjedisit të hartave shpërndarjes së habitateve dhe specieve të deteve,
  - marrjes së masave urgjente për ndalimin e menjëhershëm të gjuetisë së "midhjes hurmë", (lat.Molusku lithofaga) apo ajo që njihet ndryshe dhe me emrin dateri;

- shmangies së faktorëve njerëzorë që bëjnë të mundur favorizimin e erozionit që konsiston në:
  - ndërtimin e digave për hidrocentrale ose rezervuarve për përdorim bujqësor,;
  - shfrytëzimin e inerteve nga shtretërit e lumenjve për ndërtime;
  - devijimin e rrjedhës së lumenjve për bonifikime ose qëllime bujqësore.
- ruajtjes së sistemit të lagunave nga sedimentimi, mbushjes me llum, fenomeni i anaerobise hipertrofike, ndotja industriale dhe ajo shtëpiake si dhe zonave bregdetare nga eutrofikimit të cila favorizojnë lulëzimin e algave (disa herë toksike), rritjen e turbullirës së ujit, shtimin e llumit, mungesën e oksigjenit në ujërat e thella dhe ngordhjen masive të peshqve dhe faunës bentike;
- ✓ Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Bregdetit, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, etj., të rrisin bashkëpunimin në mbrojtje të deteve nga ndotjet dhe ndotësit në drejtim të :
  - ❖ shkëmbimit të informacioneve të plota për kontrollin e cilësisë së ujit të deteve;
  - ❖ kontrollit dhe eliminimit të ndotjes së ujërave të deteve nga mbetje të ndryshme plastike si dhe monitorimin e lagunave ku hidhen mbetje të ndryshme urbane, shkarkohen ujëra të ndotur etj.,
  - ❖ rritjes së kompetencave të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit për monitorimin e ujërave të deteve;
  - ❖ pastrimit të plazheve edhe pas përfundimit të sezonit turistik nga mbetjet plastike, bishta cigaresh, të cilat me kalimin e kohës nga ndryshimi i temperaturave kalojnë në fazën e asaj që quhet mikroplastikë e janë shumë të rrezikshme;
- ✓ Ministria e Turizmit dhe Mjedisit në bashkëpunim me institucionet e varësisë të minimizojë efektet e ndotjes, në mjediset bregdetare e detare, me pasoja në drejtim të:
  - ekosistemeve dhe habitateve të rrezikuara detare e bregdetare;
  - degradimit të habitateve dhe ekosistemeve, zhdukjes specieve apo kërcënimit për zhdukjen e tyre, etj.;
  - reduktimit të livadheve me popullata të *Posidonia oceanica*;
  - cenimit të riprodhimit specieve të peshqve në ekosistemet detare;
  - pasojave negative mbi zhvillimin e turizmit;
- ✓ Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të marrë masa për të ngarkuar punonjës me problematikën e ndotjes ujërave detare nga ndotjet, monitorimin, verifikimin e kontrollin në formë piramidale duke filluar nga ministria e gjithë institucionet;
- ✓ Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, AKB dhe AKM të realizojë pyetësorë për cilësinë e ujërave detare, për shërbimin e ofruar në mbrojtjen e deteve nga ndotjet dhe ndotësit;



## 4. PERMBLEDHJA, REFERENCAT DHE ANKSET

### PERMBLEDHJA

Nuk mund të bësh shumë gjëra pa u lidhur me mjedisin tënd. *“Individi është kalimtar, racat dhe kombet venë e vijnë, por njeriu mbetet”*<sup>9</sup>

Zonat detare sigurojnë benefite të rëndësishme për njerëzit përsa i përket ushqimit dhe shërbimeve të tjera të ekosistemit. Për mijëra vjet, njerëzit e kanë shfrytëzuar gjerësisht detin si një depozitë të madhe ushqimore në luftën e tyre për mbijetesë. Gjatë shekullit të XX, vija bregdetare ka ndryshuar disi për shkak se dyndja e turistëve së bashku me ndotjen e shkaktuar prej tyre ka goditur plazhet.

Mbrojtja e mjedisit, si një proces tepër kompleks, kërkon njohjen dhe aplikimin e koncepteve të reja ekologjike, sociale, ekonomike, politike; pjesëmarrjen si partnerë të shumë aktorëve: organeve shtetërore, komunitetit të banorëve të zonës me rol të veçantë, OJF-ve; kërkon ndihmesën e të gjithë qytetarëve. Ajo realizohet nëpërmjet: mbështetjes ligjore dhe institucionale, formulimit të strategjive dhe politikave të përshtatshme; përgatitjes dhe zbatimit të programeve të studiuara.

Çdo person, kushdo qoftë, bashkëjeton me mjedisin, jo të gjithë njerëzit e institucionet veprojnë njëllor ndaj mjedisit, prandaj është detyrë e të gjithëve por edhe e jona që të synojmë nxitjen e veprimeve të menjëhershme që të përcaktojnë një reflektim mbi pasojat e veprimtarisë njerëzore në mjedis e ku po shkon niveli i ndotjes, duke bindur institucionet shtetërore, biznesin, komunitetin dhe qytetarin për të vepruar, që :

- të kuptojë ç’ është ndotja e mjedisit;
- të njohë ndotjen e tokës;
- të tregojmë ç’ është ndotja e ujërave detare;
- të tregojmë nivelin e ndotjes së ujit, shkaqet;
- të japim rolin e ligjit në mbrojtjen e mjedisit duke shprehur legjislacionin përkatës;
- të tregojmë realisht nivelet e ndotjes bazuar në statistika;
- të paraqesim disa masa që mund të merren për pakësimin e ndotjes;
- të tregojmë fakte mbi ndotjen dhe masat që merren në zonën ku jetojmë;
- të japim mesazhe rekomanduese për institucionet shtetërore dhe sensibilizuese për dëgjuesin.

Nëpërmjet këtij auditimi KLSH synon të skicojë dhe adresojë rrugën për përmbushjen dhe plotësimin e përparësive strategjike gjithëpërfshirëse për mbrojtjen e detit nga ndotjet, si edhe për të ndihmuar në përmirësimin e funksionimit të një sistemi unik të menaxhimit dhe monitorimit të sigurisë në detet dhe bregdetin shqiptar nga ndotja duke promovuar shërbime të sigurta, efikase dhe ekologjikisht të shëndosha në respektim edhe të standardeve evropiane, të diktuar nga direktivat e BE dhe konventat ndërkombëtare në të cilat aderohet dhe vendi ynë. Përmirësimi i sistemit të mbrojtjes mjedisit dhe ujërave të deteve ka ndikim të drejtpërdrejtë në jetën e shëndetit e njeriut, sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, në dobi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm, si dhe sigurimin e kushteve jetës gjallesave detare, zhvillimit turizmit detar, etj.

**Qëllimi i auditimit:** është përmirësimi i bashkëveprimit të gjitha palëve, për të nxitur,

---

<sup>9</sup> Nikola Tesla ka qenë një prej mendjeve më të mëdha të shkencës. Kontributi i tij ka qenë shumë i madh në fushën e elektricitetit dhe inxhinierisë.

rëndësinë strategjike në mbrojtjen dhe ruajtjen e mjedisit detar nga ndotjet dhe ndotësit, respektimin e standardeve me moton uji është jeta në dorën tuaj.

**Objektivi i auditimit:** është analizimi me objektivitet i situatës për të rritur përgjegjësitë institucionale të strukturave shtetërore në monitorimin dhe menaxhimin e ruajtjes ujërave detare nga ndotjet dhe ndotësit si pasuri kombëtare e brezave.

**Rëndësia e auditimit:** është vlerësimi i performancës, përsosja e monitorimit, modernizimi i standardeve, rritja e besueshmërisë publike, për mbrojtjen e mjedisit në ujërat detare, në funksion të ruajtjes shëndetit njeriut, florës dhe faunës detare zhvillimit të turizmit, rritjes së punësimit e zhvillimit të ekonomive që kanë lidhje më detin.

**Mesazhi kryesor i këtij auditimi është:** *“Agjencia Kombëtare të Bregdetit të krijojë një qasje të re ligjore në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare të Mjedisit pushtetin vendor, specialistë të fushës, institucionet ligjvënëse e grupet e interesit, në rritjen e kompetencave të saj për ruajtjen mjedisore të ujërave detare, zhvillimit të ekonomisë dhe turizmit detar, ruajtjes florës e faunës në dete dhe rritjes besimit qytetar.*

***Disa nga mangësitë e konstatuara gjatë auditimit janë;***

Me gjithë punën e bërë dhe reformat e ndërmarra nga institucionet shtetërore sistemi i menaxhimit të mbrojtjes së deteve nga ndotjet dhe ndotësit në mbrojtje të mjedisit, zhvillimit të ekonomisë detare dhe turizmit, në mbrojtje të florës dhe faunës në dete vazhdojnë të kenë mangësi sepse:

- ✘ Ministria e Turizmit dhe Mjedisit në bashkëpunim me institucionet e varësisë nuk ka hartuar strategji për mbrojtjen e deteve nga ndotjet ku të jenë përcaktuar objektivat drejtimet, politikat, në përputhje me drejtimet e strategjisë Qeverisë. Strategji e orientuar drejt zhvillimit efikas dhe të qëndrueshëm të mbrojtjes së deteve, me qëllim rritjen e nivelit ekonomik, ruajtjes florës dhe faunës detare dhe të cilësisë së jetës të brezave të sotëm dhe të ardhshëm;
- ✘ në përmbajtjen e legjislacionit rregullues të AKB-së nuk përfshihet mbrojtja dhe monitorimi i ujërave detare nga ndotjet dhe ndotësit megjithëse mbrojtja e bregut të detit ka lidhje dhe me ujërat e larjes në bregun e detit, por funksioni i saj lidhet kryesisht me mbrojtjen e bregdetit;
- ✘ AKB bashkëpunon me të gjitha institucionet qendrore dhe vendore për përcjelljen e informacionit të mbledhur nga monitorimet në terren, por pas konstatimeve të ndryshme dhe sipas natyrës së rastit, materialet i kalohen institucioneve përkatëse për trajtim, por çfarë ndodh më vonë AKB nuk ka informacion;
- ✘ AKB nuk ka personel, si dhe infrastrukturë mbështetëse, logjistikë zyra, fonde, investime etj. etj., të mjaftueshëm për realizimin e mbrojtjes së deteve nga ndotjet dhe ndotësit;
- ✘ në të gjitha ligjet në fuqi nuk ka një rregullim specifik apo përcaktim të vijës bregdetare, por në ligje të ndryshme ka dispozita të ndryshme, ndaj nevojitet unifikimi i të gjitha dispozitave në një ligj të vetëm;
- ✘ nuk ka një ligj specifik në mbrojtjen mjedisore vetëm për administrimin e bregdetin, ku të përfshihet si deti ashtu dhe bregu i tij i cili të kryhet në mënyrë unike nga një institucion i posaçëm shtetëror, i ngritur për këtë qëllim, me një strukturë organizative që do ti përshtatet kompetencave të reja të këtij institucioni;

- ✘ konstatohet ekzistenca e disa institucioneve qendrore që operojnë në bregdet çka tregon se ka një mbivendosje të kompetencave mes tyre. Ligji 115/2014 Për Ndarjen Administrativo-Territoriale të Njësive të Qeverisjes Vendore, nuk ka përcaktime për bregdetin, me përjashtim të përmendjes së vijës bregdetare si kufi, në hartat që shoqërojnë këtë ligj;
- ✘ nuk ka përputhje të plotë të kompetencave territoriale sipas ndarjes së re administrative duke krijuar vështirësi në menaxhimin dhe ushtrimin e detyrimeve të plota për monitorimin e ndotjeve të ujërave detare sidomos gjatë brigjeve të detit;
- ✘ Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe AKM nuk ka hartuar aktet nënligjore, rregullore, për shpalljen e zonave në rrezik ku përcaktohen programet, masat dhe detyrimet e tjera përkatëse, me qëllim reduktimin dhe parandalimin e ndotjes së ujërave nga substancat e dëmshme, në mbrojtjen e ujërave detare dhe ruajtjes florës dhe faunës detare;
- ✘ Ministria e Turizmit dhe Mjedisit nuk ka kryer auditime për të matur performancën e shërbimit të ofruar në mbrojtjen e deteve nga ndotësit dhe ndotjet;
- ✘ Ministria e Turizmit dhe Mjedisit nuk ka raporte kontrolli të ruajtjes gjendjes natyrore të faunës dhe florës të ujërave detare dhe ndërkuftare;
- ✘ Gjithashtu nga auditimi rezulton se me gjithë punën e bërë nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Bregdetit, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, etj., në mbrojtje të deteve nga ndotjet dhe ndotësit ka akoma mangësi në drejtim të :
  - rritjes së përgjegjësive dhe bashkëpunimit institucional të gjitha strukturave shtetërore për përmirësimin e sistemit të menaxhimit dhe monitorimit të ruajtjes deteve nga ndotjet;
  - përcaktimit të piramidës institucioneve shtetërore me detyrat përkatëse
  - mos evidentimit nga ana e Ministrisë Turizmit dhe Mjedisit të listës apo piramidës e shoqatave apo organizatave vendase dhe të huaja me detyrat përkatëse të cilën kanë projekte në monitorimin dhe ruajtjen e ujërave të detit nga ndotjet;
  - të përputhjes dhe përshtatjes legjislativitetit për menaxhimin dhe monitorimin e mbrojtjes së deteve nga ndotjet dhe ndotësit me legjislativin e BE;
  - mungesave në fonde për investime në shërbim të përmirësimin cilësisë së ujit të deteve në mbrojtje të njeriut, florës dhe faunës, aktiviteteve sportive, subjekteve privat, etj. ;
  - mungesës nga ana e Ministrisë Turizmit dhe Mjedisit, dhe AKB të hartës me vendet e derdhjes së ujërave të përdorura të trajtuara dhe të pa trajtuara si dhe e vendeve derdhjes së ujërave të ndotura në të gjithë vendin gjithashtu duke përcaktuar subjektet që derdhin ujërat e përdorura në det ose në gropa septike pranë bregut të deti. AKM është në procesin e përfundimit të hartës vendeve të derdhjes së ujërave të ndotura nga subjektet privatë në të gjithë vendin kështu:
    - ka zhvilluar një hartë me subjektet e identifikuar si ndotëse në lumenj,
    - vendet e derdhjes së ujërave të ndotura janë të përcaktuara me koordinata në lejet mjedisore,
    - identifikimi i subjekteve si ndotëse në lumenj është bërë nga Projekti "Identifikimi i burimeve të ndotjes në lumenjtë kryesorë të vendit dhe forcimi i kontrollit të ndotjes së lumenjve", gjatë vitit 2016.
  - mungesës nga ana e MTM të hartës vendeve të depozitimit të mbetjeve urbane në të gjithë vendin;
  - të mangësive në monitorimin e vendeve të derdhjes lumenjve në det si rezultat i mungesës hartës grykëderdhjeve tyre;

- mungesës së informacionit nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të vendeve të kryerjes së veprimtarive ekonomike në det;
- mungesës së informacionit nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe AKB të vendeve të kryerjes sportive ujore, turizmit
- ✘ ndotja në ujërat detare është ende një fushë jo shumë e hulumtuar në vendin tonë edhe për faktin se nuk ka një institucion kërkimor shkencor që merret drejtpërdrejtë me këtë punë. Kjo ka bërë të mundur që të dhënat merren nga një sistem i thjeshtë monitorimi mjedisor që kryesisht mbulon zonën bregdetare si edhe të dhënave sporadike që vijnë nga projekte të ndryshme të mbështetur nga donatorët;
- ✘ aktivitetet urbane janë ndër kontribuuesit kryesorë të ndotjes së elementeve mjedisore ajrit, ujit, tokës, ujërave e përdorura dhe të ndotura në pjesën më të madhe të gjeneruara nga qendrat urbane përfshirë këtu dhe Tiranën e cila prodhon një sasi sa gjysma e ujërave të ndotura të prodhuara në të gjithë vendi, shkarkohen në ujërat sipërfaqësore lumenj, duke përfunduar në Detin Adriatik dhe Jon, pa ndonjë lloj trajtimi;
- ✘ gjendja shumë e keqe e vend depozitimeve të mbetjeve urbane pranë bregut të detit të cilat janë nga ndotësit kryesorë të ujërave;
- ✘ ka patur një rritje të ndotjes urbane në zonat bregdetare si rezultat i zhvillimit të turizmit kryesisht në bregdetin e Adriatikut dhe migrimit të pakontrolluar të popullsisë në zonat bregdetare duke përfshirë Tiranën;
- ✘ ndërtimet turistike në zonën bregdetare nuk janë paraprirë ose shoqëruar nga infrastruktura e nevojshme si furnizimi me ujë dhe kanalizimi i ujërave të përdorura, mbledhja, transporti dhe eliminimi higjienik i mbetjeve të ngurta;
- ✘ urbanizimi bregdetar janë ndër kërcënimet kryesorë të cilat janë intensifikuar gjatë viteve të fundit në rritjen demografike bregdetare kontribuon në degradimin e peizazheve, erozionin e tokës, rritjen e shkarkimit të mbeturinave në det, humbjen dhe fragmentimin e habitateve natyrore, si dhe përkeqësimin e gjendjes së specieve vulnerabel apo të rrezikuara;
- ✘ zhvillimi i akuakulturës ka ushtruar trysni të lokalizuar në mjedis megjithëse akuakultura mbështetet nga shumë politika publike, ngre pikëpyetje në lidhje me ndikimin e saj veçanërisht në mjedis, peshkim dhe në grupin e lëndëve të para shoqëruese të nevojshme për ta furnizuar. Zhvillimi i saj mund të ndikojë në humbjen e ose modifikime të habitateve të rëndësishme bregdetare. Përdorimi i ushqimit, antibiotikëve dhe akumulimi i ekskrementeve nga peshqit mund të kontribuojë në uljen e cilësisë së ujit. Kultivimi i peshkut ushtron trysni shtesë mbi burime peshkore dhe për disa peshq jep një rezultat të ulët duke konsideruar volumin dhe peshën e ushqimit që nevojitet për të ushqyer peshkun e kultivuar;
- ✘ Ministria Turizmit dhe Mjedisit nuk kanë të dhëna dhe harta të shpërndarjes për pjesën më të madhe të habitateve dhe specieve të deteve, dhe kjo nuk lejon një vlerësim të besueshëm të statusit të mbrojtjes së tyre apo një bazë për monitorimin;
- ✘ gjuetia e vazhdueshme megjithëse e ndaluar e “midhjes hurmë”, (lat.Molusku lithofaga) apo ai që njihet ndryshe dhe me emrin dateri, ka dëmtuar në mënyrë të pakthyeshme shkëmbinj të koralore dhe brezin koralor të vendit në mjedisin nënujor;
- ✘ shumica e shumë dukurive që vihen re në zonën detare e bregdetare mbesin në nivelin e konstatimeve pasi vlerësimet sasiore të shkallës së ndotjes në zonën bregdetare janë të vështira për tu realizuar.

- ✘ monitorimi i elementeve mjedisore nuk është i plotë si në parametra ashtu dhe në hapësirë dhe kohe, si rezultat i kufizimeve financiare me të cilat ballafaqohen institucionet. Po e njëjta mund të thuhet lidhur me studimet mbi impaktin mjedisor në bregdet;
- ✘ Erozioni është një ndër faktorët më problematikë që prek më shumë se 1/3 e bregdetit Adriatik. Përveç faktorëve natyrore, ai është favorizuar kryesisht nga aktiviteti njerëzor që konsiston në:
  - ndërtimi i digave për hidrocentrale ose rezervuarve për përdorim bujqësor, që ka ulur sasinë e lëndës pezull të transportuar nga lumenjtë në bregdet;
  - shfrytëzimi i inerteve nga shtretërit e lumenjve për ndërtime;
  - devijimi i rrjedhës së lumenjve për bonifikime ose qëllime bujqësore.
- ✘ i gjithë sistemi i lagunave është i kërcënuar në afat kohor të gjatë nga sedimentimi, mbushje me llum, fenomeni i anaerobise hipertrofike, ndotja industriale dhe ajo shtëpiake;
- ✘ studimet rreth vlerave dhe degradimit eventual të ekosistemit detare janë të rralla dhe një inventar i përgjithshëm nuk është kryer asnjëherë si dhe pak njohuri ka për mjedisin detar përgjatë Bregdetit Adriatik dhe për efektet e ndotjes për 30 vjetet e fundit, nga shkarkimi në det i lumenjve të ndotur si dhe nga shkarkimi direkt i ujërave industriale dhe urbane të ndotura të pa trajtuara;
- ✘ Pasurimi i ujërave natyrore me lëndë ushqyese (eutrofikimi), kryesisht azot në ujërat detare por gjithashtu fosfor, është shoqëruar me rritjen e prodhimtarisë parësore dhe rritje të algave shqetësuese në zonat bregdetare dhe zonat e deteve të mbyllura dhe gjysmë të mbyllura. Pasojat e eutrofikimit mund të risin frekuencën e lulëzimit të algave (disa herë toksike), rritjen e turbullirës së ujit, shtimin e llumit, mungesën e oksigjenit në ujërat e thella dhe ngordhjen masive të peshqve dhe faunës bentike. Shenja të një eutrofikimi të tillë mund të vërehen në gjirin e Sarandës, Shëngjin, Lagunën e Kunes, Lagunën e Karavastasë Liqenin e Kënellës dhe gjirin e Porto Romanos;
- ✘ Gjithashtu nga auditimi rezulton se me gjithë punën e bërë nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Bregdetit, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, etj., në mbrojtje të deteve nga ndotjet dhe ndotësit ka mangësi në drejtim të :
  - ❖ Informacioneve jo të plota nga ana e Ministrisë e Turizmit dhe Mjedisit për institucionet në varësisë në drejtim të realizimit në laboratorë të përshtatshëm mikrobiologjik/biokimik të analizave për kontrollin e cilësisë së ujit të deteve;
  - ❖ nga AKB janë të evidentuar rastet të ndotjes së ujërave të deteve nga mbetje të ndryshme plastike si dhe nga monitorimi i lagunave rezultojnë probleme më të mëdha, kështu në Lagunën e Patokut dhe Lagunën e Kune-Vainit ku hidhen mbetje të ndryshme urbane, shkarkohen ujëra të ndotur etj.;
  - ❖ Agjencia Kombëtare e Bregdetit përfshihet në monitorimin e vijës bregdetare por nuk ka kompetenca për monitorimin e ujërave të deteve, si dhe për shkak të mungesës së burimeve njerëzore dhe infrastrukturës së nevojshme e ka të pamundur të realizojë monitorimin e ujërave të ndotura;
  - ❖ pastrimi i ujërave detare nga ndotjet kërkon kosto financiare, kushte të përshtatshme, kërkon studim të zonës, angazhim të disa institucioneve duhet që të merren masa përpara se ndotja të shkojë në det;
  - ❖ pas përfundimit të sezonit turistik ka shumë mbetje plastike të cilat janë qëndrojnë në rërë gjatë gjithë kohës. Këto mbetje janë tapa të shisheve, bishta cigaresh, mbetje

të tjera plastike të vogla të cilat me kalimin e kohës, nga ndryshimi i temperaturave kalojnë në fazën e asaj që quhet mikroplastikë;

- ✘ Efektet e ndotjes, në mjediset bregdetare e detare, mund të përmbliidhen si më poshtë:
  - Ekosisteme dhe habitate të rrezikuara detare, në nivelin e ndërmjetëm dhe infralitoral (sidomos zona Shëngjin-Lezhë, Porto Romano, gjiri i Vlorës dhe Sarandës);
  - Ekosisteme të rrezikuara bregdetare: deltat e lumenjve (sidomos Drini-Lezhe), pyjet aluviale dhe kënetore, lagunat (Kune, Vaini dhe Karavastaja) dhe liqenet bregdetare (Kënella);
  - Risqet dhe impaktet ndaj biodiversitetit dhe disa nga impaktet kryesore negative kanë qenë: prishja dhe fragmentimi i habitateve, dëmtimi (gjiri i Porto Romanos, gjiret e Shëngjinit dhe Sarandës) dhe degradimi i habitateve dhe ekosistemeve, zhdukja e specieve apo kërcënimi për zhdukje të tyre, etj.;
  - Reduktimi i livadheve me popullata të *Posidonia oceanica*, sidomos në zonat Shëngjin-Lezhës dhe Sarandës-Ksamil, por gjithashtu edhe gjirin e Porto Romanos dhe të Lalzi, në gjirin e Vlorës dhe të Gjipesë;
  - cenohet riprodhimi i specieve të peshqve (psh. levreku) në ekosistemet detare të gjirit të Shëngjinit (sidomos në pjesën veriore - Rana e Hedhun), në gjirin e Porto Romanos dhe të Lalzit dhe në afërsi të gjirit të Sarandës e Ksamilit, etj.
  - ka pasoja negative mbi zhvillimin e turizmit;
- ✘ AKB nuk zotëron kapacitetet e nevojshme njerëzore dhe materiale për një analizë e shkallës së ndotjes së ujit të lumenjve që derdhen në det në bazë të monitorimit të vendeve të derdhjes së lumenjve në det por vlerëson atë me sy të lirë për të konstatuar mbetjet plastike dhe mbetje të tjera të dukshme;
- ✘ Ministria e Turizmit dhe Mjedisit nga ana e saj nuk ka punonjës të ngaruar me problematikën e ndotjes ujërave detare e ndotësit e tyre si dhe nuk ka informacion për punonjësit e ngarkuar me monitorimin, verifikimin e kontrollin e ujërave detare nga ndotjet dhe ndotësit në formë piramidale duke filluar nga ministria e gjithë institucionet;
- ✘ Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, AKB dhe AKM nuk kanë realizuar pyetësorë për cilësinë e ujërave detare, për shërbimin e ofruar në mbrojtjen e deteve nga ndotjet dhe ndotësit?

### ***Disa nga konkluzionet e auditimit janë;***

- Trashëgimia është vlerë e përcjellë brez pas brezi. Ajo përbën vlerë të mjedisit natyror dhe, si e tillë, është natyrore, por edhe vlerë materiale e shpirtërore e shoqërisë dhe, si e tillë, është kulturore. Vlerat e saj mund të kenë rëndësi kombëtare dhe cilësohen si "Trashëgimi Natyrore Kombëtare". Ato mbrohen nga ligjet kombëtare. Çdo vend i kulturuar e cilëson dhe e trajton si të shenjtë trashëgiminë natyrore dhe kulturore, sepse me to është i lidhur identiteti kombëtar. Vazhdimisht trashëgimia natyrore kombëtare është kërcënuar dhe kërcënohet nga veprimtaria njerëzore mbi mjedisin dhe vlerat e tij. Kjo e ka bërë të domosdoshme gjetjen dhe aplikimin e mënyrave e rrugëve për mbrojtjen e saj;
- Legjislacionit është i rëndësishëm në të gjitha fushat ai shërben si rregullatori më i mirë i të gjithë marrëdhënieve në shoqërinë njerëzore pse jo dhe në atë të gjallesave të tjera që u binden verbërisht ligjeve të natyrës duke dhënë kështu një shembull të mirë dhe për ne qenien njerëzore që vetë natyra e solli në majë të piramidës ekzistenciale. Njohja, zbatimi dhe harmonizimi i legjislacionit është shumë i rëndësishëm sepse shërben si urë lidhëse midis institucioneve qendrore, pushtetit vendor dhe komunitetit, gjithashtu tre

komponentët e mësipërm të legjislacionit sjellin besueshmëri, efikasitet, siguri dhe sukses. Është shumë e rëndësishme të krijohet një bazë e plotë ligjore për mbrojtjen e mjedisit detar si pjesë e natyrës, nëpërmjet zhvillimit të qëndrueshëm të saj dhe veçanërisht në:

- Përmirësimet ligjore kanë si qëllim t'iu sigurojë atyre të cilëve iu drejtohet një rregullim sa më të saktë dhe të kuptueshëm të problemit që shqyrtohet duke ju përmbajtur rregullimit objektiv të rrethanave, referuar karakteristikave të identifikueshme, duhet të përmbajnë shprehje të qarta dhe të sakta të drejtave dhe detyrimeve dhe të ofrojnë një zgjidhje të qëndrueshme, e cila duhet të jetë:
  - në përputhje me Kushtetutën e vendit;
  - në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara dhe me angazhimet që rrjedhin nga pjesëmarrja e Shqipërisë në organizatat ndërkombëtare;
  - në përputhje me nocionet bazë të arsyes dhe logjikës;
  - praktike;
  - me sa më pak efekte të padëshirueshme anësore;
  - në përputhje e të drejtës së brendshme me acquis-në e BE-së është një tjetër qëllim që duhet të mbahet parasysh
  - sa më efçente nga pikëpamja e kostos, për sa i takon raportit mes qëllimit të legjislacionit dhe mënyrave që përdoren për ta arritur atë.
- Përshtatja, përmirësimet ligjore dhe hartimi i strategjisë për sistemin e mbrojtjes së deteve nga ndotjet dhe ndotësit bëjnë që ky sistem të ecin me ritmin e kohës, kushtimit të vëmendjes ndaj problematikave që e kanë shoqëruar në këto vitet e fundit duke e reformuar nëpërmjet adresim të plotë të fenomeneve që rregullojnë organizimin, funksionimin, institucionalizimit, rritjen e transparencës, përgjegjshmërisë dhe efektivitetit, të tij në funksion të transformimit të ujërave detar në një mjedis në përputhje me standardet më të lartat të BE.
- Kryerja e këtyre përmirësimeve është e rëndësishme duke patur parasysh atë që mbrojtja e ujërave të deteve nga ndotjet është e rëndësishme për qytetarët, nxit punësimin, zhvillon ekonominë, rrit turizmin që të kushtojnë më shumë burime për zhvillimin e forcës së punës si dhe për të siguruar monitorimin e tij që t'u përgjigjet gjithmonë e më mirë nevojave të individëve, punëdhënësve dhe ofruesve.
- Pa një sistem mëndje hapur menaxhimi të mbrojtjes së deteve nga ndotjet dhe ndotësit do të jetë i pamundur trajtimi dhe zgjidhja e shumë problemeve, të cilat kanë të bëjnë me mbrojtjen e shëndetit njeriut, zhvillimin e turizmit ujor, mbrojtjen e florës dhe faunës detare zhvillimit të biznesit në det, etj.
- Përshtatja, përmirësimet ligjore dhe hartimi i strategjisë për sistemin e mbrojtjes së ujërave detarë, do të konsistojnë gjithashtu në garantimin e cilësisë së tyre, në përputhje me kërkesat e BE. Është shumë e rëndësishme kryerja e reformave të vazhdueshme në mirë menaxhimin të mbrojtjes së ujërave të deteve nga ndotjet në mënyrë të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse sepse ofron përfitime social-ekonomike të barabarta dhe për brezat e ardhshëm, sipas parimeve të politikave mjedisore të BE-së. Reformat institucionale kontribuojnë në efçencën e ndërmarrjeve që merren me ndotjet e deteve duke qartësuar çështjet e pronësisë dhe përgjegjësitë e menaxhimit si dhe për më tepër, duke rritur autonominë e tyre krijohet mundësia për rritjen e performancës;
- Ruajtja e mjedisit ka të bëjë edhe me përmbushjen dhe plotësimin e përparësive strategjike gjithëpërfshirëse për mbrojtjen e ujërave detare nga ndotjet dhe ndotësit, florën dhe faunën natyrore detare, e për të ndihmuar në zhvillimin e qëndrueshëm të menaxhimit,



administrimit, politikat, konsiderimit të popullsisë në zonat detare si faktor i rëndësishëm në realizimin e mbrojtjes dhe zhvillimit të kësaj pasurie kombëtare natyrore, duke i përfshirë ata në vendimmarrje dhe hartimin e planeve të administrimit të integruar për mbrojtjen e tij. Të gjitha këto bëjnë të mundur që, të nxisin zhvillimin e qëndrueshëm, sidomos të turizmit, biznesit, të rriten ndjeshëm të ardhurat e banorëve vendas, të përmirësohet cilësia e jetës së tyre dhe ruajtjen e ujërave detare si trashëgimi për brezat.

- Ka shumë rëndësi përmirësimi i sektorëve që mbrojnë dhe monitorojnë ndotjen e ujërave të deteve, me qëllim mbrojtjen e shëndetit publik nga efektet negative të ndotjes së tij, rritjes së veprimtarisë ekonomike, promovimit dhe rritjes turizmit e sporteve, ruajtje s së florës dhe faunës detare në drejtim të:
  - g) përmirësimit të kërkesave të cilësisë ujërave detare, monitorimit dhe përmirësimit të specifikimeve për analizat e parametrave të tij;
  - h) përcaktimit të vlerave e parametrave që nuk gjenden në tabelat përkatëse sa herë që kjo është e nevojshme për mbrojtjen e shëndetit publik në një pjesë apo në gjithë ujërat detare të vendit;
  - i) përshtatjes së metodave analitike të ndryshme, pas verifikimeve përkatëse, në mënyrë që rezultatet përfundimtare të jenë të së njëjtës shkallë besueshmërie me rezultatet e përfituara me metodat e specifikuar më parë;
  - j) përzgjedhjes së vendeve në ujërat detare që përdorin ndërmarrjet e rritjes dhe përpunimit të peshkut;
  - k) përshtatjes së normave dhe udhëzimeve teknike;
  - l) etj.
- Angazhimi dhe bashkërendimi i veprimtarisë të institucioneve shtetërore do të garantojë një mjedis të shëndetshëm për qytetarët, ta ruajë atë nga ndotja dhe dëmtimi, nga aktiviteti njerëzor dhe veprimtaritë ekonomike, ta trajtojë si vlerë të shtuar dhe pasuri për gjenerim aktivitetesh ekonomike, veçanërisht turistike, si dhe ta ruajë atë si trashëgimi për brezat e ardhshëm.
- Shfrytëzimi i qëndrueshëm i mjedisit, është një potencial i madh punësimi dhe mbrojtjen e tij duhet ta konsiderojmë si një detyrë të përbashkët për të gjithë qytetarët, organizatat mjedisore, shoqërinë civile, median, shkollën, shkencëtarët dhe sektorët e biznesit privat. Falë pozicionit gjeografik dhe shumëllojshmërisë së ekosistemeve në vendin tonë gjenden rreth 30% e florës evropiane. Ndotja, gjuetia e paligjshme dhe shfrytëzimi pa kriter i natyrës, kanë shkaktuar dëme të mëdha. Prandaj duhet të përmirësojmë situatën nëpërmjet vendosjes së masave rigoroze për ruajtjen e ujërave detare, nga ndotjet, duke kontrolluar rreptë gjuetinë, etj.
- E ardhmja e vendit varet nga përdorimi i mençur i burimeve të tij natyrore, angazhimin për ruajtjen e trashëgimisë natyrore të rinovueshme dhe jo- të rinovueshme të vendit, për të mirën e gjeneratave të sotme dhe të ardhshme;
- Mungesa e bashkëpunimit, fondeve, strategjive, planeve të menaxhimit, zbatimit të politikave kombëtare për të siguruar menaxhimin e qëndrueshëm në menaxhimin e ndotjeve në dete ndikon në:
  - ofromin e një kornizë për dialog dhe komunikim ndërmjet hartuesve të politikave, brenda dhe jashtë sektorit, si dhe palët e tjera përkatëse, për menaxhim të qëndrueshëm dhe zhvillim të politikave;
  - monitorimin dhe raportimin e gjendjes konkrete mbi zhvillimin e sektorit në mënyrë të përhershme dhe periodike;

- vlerësimin e përparimin e menaxhimit të qëndrueshëm të AKB dhe në identifikimin nga ana e saj dhe strukturave të tjera shtetërore të çështjeve të reja që dalin në planin kombëtar;
- formulimin dhe zbatimin, në kuadër të monitorimit e vlerësimi edhe të politikave e programeve kombëtare dhe lokale të AKB e institucioneve të tjera planeve vjetore të veprimeve;
- sigurojë informata mbi vlerësimin, zhvillimin e qëndrueshëm të biodiversitetit;
- Mungesa e fondeve, vlerësimin të gjendjes së treguesve, mungesa e kapaciteteve njerëzore, etj., janë problemi kryesor për zbatimin planeve të veprimit për AKB, të cilat mbeten çështje komplekse që mund të zgjidhet vetëm nga qeverisja, me anë të përmirësimit të interesit dhe kapaciteteve brenda kuadrit të politikave edhe integruese si vend aspirues për në BE, e cila kërkon:
  - koordinim të përmirësuar horizontal dhe vertikal të komunikimit (p.sh. komunikimi brenda sektorit dhe komunikimi ndër-sektoriale),
  - zgjidhjen e çështjeve legjislativë dhe juridiksionit të strukturave (p.sh. adresimin e plotë të strukturave që menaxhojnë, që mbrojnë, që monitorojnë dhe që do të kenë qasje në sistemin e të dhënave),
  - përfshirja e palëve të interesuara dhe qartësimi i tyre (p.sh. trajtimin për perceptime të ndryshme dhe përmirësimin e të kuptuarit në sistem të treguesve),
  - unifikimin e harmonizim në mbledhjen e të dhënave, reduktimin e raportimit dhe mbingarkesave nga institucionet përgjegjëse,
- Parandalimi i dëmtimeve nga faktorët natyrore dhe njerëzore ku parësore është rritja e bashkëpunimit me pushtetin vendor dhe me institucionet e tjera, marrja e masave mbrojtëse ndihmon në ruajtjen e florë dhe të faunës, të cilat kryesisht duhet të përqendrohen në:
  - ngritjen e sistemit të vrojtimit sinjalizimit për parandalimin e ndotjeve;
  - hartimin e skemave dhe grafikëve të grupeve të punës në qarqe në bashkëpunim me pushtetin vendor dhe strukturat lokale e të specializuara;
  - zhvillimit të inspektimit me grup pune mbi problematikat dhe parandalimin e ndotjeve të paligjshme, gjuetisë, dëmtim të biodiversitetit dhe ushtrim aktivitetesh të paligjshme nga subjekte private;
- Rreziku vjen nga dora e njeriut dhe mungesa e ndërgjegjësimit mund të çojë në dëmtime të mëdha mjedisore. Mungesa e gjatë e vëmendjes nga, faktorët klimatikë, por edhe presioni human, konsiderohen "armiqtë" kryesorë në ndotjet mjedisore, zhdukjen dhe minimizimin e shumëllojshmërisë në florë dhe faunë. Shqipëria njihet si vendi i koranëve, peshk i rrallë që rritet në liqenin e Ohrit (Pogradec), por sot ky lloj peshku është drejt zhdukjes apo dhe i gjuetisë së paligjshme të "midhjes dateri"

### ***Rekomandimet për përmirësimin dhe përsosjen e sigurtë rrugore;***

- ✓ Ministria e Turizmit dhe Mjedisit në bashkëpunim Agjencinë Kombëtare të Bregdetit, Agjencinë Kombëtare të Mjedisit dhe institucionet e saj të varësisë, të hartojnë strategji për mbrojtjen e deteve nga ndotjet ku të jenë përcaktuar objektivat drejtimet, politikat, në përputhje me drejtimet e strategjisë Qeverisë;
- ✓ AKB në bashkëpunim me Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe institucionet ligjvënëse, të marrin masa për përmirësimin e gjithë paketës ligjore, me një strukturë organizative që do ti përshtatet kompetencave të reja të këtij institucioni, për administrimin dhe mbrojtjen e

mjedisit bregdetar e detar nga ndotjet dhe ndotësit, zhvillimit të turizmit detar, mbrojtjes florës dhe faunës detare;

- ✓ AKB në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit të mundësojë plotësimin e strukturës saj me personel infrastrukturë mbështetëse, logjistikë zyra, фонде, investime etj. etj., të mjaftueshëm për realizimin e mbrojtjes së deteve nga ndotjet dhe ndotësit;
- ✓ AKB në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, institucionet ligjvënëse, të marri masa për unifikimin e të gjitha dispozitave të ndryshme ligjore në një ligj të vetëm për përcaktimin e saktë të vijës bregdetare duke bërë të mundur dhe shmangien e mbivendosje të kompetencave mes tyre në zbatim të ligjit 115/2014 “Për Ndarjen Administrativo-Territoriale të Njësive të Qeverisjes Vendore”;
- ✓ AKB në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, institucionet ligjvënëse të kërkojë përmirësime ligjore për përputhje të plotë të kompetencave territoriale sipas ndarjes së re administrative në menaxhimin dhe ushtrimin e detyrimeve të plota për monitorimin e ndotjeve të ujërave detare sidomos gjatë brigjeve të detit;
- ✓ Ministria e Turizmit dhe Mjedisit në bashkëpunim me AKM, institucionet ligjvënëse të hartojë aktet nënligjore, rregullore, për shpalljen e zonave në rrezik, me qëllim reduktimin dhe parandalimin e ndotjes së ujërave nga substancat e dëmshme, në mbrojtjen e ujërave detare dhe ruajtjes florës dhe faunës detare;
- ✓ Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të realizojë auditime për të matur performancën e shërbimit të ofruar në mbrojtjen e deteve nga ndotësit dhe ndotjet si dhe realizimin e Raporteve të kontrollit të ruajtjes gjendjes natyrore të faunës dhe florës të ujërave detare dhe ndërkuftare;
- ✓ Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Bregdetit, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, të rrisin bashkëpunimin në mbrojtje të deteve nga ndotjet dhe ndotësit në drejtim të :
  - rritjes së përgjegjësive për përmirësimin e sistemit të menaxhimit dhe monitorimit të ruajtjes deteve nga ndotjet;
  - evidentimit nga ana e Ministrisë Turizmit dhe Mjedisit të listës apo piramidës e shoqatave apo organizatave vendase dhe të huaja me detyrat përkatëse të cilën kanë projekte në monitorimin dhe ruajtjen e ujërave të detit nga ndotjet;
  - të përputhjes dhe përshtatjes legjisacionit për menaxhimin dhe monitorimin e mbrojtjes së deteve nga ndotjet dhe ndotësit me legjisacionin e BE;
  - të rritjes фондеve për investime në shërbim të përmirësimin cilësisë së ujit të deteve në mbrojtje të njeriut, florës dhe faunës, aktiviteteve sportive, subjekteve privat, etj.;
  - përcaktimit nga ana e Ministrisë Turizmit dhe Mjedisit, të hartës me vendet e derdhjes së ujërave të përdorura të trajtuara dhe të pa trajtuara si dhe e vendeve derdhjes së ujërave të ndotura në të gjithë vendin;
  - rritjes së përgjegjësive në monitorimin e vendeve të derdhjes lumenjve në det si kjo dhe rezultat i mungesës hartës grykëderdhjeve tyre;
  - krijimit të një bazë të dhënash nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të vendeve të kryerjes së veprimtarive ekonomike në det;
  - krijimit të një bazë të dhënash nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe AKB të vendeve të kryerjes sportive ujore, dhe turizmit ujor;
- ✓ Ministria e Turizmit dhe Mjedisit në bashkëpunim me institucionet e varësisë të mundësojë hulumtimin e ndotjes ujërave detare rreth vlerave të degradimit eventual të ekosistemit tonë

detar me efektet e ndotjes për 30 vjetët e fundit, nga shkarkimi në det i lumenjve të ndotur dhe shkarkimi direkt i ujërave industriale, urbane e rurale të përdorura e të pa trajtuara;

✓ Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Bregdetit, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, të rrisin bashkëpunimin në mbrojtje të deteve nga ndotjet dhe ndotësit në drejtim të :

- largimit të vend depozitimeve të mbetjeve urbane të ndërtuara pranë bregut të detit të cilat janë nga ndotësit kryesorë të ujërave;
- kontrollit të zhvillimit turizmit në bregdetin e Adriatikut dhe Jonit shoqëruar në plotësimin e infrastrukturës e nevojshme si furnizimit me ujë dhe përdorimi i kanalizimeve të ujërave të përdorura, mbledhja, transporti dhe eliminimi higjienik i mbetjeve të ngurta;
- kontrollit zhvillimit të akuakulturës e cila mund të ndikojë në humbjen ose modifikimin e habitateve të rëndësishme bregdetare;
- realizimit nga Ministria Turizmit dhe Mjedisit të hartave shpërndarjes së habitateve dhe specieve të deteve,
- marrjes së masave urgjente për ndalimin e menjëhershëm të gjuetisë së “midhjes hurmë”, (lat.Molusku lithofaga) apo ajo që njihet ndryshe dhe me emrin dateri;
- shmangies së faktorëve njerëzorë që bëjnë të mundur favorizimin e erozionit që konsiston në:
  - ndërtimin e digave për hidrocentrale ose rezervuarve për përdorim bujqësor,;
  - shfrytëzimin e inerteve nga shtretërit e lumenjve për ndërtime;
  - devijimin e rrjedhës së lumenjve për bonifikime ose qëllime bujqësore.
- ruajtjes së sistemit të lagunave nga sedimentimi, mbushjes me llum, fenomeni i anaerobise hipertrofike, ndotja industriale dhe ajo shtëpiake si dhe zonave bregdetare nga eutrofikimit të cila favorizojnë lulëzimin e algave (disa herë toksike), rritjen e turbullirës së ujit, shtimin e llumit, mungesën e oksigjenit në ujërat e thella dhe ngordhjen masive të peshqve dhe faunës bentike;

✓ Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Bregdetit, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, etj., të rrisin bashkëpunimin në mbrojtje të deteve nga ndotjet dhe ndotësit në drejtim të :

- ❖ shkëmbimit të informacioneve të plota për kontrollin e cilësisë së ujit të deteve;
- ❖ kontrollit dhe eliminimit të ndotjes së ujërave të deteve nga mbetje të ndryshme plastike si dhe monitorimin e lagunave ku hidhen mbetje të ndryshme urbane, shkarkohen ujëra të ndotur etj.,
- ❖ rritjes së kompetencave të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit për monitorimin e ujërave të deteve;
- ❖ pastrimit të plazheve edhe pas përfundimit të sezonit turistik nga mbetjet plastike, bishta cigaresh, të cilat me kalimin e kohës nga ndryshimi i temperaturave kalojnë në fazën e asaj që quhet mikroplastikë e janë shumë të rrezikshme;

✓ Ministria e Turizmit dhe Mjedisit në bashkëpunim me institucionet e varësisë të minimizojë efektet e ndotjes, në mjediset bregdetare e detare, me pasoja në drejtim të:

- ekosistemeve dhe habitateve të rrezikuara detare e bregdetare;
- degradimit të habitateve dhe ekosistemeve, zhdukjes specieve apo kërcënimit për zhdukjen e tyre, etj.;
- reduktimit të livadheve me popullata të *Posidonia oceanica*;

- cenimit të riprodhimit specieve të peshqve në ekosistemet detare;
  - pasojave negative mbi zhvillimin e turizmit;
- ✓ Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të marrë masa për të ngarkuar punonjës me problematikën e ndotjes ujërave detare nga ndotjet, monitorimin, verifikimin e kontrollin në formë piramidale duke filluar nga ministria e gjithë institucionet;
- ✓ Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, AKB dhe AKM të realizojë pyetësorë për cilësinë e ujërave detare, për shërbimin e ofruar në mbrojtjen e deteve nga ndotjet dhe ndotësit;

#### 4.1 Referencat

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Ligjin 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- Ligji nr. 8378, datë 22.7.1998, “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 118/2012 datë 13.12.2012 “Për transportin e mallrave të rrezikshme”;
- Ligji nr. 158/213 datë 10.10.2013 “Për sigurinë në tunelet rrugore”;
- Ligjin nr. 10211, datë 23.12.2009 “Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 9, datë 11.12.2009, të Këshillit të Ministrave “Për mënyrën e funksionimit dhe burimet e financimit të sistemit të tahogرافit dixhital në Shqipëri”;
- Ligji nr. 8308 datë 13.03.1998 “Për transportin rrugor”, i ndryshuar;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 153 datë 7.4.2000 “Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Vendimi nr. 739 datë 09.09.2015 “Për disa masa shtesë dhe ndryshime në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 153, datë 7.4.2000”;
- Vendimi nr. 1243, datë 10.09.2008 “Për miratimin e rregullores për organizimin e kohës së punës së personave që kryejnë transport rrugor, për orët e drejtuesve të mjeteve dhe pajisjet e regjistrimit”;
- Vendimi nr. 207, datë 25.02.2009 “Për vendosjen dhe përdorimin e tahogرافit dixhital”;
- Vendimi Nr. 1054, datë 22.12.2010 “Për miratimin e rregullores për pajisjet e regjistrimit në transportin rrugor”;
- Vendimi nr. 298, datë 08.04.2015 për ndryshimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 153, datë 7.4.2000 “Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”;
- Vendimi nr. 739, datë 09.09.2015 “Për sistemin e të dhënave të aksidenteve rrugore”;
- Vendimi nr. 940, datë 18.11.2015 “Për disa ndryshime në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 153, datë 07.04.2000” Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”;
- Analiza të veprimtarisë së Ministrisë Infrastrukturës dhe Energjisë;
- Analiza të veprimtarisë së Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit;
- Vlerësime të situatës sigurisë rrugore në periudha të ndryshme nga ana Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit;
- Analiza të veprimtarisë së Autoritetit Rrugor Shqiptar;
- Rregullore për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë Infrastrukturës dhe Energjisë, Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Autoritetit Rrugor Shqiptar;
- Direktiva 2006/126 /KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 20 dhjetor 2006 mbi lejet e drejtimit.  
<http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=URISERV%3A124141>  
[https://ec.europa.eu/neighbourhoodenlargement/sites/near/files/pdf/key\\_documents/2016/20161109\\_report\\_albania.pdf](https://ec.europa.eu/neighbourhoodenlargement/sites/near/files/pdf/key_documents/2016/20161109_report_albania.pdf);
- Udhëzimi i Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës Nr. 3606/2, datë 28.10.2011 “Për pajisjen e përdoruesve të mjeteve rrugore të kategorive C, CE, D (\*) dhe DE, me certifikatën e aftësisë profesionale (ÇAP)”;
- Udhëzimi Nr. 2 datë 11.2.2010 “Për kontrollin teknik të mjeteve rrugore”;
- Udhëzimi Nr. 9, datë 03.07.2012 “Për auditimin dhe kontrollin e sigurisë rrugore”;
- Udhëzimi Nr. 1, datë 10.01.2012 “Për regjistrimin e automjeteve rrugore dhe rimorkiove të tyre”, i ndryshuar;

- Udhëzimi Nr. 3985/4, datë 24.06.2013 “Për procedurat e kontrollit gjatë transportit rrugor të mallrave”;
- Udhëzimi nr. 4 datë 27.5.2014 “Për standardet e funksionimit të pikave të autorizuara të shitjes së makinerive (qendrat teknike) të takografit dixhital”, i ndryshuar;
- Udhëzimi i Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës Nr. 9, datë 09.10.2015 “Për disa ndryshime të Udhëzimit nr. 3606/2 (18), datë 28.10.2011” Për pajisjen e përdoruesve të mjeteve rrugore të kategorive C dhe D me certifikatën e aftësisë profesionale (ÇAP)”;
- Udhëzimi i Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës Nr. 682/4, datë 01.04.2016 “Për aktivitetin e auto shkollave, pajisjen e kandidatëve me leje drejtimi, kualifikimin e instruktorëve të auto shkollave dhe specialistëve të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor(DPSHTRR)”;
- Udhëzim i Ministrit të Transportit nr. 1546, datë 29.03.2016 “Riparimi i mjeteve rrugore dhe rimorkiove të tyre”;
- Udhëzimi nr. 10, datë 30.05.2011 “Për miratimin e tipit të traktorëve bujqësorë ose të pylltarisë, rimorkiove dhe rimorkiatorëve të tyre të ndërkëmbyeshëm, së bashku me sistemet, pjesët përbërëse dhe njësitë e tyre të ndara teknike”;
- Udhëzimi nr. 11, datë 06.06.2011 “Për miratimin e tipit të mjeteve motorike dhe rimorkiove të tyre, të sistemeve, pjesëve përbërëse dhe njësisë të veçanta teknike të destinuar për këto mjete”;
- Udhëzimi Nr. 12, datë 06.06.2011 “Për miratimin e tipit të mjeteve motorike me dy ose tre rrota”;
- Të dhëna statistikore nga INSTAT
- Udhëzues dhe Manuale të Auditimit të Performancës të KLSH-së dhe SAI-ve;
- Raporte monitorimit;
- Raporte të sigurisë rrugore për vitet 2013, 2014, 2015, 2016, 2017;
- Shqipëria, Raporti Vjetor i KE-së “për vitet 2014, 2015 dhe 2016 të publikuar nga ish-Ministria e Integritetit të Shqipërisë;
- Raporti i Statusit Global për sigurinë rrugore, OBSH 2009
- Marrëveshjet ndërkombëtare në të cilat Shqipëria është anëtarësuar/ Në tërësi, Shqipëria është palë kontraktuese në 30 marrëveshje (konventa) ndërkombëtare të transportit rrugor. ([http://www.unece.org/fileadmin/DAM/trans/conventn/agree\\_e.pdf](http://www.unece.org/fileadmin/DAM/trans/conventn/agree_e.pdf))
- Indikatorët e Performancës, NAO Britanike;
- Raporte me eksperiencë më të mira ndërkombëtare;
- ([http://ec.europa.eu/transport/wcm/road\\_safety/erso/data/Content/european\\_databases.htm](http://ec.europa.eu/transport/wcm/road_safety/erso/data/Content/european_databases.htm))
- ([https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/key\\_documents/2016/20161109\\_report\\_albania.pdf](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/key_documents/2016/20161109_report_albania.pdf))
- <https://www.worldwildlife.org/> Fondi botëror i jetës së egër për natyrën
- National Environmental Action Plan. Tiranë 2002
- State of Environment Report, 1997-1998, Tiranë 2000
- State of Environment Report (draft), 1999-2000, Tiranë 2001
- Solid Waste National Management Plan, Phare, 1996
- Public Investment Program 2000-2003, Tiranë, 2000
- Tafaj L., et.al. Assessment of the pollution from hexachlorocyclohexan isomers in the area of Porto-Romano (Durrës), Tiranë, 2001.
- Post-Conflict Environmental Assessment of Albania. UNDP, 2001



- Conservation of wetland and coastal ecosystem in the Mediterranean Region. Project Document. UNDP, 1999.
- The Albanian Statistical Yearbook 1991-1999, Tirana, 2002
- Strategic Action Program to Address Pollution from Land Base Sources Activities. UNEP, Athens 1999.
- Karavasta Lagoon Wetland Management Project. Milano 1996
- Saranda eater supply and sanitation feasibility study. Final Report, IËACO 1997
- Strategic Plan for Great Tirana. Main Report. PADOC, 2002
- Agriculture Annual Report (draft). Tirana 2002
- Technical Assessment and final design Construction and Management of Constructed Treatment Wetlands (draft). SËS-TEI, Milano 2002
- Feasibility study for Urgent Risk Reduction Measures at Sharra Landfill in Albania. UNEP 2002
- First National Communication of Albania to the UNFCCC. Tirana 2002
- Environmental Performance Review of Albania. Geneva 2002
- Monitoring of *Posidonia oceanica* in Albanian Coastal Eater. NGO: Mass media and Environment. Tirana 2002
- Coastal Zone Management Plan. The Region Durrresi-Vlora (draft). Split 1996
- Albanian Coastal Zonë Management Plan. Northern & Southern part. Split-Vienne, 1996
- Field Study in Albania on State of Protection of Marine and Coastal Sites of Ecological Interest and Endangered Species. Cite Jardin 1992
- Coastal Changes in Albania: Case studies at Karavasta and Patok. BGS 1995
- Implementation of the Seëerage Project Kavaja. Conceptual Design Report. RODECO, 2001.
- A. Cullaj et.al. Analytical Investigation on Heavy Metals Content in Sediments of Albanian Coast. Journal of Envir. Prot. and Ecology, No.1, pp 81-89, 2000.
- V. Celo, et.al. An Assessment of Heavy Metals Pollution in the Sediments Along the Albanian Coast. Eater, Air and Soil Pollution, 111; 235-250, 1999. Netherland.
- Babi. D, et.al. Evaluation of Heavy Metals Pollution of Sediments of Vlora Bay Adriatic Sea, Albania. Fresenius Enviro. Bull. 7: 577-584, 1998. F.R.of Germany.
- Baraj et.al. Heavy Metal Contents in Sediments, Biota and Micro algae Samples, Collected in Vlora Bay. Fresenius Environ. Bull.3, 169 F.R.of Germany.
- Institute of Statistics. Albanian population in 2001. Tirana 2002.
- Strategy and Action Plan for Biodiversity Protection. p106 Tirana 1999
- Peja N. et.al. Characteristics of Albanian lagoons and their fishery. Fisheries Research, 27, 1999, pp 215-225. Neë York.
- Amato E. Mediterraneo e Caraibi due mari in pericolo? Sversamenti accidentali di idrocarburi ed emergenze causate dalle alghe. ICRAM, Genova, 1992
- Miho A. et.al. Phytoplanktonic data and trophic state of Lezha lagoons. AJNTS, 1, 1999 pp 69-75 Tirana.
- Koci K. et al. Polychlorinated Biphenyls in a loë polluted area (Karavasta Lagoon; Albania); levels, patterns and biomagnification. Proceedings of subregional ëorkshop on identification and management of PCB-s and Dioxins/Furans. pp199-125. UNEP, Croatia 2000.
- Koci K. The trend of POP pollution in the Albanian Adriatic Coast: Case study: PCB-s (1992-1996) pp 101-106, Proceedings of Sub regional äareness raising ëorkshop on POP-s. UNEP, Slovenia 1998

- Feasibility study for urgent risk reduction measures at Sharra landfill in Albania. p56. Tirana 2002.
- CoNISMa. Interreg II Italia-Albania. Asse 3 - Ambiente. Misura 3.1 - Progetto di una rete di monitoraggio delle acque marine del Basso Adriatico. Vol I-II e Relazione Finale Sintetica, 2002.
- Public Health Institute. Monitoring of the quality of urban wastewater for the year 2002. Tirana
- Cullaj, et al. Some considerations of mercury levels in the environment of Vlora bay. Faculty of Natural Science, University of Tirana, 2001
- UNEP. "Monitoring Programme of the Eastern Adriatic Coastal Area" MAP Technical Reports Series, No 86, Athens, 1994
- The European Commission " Bathing water quality", 2002
- Profili i Bashkive, 174 f., Tirane. 2002
- Jana N, et al. "Percaktimi i zonave rajonale te ngritjes se industrise se perpunimit te lekureve", 65 f., Tirane, 2002.
- Rakaj N. Iktiofauna e Shqiperise. Shtepia Botuese "Libri Universitar", 700 f, Tirane 1995.
- Akademia e Shkencave e Shqiperise, Instituti Hidrometeorologjik. Hidrologjia e Shqiperise, 425 f. Tirane, 1984.
- Pano N. Dinamica del litorale albanese - Sintesi delle conoscenze. Atti del XIX Convegno AIGI, 15 f., 1992.
- Paskoff R. Le cotes d'Albanie - Aspects Geomorfologique, Bulletin de L'association de Geographie,2, pp 77-83, 1985.
- Bertoluzza et al. Influence of rivers on pollution of coastal waters. In Fabbri P., Coastlines of Italy. American Society of Civil Engineers, pp.16-29, NY , 1989.
- Picinetti C. and Bombace G. Eutrophication in the Adriatic Sea. In Fabbri P., Coastlines of Italy. American Society of Civil Engineers, pp.30-39, NY, 1989.
- MEDPOL-PHASE III, Agreement between Albania and UNEP. 2002
- Bathing Water Quality Directive 76/160/EEC. 1975
- Urban wastewater Directive 91/271/EEC.1991
- Europe's Water: An Indicator Based Assessment. 2003
- Report on Microbiological Monitoring of Bathing Waters in Main Beaches of Albania. Institute of Public Health. 2002 (in Albanian language)
- Strategjia Kombëtare e sigurisë Rrugore 2011 – 2020;
- Strategjia Kombëtare e Transportit dhe Plani i Veprimit 2016-2020 (përditësuar sipas riorganizimit të fundit të qeverisë që u realizua në fund të vitit 2017);
- "Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020" miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 348, datë 11 maj 2016 dhe botuar në Fletoren Zyrtare nr. 86, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 811, datë 16 nëntor 2016 "Për miratimin e Strategjisë së Sektorit të Transportit dhe të Planit të Veprimit";
- Vlerësimi i performancës së sigurisë rrugore në Shqipëri realizuar nga Komisioni Ekonomik i Kombeve të Bashkuara për Evropën, Komisioni Ekonomik i Kombeve të Bashkuara për Amerikën Latine dhe Karaibet, Komisioni Ekonomik dhe Social i Kombeve të Bashkuara për Azinë dhe paqësorin;
- Inspektimi i akteve kombëtare në aspektin e sigurisë rrugore
- Raporte të auditimit të KLSH-së, Ministrisë dhe auditit të brendshëm;
- Etj.

## 4.2 Anekset (Pyetësorët)

### MBI AUDITIMIN E PERFORMANCËS ME TEMË “NDOTJA E DETEVE”

**Drejtuar: Agjencisë Kombëtare të Bregdetit me Drejtoritë Rajonale**

**Tiranë**

Në përputhje me Programin e Auditimit të Performancës “Ndotja e Deteve” të Kontrollit të Lartë të Shtetit, me nr. 442/2, datë 21/10/2019, ku shtrirja e tij është në; Ministria e Turizmit dhe Mjedisit; Agjencia Kombëtare e Bregdetit me katër Drejtoritë Rajonale, që monitoron bregdetet në Velipojë, Shëngjin, Tale (Lezhë), Gjiri i Lalzit, Durrës, Golem, Vlorë, Dhërmi, Himarë, Borsh, Sarandë; Agjencia Kombëtare e Mjedisit me Drejtoritë Rajonale Mjedisore në 12 qarqet e vendit Berat, Dibër, Durrës, Elbasan, Fier, Gjirokastër, Korçë Kukës, Lezhë, Shkodër, Tiranë dhe Vlorë, për veprimtarinë që përfshihet në periudhën 01.01.2016-31.08.2019, **Jeni të lutur** të plotësoni pyetësorin e mëposhtëm, i cili ka si qëllim marrjen e opinioneve dhe informacioneve për realizimin e këtij auditimi.

Nëpërmjet përgjigjeve, ne kërkojmë me dëshirën e mirë të kontribuojmë në kthjellimin e perspektivës të mbrojtjes ujit deteve nga ndotje, si një nga faktorët e rëndësishëm në mbrojtjen e mjedisit, përmirësimin e cilësisë jetës njeriut duke promovuar përvojat më të përparuara dhe shërbime të sigurta dhe efikase.

**Përgjigjet e pyetjeve duhet të bëhen një nga një, rast pas rasti, me argumente dhe komente sqaruese.** Krahas opinioneve dhe komentet tuaja, bashkëlidhur çdo pyetjeje, lutemi të na vini në dispozicion dokumente argumentues, relacione, informacione, evidenca, raporte, urdhra e udhëzime, etj.

Pyetësori apo informacioni pasi të nënshkruhet nga të gjithë personat që kanë marrë pjesë në përgatitjen e tij, të dërgohet zyrtarisht pranë Institucionit të KLSH në adresën:

#### **KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**

**Rruga "Abdi Toptani" , Nr. 1 / TIRANË**

si dhe në formë elektronike në adresat:

[rmuca@klsh.org.al](mailto:rmuca@klsh.org.al); [azylfi@klsh.org.al](mailto:azylfi@klsh.org.al); [eagolli@klsh.org.al](mailto:eagolli@klsh.org.al);

Gjatë shtjellimit, pyetësori mund të pasurohet më tej me pyetje të reja gjatë bashkëbisedimeve me personat përgjegjës dhe të ngarkuar për zbatimin e tyre si dhe të përgjigjeve të pyetësorëve që mund të realizohen me qytetarët, subjekte private e organizata jo qeveritare që kanë kontribuar në përmirësimin e sistemit të mbrojtjes së deteve nga ndotjet etj.

Për çdo sqarim të mëtejshëm jemi në dispozicion dhe për diskutime të hapura, të cilat do të na ndihmonin në formulimin e mendimeve dhe rekomandimeve sa më të plota për përmirësimin e sistemit të menaxhimit të deteve të cilat do t’u ndihmonin **Ju**.

Për sa më sipër **lutemi** që informacioni të dorëzohet brenda 7 ditëve nga data e marrjes së Pyetësorit.

Dokumentacioni argumentues, relacione, informacione, evidenca, raporte, urdhra e udhëzime, etj., të dërgohet dorazi pranë zyrës ku është vendosur grupi i auditimit i Kontrollit të Lartë të Shtetit në Agjencinë Kombëtare të Bregdetit Tiranë.

Ju faleminderit për bashkëpunimin!



## PYETËSOR

- 1. A E KA REALIZUAR MENAXHIMI DHE MONITORIMI I DETIT SI PASURI NATYRORE KOMBËTARE, RUAJTJEN NGA NDOTJET DHE ZHVILLIMIN E TIJ SI VLERË E MJEDISIT NATYROR NË SHËRBIM TË NJERIUT?**
  - 1.1. Paraqitni shkurtimisht historikun e zhvillimin të aktivitetit institucionit tuaj në mbrojtje të deteve nga ndotjet, mënyrën e krijimit, organizimit, funksionimit, baza ligjore, drejtimit dhe programet e ofruara, etj., në lidhje me menaxhimin e tij në funksion të ruajtjes nga ndotësit, mbrojtjes biodiversitetit, habitateve, të faunës dhe florës së egër?
  - 1.2. A keni bashkëpunim me institucionet shtetëror dhe privatë të cilën merren me menaxhimin, monitorimin dhe ruajtjen e ujërave të detit nga ndotjet? (nëse po kush janë ata dhe detyrat e tyre)
  - 1.3. A është i rregulluar me legjislacion menaxhimi dhe monitorimi i mbrojtjes deteve nga ndotjet? (nëse Po paraqiteni atë dhe në të kundërt argumentet pse JO)
  - 1.4. A është i përshtatur legjislacion menaxhimi dhe monitorimi i mbrojtjes së deteve nga ndotjet me legjislacionin e BE? (nëse Po paraqiteni atë rast pas rasti dhe në të kundërt argumentet pse JO)
  - 1.5. A keni propozuar ndryshime në aktet ligjore dhe nën ligjore që kanë të bëjnë me menaxhimin dhe administrimin e sistemit të mbrojtjes së deteve nga ndotësit? (nëse PO kush janë ato)
  - 1.6. A keni propozuar ndryshime në aktet ligjore dhe nën ligjore që kanë të bëjnë me cilësinë e ujërave të deteve për larje? (nëse PO kush janë ato)
  - 1.7. A ka në procesin e administrimit e menaxhimit të shërbimit të veprimtarisë sistemit të mbrojtjes ujërave të deteve mbivendosje kompetencash midis organeve qendrore Ministrive dhe pushtetit vendor që bëhen pengesë në mbarëvajtjen e këtij sistemi? (nëse PO kush janë ato)
  - 1.8. A keni propozime për investime në shërbim të përmirësimit cilësisë së ujit të deteve në mbrojtje të njeriut, florës dhe faunës, aktivitetve sportive, subjekteve privat, etj.? (nëse PO, paraqitini ato rast pas rasti )
